

INSPEKTIMI SI INSTRUMENT I KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË POLICINË E KOSOVËS

Sabri Gashi


Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Fakultetin Juridik, profili Juridik Publik, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”.

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Xhemajl Ademaj

Numri i fjalëve: 61,626

Tiranë, Nëntor 2020



DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë, Sabri Gashi, kandidat për gradën shkencore doktor, dorëzoj pranë Universitetit Evropian të Tiranës punimin tim të disertacionit me titull: **“INSPEKTIMI SI INSTRUMENT I KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË POLICINË E KOSOVËS”**, dhe me këtë rast deklaroj me shkrim se studimi im është punë origjinale.

Unë deklaroj se në punimin tim, nuk kam përdorur ide, të dhëna, ose gjuhë të ndonjë subjekti tjetër pa njohjen dhe referencën specifike.

Unë jam plotësisht i vetëdijshëm se kjo deklaratë ka fuqi kontraktuale dhe çdo akt plagjiature, i cilësuar si i tillë nga Komisioni vlerësues i punimit, çon deri në heqjen e të drejtës për të ri dorëzuar punimin në një moment të mëvonshëm.

ABSTRAKTI

Roli dhe forma e organizimit të policisë në të gjitha shtetet është me rëndësi shumë të madhe për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike si dhe për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Në kuadër të këtij punimi studimor shtjellohet organizimi dhe roli i policisë në disa shtete, organizimi dhe roli i policisë në Kosovë si dhe institucionet e kontrollit policor në Kosovë. Po ashtu janë shtjelluar edhe format e organizimit të policisë në disa shtete të botës, historiku i policisë në Kosovë nga shpallja e pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912 e deri te ndërhyrja e trupave të KFOR-it, në Kosovë më 12 qershor 1999, mandej trajtohet krijimi i Shërbimit Policor të Kosovës, detyrat e policisë së republikës së Kosovës dhe në fund të këtij punimi trajtohen institucionet e kontrollit si komisioni parlamentare për siguri si mekanizëm i kontrollit parlamentar ndaj segmenteve të sigurisë në përgjithësi dhe me theks të veçantë i policisë së Kosovës dhe historiku i Inspektoratit Policor të Kosovës, detyrat e tyre dhe autorizimet e inspektorëve policor dhe fushat të cilat inspektohen nga inspektorët.

Arsyeja e përcaktimit për trajtim të kësaj teme bazohet në atë se publikime shkencore për policinë si një segment me rëndësi për luftimin e kriminalitetit nuk ka mjaftueshëm në Kosovë, si dhe duke pasur parasysh natyrën e punës të cilën e kryejnë pjesëtarët e policisë, iu ekspozohen për çdo ditë rreziqeve të natyrave të ndryshme dhe kryerjes së punëve me natyrë mjaft sensitive por me rëndësi të madhe për funksionimin e një shteti më motivoi shumë që ti qasem kësaj fushe për trajtim më të thellë.

Përfundimet e këtij studimi përmbajnë konstatimet kryesore mbi organizimet dhe rolin e policive në disa shtete dhe theks të veçante në Kosovë si dhe përfundimet në lidhje me mekanizmat e kontrollit në policinë e Kosovës.

ABSTRACT

The role and structure of the police in all states is of great importance for the preservation of public peace and order and to combat and prevent crime. Within this research paper discussed the organization and role of the police in some countries, the organization and role of the police in Kosovo and institutions of policing in Kosovo. Also they elaborated forms of organizing the police in several countries of the world, the history of the police in Kosovo since the declaration of independence of Albania on November 28, 1912 until the intervention of troops to KFOR in Kosovo on June 12, 1999, then It dealt with the creation of the Kosovo police Service, the duties of the police of the republic of Kosovo and at the end of this paper treated control institutions such as the parliamentary committee on security as a mechanism to control the Assembly on segments of security in general and with particular emphasis on Kosovo police and the history of the police Inspectorate of Kosovo, their duties and powers of the police inspectors and areas inspected by inspectors.

The reason for determining treatment of this subject is based on that scientific publications for the police as an important segment for combating crime there is not enough in Kosovo, and given the nature of the work which accomplishes police was exposed to daily risks of different natures and performing works quite sensitive nature but of great importance for the functioning of a state that motivated me more to access this field for deeper treatment.

The conclusions of this study include the main findings on the organization and the role of police in some countries and particular emphasis on Kosovo and conclusions about the mechanisms of control of police in Kosovo.

FALËNDERIME

Dëshiroj të falënderoj udhëheqësin shkencor prof. ass. dr. Xhemajl Ademaj për motivimin, përkrahjen, këshillat dhe ndihmën e pakursyer që më ka dhënë gjatë gjithë kohës së studimeve.

Gjithashtu, shpreh mirënjohje dhe falënderim për drejtuesit, stafin akademik dhe administrativ të Shkollës Doktorale të Universitetit Europian të Tiranës për përkushtimin e treguar në mbarëvajtjen e studimeve.

Falënderoj personelin e Policisë së Kosovës, në veçanti kolegët: Kolonel Destan Thaçi, Kapiten Shemi Haziri PhD-lektor, Çajup Kajtazin web-dizajn, Rreshter Osman Osmani Webmaster, për bashkëpunimin dhe ndihmën e dhënë në përpunimin dhe sistemin e të dhënave statistikore për qëllime të punimit.

Falënderoj familjen dhe të afërmit për mirëkuptimin dhe përkrahjen morale dhe materiale të treguar gjatë gjithë kohës së studimeve.

LISTA E SHKURTESAVE

DCAF - Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri

KFOR - Kosovo Force

NATO - Organizata e Aleancës Veri Atlantik

FBI - Federal Bureau of Investigation (Byroja Federale e Hetimeve)

OZNA - Odeljak za zastitu naroda (Njësia për Mbrojtjen e Qytetarëve)

UDB - Unutrasnja Drzavna Bezbednost (Shërbimi i sigurimit shtetëror)

UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës

UNMIK - United Nations Mission in Kosovo

PSSP - Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

KS - Këshilli i Sigurimit

BE - Bashkimi Evropian

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

IPK - Inspektorati Policor i Kosovës

PK - Policia e Kosovës

SHPK - Shërbimi Policor i Kosovës

IPCO - Organizata Ndërkombëtare për Bashkëpunim Policor

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës

VIP - Persona me Rëndësi të Veçantë

SHIKS - Shërbimi Inteligjent Komandues i Sigurisë

ZMP - Zyra e Menaxhmentit të Personelit

NJI - Njësia e Inspektimit

SHKB - Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

KLSH - Kontrolli i Lartë i Shtetit

PSO - Procedura standarde e operimit

DPP - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

DRP - Drejtoria Rajonale e Policisë

IIA - Instituti ndërkombëtar i auditivit të brendshëm

K-1, Kuartal (periudha tremujore)

K-2, Kuartal (periudha tremujore)

KAB - Komiteti i auditivit të brendshëm

AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit

EULEX - European Rule of Law Mission in Kosovo

DCAF - Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura

DSP - Drejtoria e Standardeve Profesionale

KPPK - Kodi i Procedurës Penale i Kosovës

KPPPK - Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës

KPK - Kodi Penal i Kosovës

KBD - Komisioni i Brendshëm Disiplinor

KASH - Komisioni për Shpërblime dhe Ankesa

KELDP - Komisioni për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici

KSHPF - Komisioni për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës

OECD - Organisation for Economic Co-operation and Development

Përmbajtje

DEKLARATA E AUTORËSISË	2
ABSTRAKTI	3
ABSTRACT	5
FALËNDERIME	7
LISTA E SHKURTESAVE	8
KAPITULLI I PARË.....	17
1. HYRJE DHE BAZIMI TEORIK	17
1.1. Përmbledhje	17
1.2. Shtrimi i problemit.....	23
1.3. Qëllimi i studimit.....	23
1.4 Burimet e referimit	26
1.5 Hipoteza / hipotezat e punimit.....	26
1.5.1 Hipotezat e përgjithshme	26
1.5.2 Hipoteza e veçantë:	27
1.5.3 Hipoteza ndihmëse	27
1.6 Pyetjet kërkimore të punimit.....	28
1.6.1 Metoda teorike-praktike dhe analitike.....	30
1.7 Mundësitë dhe kufizimet.....	31
1.8 Rëndësia e studimit	31
1.9 Një këndvështrim.....	32
KAPITULLI I DYTË.....	34
2. HISTORIKU I POLICISË	34
2.1 Organizimet e institucionit të policisë në disa shtete në pika të shkurtra	35
2.2 Historiku i policisë në Kosovë	41
2.3 Organizimet policore ndërshtetërore-ndërkombëtare	46
2.3.1 Roli i Interpolit në luftimin e kriminalitetit në Kosovë	46
2.3.2 Organizata e Inteligjencës Europiane - Europol	49

2.3. Format e organizimit të policisë në disa shtete.....	52
2.4 Kuptimi, përkufizimi dhe definicioni i policisë.....	53
2.5. Dizpozitat ligjore lidhur me rolin dhe punën e policisë.....	54
2.5.1. Detyrat më të rëndësishme që i kryen Drejtoria e Policisë janë:.....	55
2.5.2. Misioni i policisë:.....	56
2.5.3. Organizimi dhe struktura e Policisë së Kosovës.....	56
2.6. Kuptimi i menaxherit dhe menaxhimit.....	57
2.6.1. Planifikimi.....	58
2.6.2. Organizimi.....	58
2.6.3. Drejtimi/Lidershipi.....	59
2.6.4. Kontrolli.....	59
2.7. Parimet e punës së policisë.....	60
2.7.1. Etika policore.....	61
2.8. Bashkpunimi i policisë.....	63
2.8.1. Bashkëpunimi me Interpolin dhe Evropolin.....	65
2.9. Krijimi i policisë së kosovës dhe kontrollit policor.....	71
2.9.1. Autorizimet e Përgjithshme të Inspektoratit Policor të Kosovës janë:.....	76
KAPITULLI I TRETË	78
3. VEPRAT PENALE TË KORRUPSION/VËSHTRIM	78
3.1. “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” - Neni 422.....	85
3.2. “Keqpërdorimi i informatës zyrtare” – Neni 423.....	91
3.3. Hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e policisë së kosovës dhe problemet që dalin.....	95
3.3.1. Ndarja e kompetencave për zhvillimin e hetimeve penale ndaj zyrtarëve të PKsë.....	96
3.3.2. Roli i PK-së në hetimet penale të zyrtarëve të saj.....	96
3.3.3. Roli i Inspektoratit Policor në hetimet penale ndaj punonjësve të PK-së.....	98
3.4 Mbikëqyrja dhe kontrolli institucional i policisë së kosovës.....	100
3.5 Administrimi i masave disiplinore në Policinë e Kosovës.....	103
3.6 Shkeljet e rënda disiplinore.....	106
3.7 Shkeljet e lehta disiplinore.....	108

3.8 Roli i institucioneve të mbikëqyrjes dhe të kontrollit.....	110
KAPITULLI I KATËRT	112
4. Inspektimi	112
4.1 Përse është i domosdoshëm inspektimi?	113
4.2 Kush ka nevojë të inspektohet?.....	113
4.3 Kush e reagon inspektimin?	115
4.4 Cilat janë disa nga teknikat kryesore të inspektimit?	117
4.5 Sa është i nevojshëm inspektimi?.....	119
4.6 Çfarë sfidash paraqet inspektimi për të drejtat e njeriut dhe qeverisjen?	119
4.7 Kriteret e papërshtatshme për inspektim.	120
KAPITULLI I PESTË	123
5. KONTROLLI I POLICISË SË KOSOVËS	123
5.1 Institucionet e kontrollit të policisë.....	124
5.2 Format e kontrollit të policisë	125
5.3 Kontrolli i brendshëm	129
5.4 Kontrolli i jashtëm.....	129
5.5 Mjetet e kontrollit- formale të jashtme.....	130
5.6 Kontrolli parlamentar ndaj punës policore.....	131
5.6.1 Komisioni parlamentar për siguri (mbikëqyrja dhe kontrolli parlamentar)	131
5.7 Avokati i popullit.....	133
5.8 Kontrolli e jashtme jo formale	133
5.9 Kontrolli i brendshëm i punës policore.....	134
5.9.1 Kontrolli i veprimeve të policisë bëhet në dy mënyra:.....	134
5.9.2 Mekanizmat mbikëqyrës në kuadër të policisë	135
5.10 Inspektorati policor i Kosovës (inspektimi dhe hetimi i shkeljeve të rënda disiplinore) .	137
5.10.1 Ligji nr. 03/l-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.....	141
5.10.2 Analizë rasteve të hetuara nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)	144
5.11 Roli i institucioneve të mbikëqyrjes dhe kontrollit.....	151
5.11.1 Mekanizmat e kontrollit të brendshëm të Policisë së Kosovës	154

5.11.2 Roli i Inspektoratit Policor të Kosovës në kontrollin e jashtëm të PK-së.....	156
5.11.3 Autorizimet e inspektoratit policor të Kosovës	158
5.11.4 Llojet e inspektimeve në inspektoratin policor të Kosovës	158
5.11.5 Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë së Inspektimit	162
5.11.6 Definimi i misionit të Inspektimit	165
5.11.7 Detyrat dhe përgjegjësitë:	168
5.11.8 Identifikimi i njesisë së Auditimit dhe Inspektimit	172
5.12 Procedura standarde e operimit - njësia e inspektimit	172
5.12.1 Detyrat dhe përgjegjësitë e Shefit të Njesisë së Inspektimit.....	175
5.12.2 Detyrat dhe përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të Njesisë së Inspektimit.....	176
5.12.3 Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarëve të Njesisë së Inspektimit.....	178
5.13 Kontrolli dhe auditimi i brendshëm.....	180
5.14 Objektivat e auditimit brendshëm.....	186
5.15 Çfarë është Kontrolli i Larte i Shtetit (SAI)	188
5.16 Pavarësia e organizatës	191
5.17 Llojet e auditimeve të brendshme.....	191
5.17.1 Zhvillimi historik i auditimit	194
5.17.2 Çfarë është auditimi i brendshëm	195
Përbërësit e kontrollit të brendshëm	204
5.18 Veprimtaria e punës në periudhën 2008 të Njesisë së Inspektimit dhe Aditimit:	207
5.18.1 Vizioni dhe misioni.....	208
5.18.2 Përgjegjësia dhe Kontrolli i Policisë	208
5.18.3 Realizimi i planit -statistika e inspektimit	212
5.18.4 Aktiviteti i Inspektoratit policor të Kosovës – 2008.....	214
5.18.5 Aktiviteti i njesisë së inspektimit - 2009	215
5.19 Njësia e Auditimit të Brendshëm.....	221
5.20 Drejtoria e standardeve profesionale.....	221
5.20.1 Statistikat për vitin 2012.....	222
5.20.2 Statistikat për vitin 2013.....	224
5.20.3 Statistikat për vitin 2014.....	225

5.20.4 Statistikat për vitin 2015.....	227
5.20.5 Statistikat për vitin 2016.....	229
5.20. 6 Statistikat për vitin 2017	231
5.21 Inspektimi	233
5.21.1 Inspektime të jashtëzakonshme	252
5.22 Njësia e auditimit.....	256
5.23 Komisioni i brendshëm disiplinor	256
5.24 Komisioni për ankesa dhe shpërblime.....	257
5.25 Drejtoria e standardeve profesionale.....	257
KAPITULLI I GJASHTË	260
6. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	260
6.1 Konkluzionet	260
6.2 Përfundime të përgjithshme rreth studimit	263
6.3 Rekomandimet	268
Literatura- Bibliografia.....	277

Tabelat

Tabela 1. Aktiviteti i Njësisë së Inspektimit – 2008	213
Tabela 2. Pasqyra tabelore e rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2008	213
Tabela 3. Numri i automjeteve të kontrolluara gjatë vitit 2008	214
Tabela 4. Numri i zyrtarëve policorë të inspektuar gjatë vitit 2008.....	214
Tabela 5. Objektivat e realizuara për vitin 2009	216
Tabela 6 Tabela e inspektimeve të rregullta + rekomandime-2009.....	217
Tabela 7 Inspektime të rregullta – rekomandime-anagram.....	217
Tabela 8. Inspektime të Jashtëzakonshme+rekomandime -2009.....	218
Tabela 9. Inspektime të jashtëzakonshme + rekomandime anagram.....	218
Tabela 10. Inspektime të jashtëzakonshme + rekomandime.....	219
Tabela 11. Auditime + rekomandime 2009.....	219
Tabela 12. Auditime + rekomandime.....	220
Tabela 13. Rekomandimet nga auditimet e vitit 2009	220
Tabela 14. Lëndë të pranuar nga IPK-ja Janar - Dhjetor (2009-2010).....	221
Tabela 15. Hetimet e Brendshme Janar - Dhjetor (2009 - 2010)	221
Tabela 16. Numri i Paraqitjeve të disiplinës Interne dhe Ankesave të Qytetarëve	222
Tabela 17. Statistika e lëndëve të administruara	222
Tabela 18. Lëndë te pranuar - 2012.....	222
Tabela 19. Lloji i Masave disiplinore për vitin 2012	223
Tabela 20. Llojet e akuzave (shkeljeve) disiplinore për vitin 2012	223
Tabela 21. Statistikat për vitin 2013	224
Tabela 22. Lloji i Masave disiplinore për vitin 2013	224
Tabela 23. Llojet e akuzave (shkeljeve) disiplinore për vitin 2013	225
Tabela 24. Statistikat për vitin 2014	225
Tabela 25. Lloji i Masave disiplinore për vitin 2014	226
Tabela 26. Llojet e akuzave (shkeljeve) disiplinore për vitin 2014	226

Tabela 27. Statistikat për vitin 2015	227
Tabela 28. Lloji i Masave disiplinore për vitin 2015	228
Tabela 29. Llojet e akuzave (shkeljeve) disiplinore për vitin 2015	228
Tabela 30. Statistikat për vitin 2016	229
Tabela 31. Lloji i Masave disiplinore për vitin 2016	229
Tabela 32. Llojet e akuzave (shkeljeve) disiplinore për vitin 2016	230
Tabela 33. Statistikat për vitin 2017	231
Tabela 34. Lloji i Masave disiplinore për vitin 2017	231
Tabela 35. Llojet e akuzave (shkeljeve) disiplinore për vitin 2017	232
Tabela 36. Masat disiplinore të rekomanduara dhe të shqiptuara	232
Tabela 37. Hetimet Preliminare të trajtuara në periudhën (janar – dhjetor)	232
Tabela 38. Statistika e lëndëve të hetimeve të brendshme për vitin 2010 – krahasimi.....	233
Tabela 39. Statusi i lëndëve të Hetimeve të Brendshme	233
Tabela 40. Objektivat e realizuara për nëntë muajt e vitit 2011	233
Tabela 41. Objektivat e realizuara për gjashtë muajt e parë të vitit 2011	235
Tabela 42. Statistikat e inspektimeve në vitin 2013.....	237
Tabela 43. Statistikat e inspektimeve në vitin 2012.....	237
Tabela 44. Objektivat e realizuara për gjashtë muajt e parë të vitit 2011	238
Tabela 45. Statistikat lidhur me implementimin e rekomandimeve të Auditimit	239
Tabela 46. Forma tabelore e krahasimit të raportit vjetor të vitit 2014 / 2013.....	241
Tabela 47. Forma e krahasimit të raportit vjetor të vitit 2014 / 2013	241
Tabela 48. Forma tabelore e krahasimit të raportit 12-mujor të vitit 2014 2015 - 2014..	242
Tabela 49. Forma tabelore e krahasimit të raportit 12-mujor të vitit 2014/2015.....	243
Tabela 50. Forma tabelore e krahasimit të raportit 12-mujor të vitit 2015/2016.....	243
Tabela 51. Forma tabelore e krahasimit të raportit 12-mujor të vitit 2015/2016.....	245
Tabela 52. Forma tabelore e krahasimit të raportit vjetor 2017/2016	245
Tabela 53. Forma tabelore e krahasimit të raportit vjetor 2017/2016	246
Tabela 54. Objektivat e realizuara për vitin 2011	247
Tabela 55. Statistikat lidhur me implementimin e rekomandimeve të Auditimit të	249
Tabela 56. Tabela e inspektimeve 2012.....	252

Tabela 57. Objektivat e realizuara për periudhën Tetor – Dhjetor të Vitit 2012	253
Tabela 58. Të dhënat statistikore lidhur me vlerësimin e implementimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga njësitë e audituara të PK-së për periudhën tetor – dhjetor 2012.....	254
Tabela 59. Të dhënat statistikore lidhur me vlerësimin e implementimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga njësitë e audituara të PK-së për periudhën janar – dhjetor 2012.....	256
Tabela 60. Komisioni i Brendshëm Disiplinor vlerëson sa ka përmbushur objektivat e përcaktuara për vitin 2012.....	256
Tabela 61. Objektivat që ka përcaktuar për vitin 2012 dhe krahasimi me vitin 2011	257
Tabela 62. Statistika e hetimeve të brendshme	257
Tabela 63. Statistika e hetimeve të së kaluarës	258

KAPITULLI I PARË

1. HYRJA DHE BAZIMI TEORIK

Lënda e kësaj teme do të bazohet në dy rrafshë. Rrafshi i parë do të elaborohet në aspektin teorik të temës, duke përfshirë historikun e kontrollit në disa shtete demokratike, historikun e kontrollit të brendshëm në Kosovë, kontrollin e brendshëm policor në Policinë e Kosovës, misionin, qëllimin, anët pozitive dhe negative, mënyrën dhe llojet e kontrollit. Në rrafshin e dytë do të trajtohet një statistikë e kontrollit të brendshëm të Policisë së Kosovës në ngritjen e performancës në Policinë e Kosovës.

Këtë temë e kam zgjedhur pikërisht për një arsye apo mundësisë që të njoftohemi me këtë lëndë se si mund të arrihet një performancë pozitive tek punonjësit institucionalë, joinstitucionalë, pse jo edhe te zyrtarët policorë në lëmin e sigurisë, e cila është si alfa dhe omega për një punë të shëndoshë, për një sistem të shëndoshë dhe demokratik, preventivë e drejtpërdrejtë në parandalimin e keq menaxhimit, keq veprimit, humbjen e imazhit institucional, si në aspektin e brendshëm ashtu edhe atë ndërkombëtar.

1.1. Përmbledhje

Në këtë punim janë prezantuar format e kontrollit dhe mbikëqyrjes ndaj punës policore dhe kryesisht ato janë ndarë në dy kategori, të brendshme dhe të jashtme. Të dy këto forma të kontrollit janë shumë të nevojshme dhe të domosdoshme dhe përgjithësisht shumica e shteteve e pranojnë këtë ndarje. Këtu theks të veçantë i është kushtuar kontrollit së brendshme që bëhet brenda për brenda policisë. Unë them se sa më i fuqishëm dhe profesional të jetë kontrolli e brendshëm policor aq më profesionale dhe etike do të jetë puna policore. Kjo nënkupton që policia duhet të krijojë dhe përgatisë kuadro të afta, të edukuara, të arsimuara për të qenë në gjendje të krijoj dhe funksionalizojnë standarde të forta të punës policore dhe standarde të larta të etikës policore.

Bazuar në gjithë problematikën dhe çështjen mjaftë komplekse të punës policore dhe nevojës për kontroll dhe mbikëqyrje të mirëfilltë ndaj punës policore dhe bazuar në të dhënat e cekura në këtë punim mund të nxjerrin disa konkluzione dhe të paraqesin rekomandimet për arritjen e qëllimeve me sukses të kontrollit ndaj punës policore.

Në këtë punim jam munduar që në pika të shkurta të përshkruaj rolin e policisë në përgjithësi duke u fokusuar në historikun e policive të disa shteteve, kuptimin, nocionin, misionin, organizimin, punët, detyrat autorizimet si dhe etikën policore në parandalimin e kriminalitetit në përgjithësi dhe në sigurinë e brendshme në veçanti. Se, i çfarë rëndësie është misioni i policive të shteteve por edhe policisë së Kosovës është shtjelluar më lartë dhe besoj se ky punim do t'i ndihmoj sa do pak studenteve të Fakultetit Juridik, dega Kriminalistikë por edhe të shkencave të sigurisë që të kanë njohuri më të mëdha me policinë në përgjithësi dhe sigurinë në veçanti. I përkujtoj studentët e ardhshëm se sa e rëndësisë se veçante është që një shtet të ketë një polici demokratike, profesionale dhe të pa korruptuar, e gatshme gjithëherë t'iu dalë në ndihmë qytetarëve të vet, sepse policia është në shërbim të tyre. Mos të harrojmë historinë e hidhur që pushteti serb me forcat e tij policore bëri ndaj popullatës së pambrojtur shqiptare që nga viti 1912 deri 1999. Duhet ta dimë se puna policore është e shenjtë dhe ajo duhet çmuar, por theksoj se puna policore e një policie demokratike, profesionale, e paanshme, me etikë dhe moral të fortë është ajo që i duhet një shoqërie. Në rast të rrezikimit të shtetit nga ana e agresorit të jashtëm, policia hyn nën komandën e forcës ushtarake të vendit në mbrojtje të vendit, pavarësisht prej pretendimeve, qëllimeve dhe se çfarë formash të agresionit ndërmerr armiku vetëm e vetëm që të mbrojë sovranitetin e vendit, popullin e saj në situata të tilla.

Roli i policisë në të gjitha shtetet është i një rëndësie të madhe në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike, në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, institucion me rëndësi specifike në strukturat e sigurisë të sistemit juridik të shteteve përkatëse. Andaj edhe në vendin tonë janë marrë si model apo për bazë përvojat e policive më bashkëkohore dhe më profesionalitet në ndërtimin e policisë së Kosovës. Treguesi më i mirë për këtë

konstatim, është performanca e Policisë së Kosovës në raport me policitë e shteteve në rajon. Organizimi i policisë në shumicën e vendeve të cilat janë trajtuar gjatë këtij punimi është pothuajse i ngjashëm me disa dallime të vogla në formën e organizimit ku disa shtete kanë organizim të ndarë në dy, tre apo katër nivele. Por konsiderojmë se këto ndarje më shumë i takojnë aspekteve të realizimit të punëve praktike policore brenda për brenda shteteve, varësisht nga ajo se si është strukturuar ndarja e brendshme e sistemit policor, se sa kanë në fakt ndonjë dallim thelbësor në organizimin e sistemeve policore të trajtuara. Policia e Kosovës ka akceptuar një formë të organizimit të saj, të atillë që funksionimin e policisë e ka të ndarë në nivel qendror (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës) dhe nivel lokal (Drejtoritë Rajonale), mandej në kuadër të regjioneve bëjnë pjesë stacionet dhe nën/stacionet përkatëse. Çështje tejet me rëndësi që duhet të potencohet është se policia e Kosovës ka vetëm një zinxhir komandues unik, i cili gjendet në Drejtorinë qendrore në Prishtinë. Kontrolli i policisë në përgjithësi është çështje mjaft ndjeshme por e domosdoshme dhe shumë e rëndësishëm, ngase policia si një mekanizëm i rëndësishëm i shtetit nëse nuk ka kontroll mundet lehtë të devijoj nga qëllimi i sajë. Pikërisht për këtë arsye edhe zbatohen forma të ndryshme të kontrollit ndaj policisë pa të drejtë të ndërhyrjes në çështjet e operative të sajë dhe pa penguar kryerjen e punëve policore.

Kontrolli edhe pse shpesh nënkuptohet si diçka negative në këtë punim jam përpjek që të paraqes pozitivitetin e kontrollit në ngritjen e standardeve profesionale të punës policore dhe vetëm shikuar në këtë aspekt kontrolli ndaj punës policore ka perspektiv të zbulimit dhe korrigjimit të veprimeve joprofesionale policore. (Në shumë raste zyrtarët policor por edhe personeli tjetër policor kanë përshtypje se kontrolli-inspektimi ka misionin apo

qëllimin e ndërmarrjes së procedurave administrative ose penale, e që është e kundërta, kontrolli-inspektimi ka qëllimin e ngritjes së performanës dhe integritetit i cili ngritë imazhin në misionin e vet policisë).

Në punim janë prezantuar format e kontrollit dhe mbikëqyrjes ndaj punës policore dhe kryesisht ato janë ndarë në dy kategori: të brendshme dhe të jashtme. Këto dy forma të kontrollit janë shumë të nevojshme dhe të domosdoshme dhe përgjithësisht shumica e shteteve e pranojnë këtë ndarje. Këtu theks të veçantë i është kushtuar kontrollit të brendshme që bëhet brenda për brenda policisë. Mund të themi se sa më i fuqishëm dhe profesional që të jetë kontrolli i brendshëm policor aq më profesionale dhe etike do të jetë puna policore. Kjo nënkupton që policia duhet të krijojë dhe përgatisë kuadro të afta, të edukuara, të arsimuara për të qenë në gjendje të krijojnë dhe funksionalizojnë standarde të forta të punës policore dhe standarde të larta të etikës policore.

Me kontroll dëshirohen të arrihen shumë qëllime që janë paraqitur nga shumë autorë si: identifikimi, verifikimi, vërtetimi, krahasimi i rezultateve të vërtetuara me ato të pritura, mbikëqyrjen, analizimi, përshtatjen e veprimeve me qëllim që puna e kontrolluar të kthehet në rrethana normale.

Një nga konstatimet më të vërtetua, thuhet, gjithnjë, të kontrollosh do të thotë të kesh situatën në dorë, por nëse analizohet kjo thënie nuk përshtatet në të gjitha rrethanat. Definicioni më i pranuar në krahasimin e rezultateve të vërtetuara me ato të pritura i thënë nga M.H. Fayol Mohler, “me kontroll do të thotë të konstatuarit se a janë operacionet punuese në çdo kohë duke u zhvilluar në bazë të planeve të pranuar, me urdhëresat e dhëna dhe parimeve të vendosura”. Definicioni më i plotë merret ai i Glaser Comstock,

sipas tij “kontrolli krahason, shqyrton, kritikon, stimulon planifikimin, thjeshtëson dhe forcon organizatën, ngritë suksesin”.

Bazuar në rreziqet e shekullit të ri në lidhje me kërcënimet për zbatuesit e ligjit nënkuptojnë rrethanat dhe mundësit e reja të shkeljeve të drejtave dhe lirive të njeriut si pasojë e ndërmarrjes së masave policore për parandalimin dhe luftimin e krimit (sidomos krimit të organizuar e në veçanti terrorizmit).

Shikuar në problematikën dhe kauzën komplekse të punës policore dhe nevojës për kontroll dhe mbikëqyrje të mirëfilltë ndaj punës policore, bazuar në të dhënat të nxjerra në këtë studim-hulumtim, mund të nxjerrim disa konkluzione, të paraqesin rekomandimet për arritjen e qëllimeve me sukses të kontrollit ndaj punës policore.

Është prioritet i shoqërisë që të krijojë dhe në vazhdimësi të zhvillojë mekanizma të përshtatshëm për të përcjellë, kontrolluar, kërkuar përmirësimin, korigjimin dhe eliminimin e dobësive.

Domosdoshmëri e institucioneve shtetërore është që të angazhojë personel te mjaftueshëm për një mbikëqyrje dhe një kontrollë serioze, profesionale, kompetente, vepruese dhe realizuese.

Infrastruktura ligjore në fuqi që rregullon punën policore duhet të jenë të kompletuara në mënyrë që mos të lejohet të ketë zbrazëtira ligjore apo mundësi e shumëllojshmërisë së interpretimit të autorizimeve policore.

Policia në ushtrimin e autorizimeve ligjore duhet të ketë gjithmonë parasysh mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Shteti me mekanizmat e veta të kontrollit duhet të pozicionohet në mbrojtjen e pa kompromis të të drejtave dhe lirive të qytetarëve nga veprimet policore. Për të qenë

efektshmëria e duhur dhe nevojshme Organizata policore duhet të krijojë mekanizma të përhershëm të kontrollit dhe mbikëqyrjes të punës policore.

Menaxhmenti policor duhet që me vet iniciativë të fillojë kontroll të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të aktiviteteve policore, kështu që këtë iniciativë mos ta merr vetëm atëherë kur dikush tjetër ka iniciuar.

Organet shtetërore duhet të tregohet të kujdesshëm në përmbushjen e kërkesave për mirëqenën të punonjësve të policisë për të parandaluar korrupsionin apo veprimet tjera devijuese nga punonjësit e policisë.

Policia duhet të bashkëpunoj ngushtë me institucionet shtetërore dhe jo shtetërore dhe veçanërisht me shoqërinë civile, mediat, gjykatat, prokurorit etj.

Udhëheqësit policor nuk duhet të i injoroj veprimet e pa matura të policisë.

Sistemi disiplinor duhet të rregullohet në atë mënyrë që të krijohet besimi në drejtësi si nga qytetarët ashtu edhe nga vetë punonjësit e policisë.

Nga të autorizuarit duhet të krijohen mekanizma të drejtë dhe transparent të kontrollit ndaj punës policore për qytetarët dhe institucionet tjera.

Eprorët policor duhet të kujdesen për zbatimin në përpikëri të misionit dhe vizionit të përcaktuar për policinë si dhe mundësoj punonjësve trajnime permanente në fushën e zbatimit të ligjit.

1.2. Shtrimi i problemit

- Trajtimi dhe studimi i mirëfilltë të problemeve që janë instrument kyç për një mbikëqyrje të plotë në parandalimin e keq menaxhimeve, keqpërdorimeve në institucione dhe shoqëri në përgjithësi.
- Ky studim ka për qëllim që të japë një trajtim kuptimplotë me rëndësinë e kontrollit në përgjithësi.
- Pse është e rëndësishme së veçantë që të ketë kontroll në çdo aspekt dhe çka do të arrihet me kontroll.
- Çfarë pasoja do të ketë shoqëria në përgjithësi pa kontroll të mirëfilltë, a do të ketë anarki totale në institucione dhe shoqëri, sa do të rritet kriminaliteti, sa do të humbë shoqëria nëse nuk ka kontroll të situatave të tilla.

1.3. Qëllimi i studimit

Qëllimi i studimit është që në mënyrë shkencore të bëjë një studim në aspektin e kontrollit të brendshëm gjithnjë duke u bazuar në atë se është një temë specifike e rrallë në shoqëri, dhe pa një njohuri të caktuar në këtë lëmi është e kotë që personeli i caktuar në kontroll të brendshëm do të ketë sukses, por as organizatat, institucionet, por edhe vetë shoqëria në përgjithësi nuk do të jetë e qëndrueshme, si në rrafshin ekonomik, pse jo edhe politik dhe të sigurisë.

Me këtë punë synojmë, hulumtimin e shkaqeve veprave penale të kryera nga pjesëtarët e policisë, shkeljeve disiplinore, identifikimin dhe adresimin i sfidave në hetimin e rasteve e posaçërisht në parandalimin e tyre. Pas kësaj të bëjmë një analizë dhe vlerësim kritik për funksionimin dhe efikasitetin institucional eksizitues, si të jashtëm ashtu edhe të brendshëm.

E veçanta e këtij studimi është adresimi i sfidave konkrete, perspektivës për të ardhmen e Policisë së Kosovës, në menaxhimin e personelit, në forcimin e integritetit profesional dhe në rritjen e efikasitetit të mekanizmave të kontrollit dhe të mbikëqyrjes së zyrtarëve policorë. Studimi përpiqet të ofrojë ide dhe mundësi të reja, që do të shërbejnë në aspektin praktik për menaxhim sa më efektiv të personelit, për ta ndihmuar Policinë e Kosovës në përmbushjen e misionit të vet.

Një kontribut i veçantë i këtij studimit do të jetë ndikimi në vendimmarrje, planifikim strategjik, planifikimin e veprimeve për forcimin e integritetit policor, përmirësimin e procedurave të rekrutimit, seleksionimit dhe trajnimit të personelit. Krahas këtyre, studimi do të jetë një ndihmë edhe për ekspertët dhe profesionistët e kësaj fushe, si edhe për studiuesit e tjerë akademikë.

Bazuar në rëndësinë që ka kontrolli i brendshëm, personalisht jam fokusuar në këtë temë që sa më shumë të kem njohuri, me të cilën me këtë punim të jap një kontribut për gjeneratat e ardhshme.

Duke u bazuar se me vet formimin e institucioneve, organizatave, veprimtaritë institucionale, bizneseve, fitimprurëse, kodeve të sjelljes, etikës njerëzore dhe profesionale, është e panevojshme që për funksionim të drejtë ligjor, parimor, procedural, etik, menaxherial etj., në kuadër, por edhe jashtë, të formohen njësi, departamente, drejtori, si për kontroll të brendshëm, ashtu edhe të jashtëm, që do të ndikojë dukshëm në cilësinë, rregullin, profesionalizmin, menaxhimin e mirë, ngritjen e performancës, motivimin, por pse jo edhe ndëshkimin e atyre të cilën veprojnë në kundërshtim me Ligjet, aktet nënligjore, parimet dhe procedurat.

Vet kontrolli ka historinë e vet, që nga formimi i shoqërisë, shtetit, organizatave, organeve shtetërore, formimin e klasave punëtore dhe sistemeve sipas historisë. Qysh në këto kohëra ka qenë e nevojshme që për punë, funksion të organizatave, organeve, institucioneve shtetërore ka qenë e nevojshme që të ketë një organ mbikëqyrës, e ai ishte kontrolli.

Në çdo shoqëri ka pasur dyshime për moszbatim të ligjshëm të punëve-detyrave, obligimeve, autorizimeve, keqpërdorimeve, keq menaxhime, shkelje të kodit të etikës-sjelljes, deri te pasurimet e kundërligjshme. Për këto veprime negative inkriminuese, vetë shoqëria, shteti sipas historisë dhe sipas organizimit strukturor ka formuar ekipin, njësinë, drejtorinë etj., por qëllimi ka qenë që kjo njësi të kryejë punët dhe detyrat e kontrollit të brendshëm, por edhe të jashtëm. Qëllimi i formimit të kontrollit ishte dhe është të mbrojë interesat e institucionit deri te shteti, pse jo edhe jashtë shtetit, kur ka të bëjë edhe me krimet trans - nacionale.

1.4 Burimet e referimit

Burimet e referimit janë nga aspekti teorik, gjithnjë duke u bazuar në literatura historike, bashkëkohore dhe analitike, duke u bazuar në procedurat standarde të operimeve të kontrollit të brendshëm, pa anashkaluar, ligjet dhe aktet nënligjore. Kurse, nga aspekti analitik, fokus të veçantë është funksioni i kontrollit të brendshëm në Policinë e Kosovës.

1.5 Hipotezat e punimit

1.5.1 Hipotezat e përgjithshme

Hipoteza e përgjithshme është: inspektimi-kontrolli i brendshëm si resor i domosdoshëm për funksionalitetin e institucioneve shtetërore-publike.

Hipoteza e përgjithshme qëndron në kërkesën që ka kjo temë, e cila ka rëndësinë, mënyrën e veprimit dhe qëllimin që ka kontrolli i brendshëm në shoqëri, pa anashkaluar kontrollin e brendshëm policor në ngritjen e performancës, e sidomos ngritjen e imazhit në aspektin e sigurisë.

Kontrolli i brendshëm luan rol të veçantë në ngritjen e performancës dhe një funksionim pozitiv demokratik të mirëfilltë tek punonjësit gjatë kryerjes së punëve të përditshme, sipas autorizimeve ligjore që i kanë. Luan një rol preventiv tek punonjësit në përgjithësi në arritjen e objektivave për një punë profesionale, me etikë të nivelit të lartë, por edhe luan rol represiv duke rekomanduar që ndaj punonjëseve që nuk i përmbushin standardet profesionale të ndërmerren masa ligjore dhe administrative.

1.5.2 Hipoteza e veçantë:

Njësia e Inspektimit në Policinë e Kosovës, e cila kryen inspektim dhe kontroll të brendshëm në Policinë e Kosovës, e cila rekomandon dhe është udhërrëfyes për tërë organizatën e Policisë së Kosovës, por nuk ka autoritet ekzekutiv sipas hierarkisë organizative aktuale.

Si hipotezë të veçantë është marrë funksionimi i Kontrollit të brendshëm në institucione shtetërore në Kosovë në veçanti inspektimet - kontrolli i punës policore në Policinë e Kosovës në periudhën kohore të cekur më lart.

Duke potencuar se në cilat akte ligjore e nënligjore, por edhe parimeve dhe procedurave bazohet autorizimi dhe kompetencat e njësisë - kontrollit, llogaridhënia, raportimet, konkluzionet, rekomandimet, kujt i dërgohen planifikimet javore, mujore, tremujore dhe vjetore, statistikat e kontrollit të kryera, si ato të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

1.5.3 Hipoteza ndihmëse

Një analizë e mirëfilltë duke u bazuar në përmbushjen e misionit të kontrollit të brendshëm policor në Policinë e Kosovës. Vetë kandidati është pjesëtar i Policisë së Kosovës dhe zyrtar i Njesisë së inspektimit – kontrollit të brendshëm në Policinë e Kosovës, do të përdorë të gjitha të dhënat e mirëfillta analitike dhe kërkimore në lidhje me temën.

1. 6 Pyetjet kërkimore të punimit

- Në aspektin teorik do të fokusohem dhe do të mundohem që të shërbehem me literaturë të mjaftueshme, që ka të bëjë me tematikën e kontrollit të brendshëm;
- Në aspektin analitik do të fokusohem se në cilat institucione dhe ku do të kërkoj të dhënat burimore dhe statistikat në përgjithësi;

- Pse jam fokusuar apo kam zgjedhur këtë temë;
- Cila është rëndësia e instrumentit të inspektimit dhe roli i saj në cilësinë e kontrollit të brendshëm në kualitetin e shërbimit?
- Si është e strukturuar instrumenti i inspektimit në Policinë e Kosovës?
- Sa kanë ndikuar raportet e inspektimit në cilësinë e shërbimeve?
- Sa janë marrë në konsideratë rekomandimet e inspektimit nga ana e menaxhmentit të Policisë?

Sa kanë ndikuar raportet e rregullta dhe ato të jashtëzakonshme të inspektimit në avancimin e shërbimeve?

Çka do të arrihet në fund të përfundimit të punimit të temës shkencore, por paraprakisht do të përpiloj:

- a) Cilat burime do të përdoren me rastin e kërkimit dhe punimit të temës,
- b) Cilët faktorë tjerë do të përfshihen në hulumtim apo kërkim.

Për të filluar me punimin e disertacionit jam përgatitur si fokus i veçantë ka qenë që të gjejë literaturë dhe material të mjaftueshëm si teorik ashtu burime praktike e të cilat do të shërbenin për temën e punimit doktoral, si burime parësore dhe dytësore, literaturë, legjislacioni vendas dhe i huaj, dokumente dhe raporte të institucioneve të ndryshme të sidomos të Kosovës. Më pas u morëm me planifikimin dhe strukturimin e temës (formimin e skeletit të punimit) , formulimin e pyetjeve kërkimore, hipotezën e veçantë. Në fund, pas analizës së të dhënave u bë trajtimi dhe përpilimi i temës, si dhe u nxorën përfundimet dhe rekomandimet, me të cilat mbyllet studimi. Të dhënat sasiore për studimin e veprave penale të kryera nga punonjës të policisë janë siguruar nga raportet statistikore të PK-së dhe IPK-së, përmes të cilave u studiuan trendi i veprave penale në

vite, llojet e veprave të raportuara, numri i zyrtarëve të PK-së të përfshirë në to etj. Shqyrtimi i një numri vendimesh gjyqësore të marra ndaj zyrtarëve të PK-së të gjykuar ka shërbyer për të parë llojin e veprave, si dhe politikën ndëshkimore të ndjekur nga gjykatat. Për të njohur perceptimin e vetë zyrtarëve të PK-së për çështjet etike, integritetin, korrupsionin dhe për veprat penale të kryera nga zyrtarët policorë është përpiluar një dokument i emruar “plani i integritetit” i cili ndan fushat e rrezikut në pesë grupe me tregues integriteti: aspektet organizative, kultura organizative, rreziqet dhe cenueshmëritë specifike, prokurimi, komunikimi e informimi. Janë identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e integritetit të çdo fushe, dhe mbi këtë bazë janë propozuar masat përmirësuese.

Për punimin e kësaj teme, që të mbetet e kapshme edhe për të tjerët, zgjedhëm dhe përdorëm këto metoda:

Metoda juridike është zgjedhur dhe zbatuar në këtë punim doktoral për të pasqyruar infrastrukturën ligjore në fushën e veprave penale të korrupsionit zyrtar. Aplikimi i saj ka qenë mjaft i përshtatshëm për temën, sepse mundësoi pasqyrimin e karakteristikat juridiko-penale të veprave penale në fushën e korrupsionit zyrtar, të politikave ndëshkimore, si dhe vështrimin e legjislacionit të disa vendeve me synime të caktuara.

Metoda e analizës është aplikuar për të njohur sa më mirë materien e veprave penale kundër detyrës zyrtare dhe të shkeljeve disiplinore.

Metoda statistikore na ka shërbyer për të evidencuar vëllimin, strukturën dhe dinamikën e shkeljeve disiplinore dhe kryerja e veprave penale veprave penale nga ana e zyrtarëve policor dhe personelit policor e në veçanti të veprave korrupsionit e cila është më e theksuara në çdo shoqëri. Duke marrë për bazë të gjitha statistikatat e mbledhura nga

institucione të ndryshme, përmes kësaj metode kemi realizuar zbërthimin dhe krahasimin e tyre për të bërë matjen e për të parë shkallën dhe përmasat e fenomeneve.

Metoda krahasuese është përdorur për të vënë përballë rregullimin e bërë nga legjislacioni i Kosovës në fushën e veprave penale të shkeljeve disiplinore nga zyrtaret policor.

Ky punim është kompletuar, gjithnjë duke shfrytëzuar metodat e punës së kontrollit të brendshëm në institucione, me theks të trajtimit të veçantë në Policinë e Kosovës.

Me rastin e punimit të temës, kam përdor metodën teorike se si funksionon kontrolli i brendshëm në disa shtete.

1.6.1 Metoda teorike-praktike dhe analitike

Gjatë punimit jam bazuar në teoritë se si në disa shtete demokratike funksionon kontrolli i brendshëm policor dhe si ka ndikuar në ngritjen e performancës në sigurinë e vendit, e gjithashtu duke përdorë praktikën dhe analitiken në Njësinë e Inspektimit në Policinë e Kosovës.

Metodën teorike e kam përdor në aspektin se si në disa shtete funksionon inspektimi – kontrolli në polici.

Kontrollin e brendshëm në Policinë e Kosovës kam përdorë metodën analitike dhe krahasimtare, sepse është metoda më e mirë dhe më konkrete, e cila do të japë një pasqyrë të detajuar dhe të saktë.

1.7 Mundësitë dhe kufizimet

Mundësitë për punim të disertacionit të doktoratës do të jenë të mjaftueshme, duke shfrytëzuar literaturën gjithëpërfshirëse që ka të bëjë me temën: ‘INSPEKTIMI SI INSTRUMENT I KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË POLICINË E KOSOVËS’, por edhe vlerësimi analitik statistikor është i mundshëm për shkak të mirëkuptimit me përgjegjësit e Policisë së Republikës së Kosovës.

Kurse sa i përket hulumtimeve të raporteve të kontrolleve të brendshme nëpër institucione të Kosovës, do t’i realizoj me përpikëri, duke hasur në mirëkuptim me të gjithë, por edhe duke u bazuar në vet rëndësinë e hulumtimit, të punimit të një teme konkrete dhe të nevojshme për mua si kandidat i shkollës doktrate, por edhe për shkolla, kolegje, universitete të ndryshme, pse jo edhe për dobinë e organizatave, organeve, institucioneve dhe shtetit apo edhe shoqërisë në përgjithësi.

Edhe pse në disa raste do të ketë kufizime, sidomos në raporte apo shkresa konfidenciale – sekrete, do të mundohem që sa më saktë, në mënyrë studimore të përfundoj temën me sukses të plotë, së bashku me mentorin tim, i cili pa dyshim do të më ndihmojë në ecurinë dhe mbikëqyrjen e punimit. Kufizim tjetër do të jetë edhe kostoja e kushtueshme e kërkimeve shkencore jashtë Kosovës.

1.8 Rëndësia e studimit

Është e rëndësisë së veçantë punimi apo studimi i kësaj teme, sepse kontrolli në përgjithësi është një temë-lëmi e gjerë. Pa kontroll, funksionimi i organizatave, organeve, institucioneve shtetërore etj., nuk do të ishte dëshirueshëm, apo mos të themi me terme

ekstreme, se nga një rregullim sistemor organizativ hierarkik, do të kalohet në një sistem anarkik, e që nuk do të ketë sukses në asnjë aspekt.

Me kontroll të duhur, shumë nga mangësitë, kryerjet apo moskryerjet e punëve dhe detyrave, shkeljet e ligjeve, parimeve dhe procedurave, do të eliminoheshin.

Me kontroll të mirëfilltë, pa implikime, çdo kund, në çdo vend, do të ketë suksese dhe rezultate. Mu për këtë arsye, kontrolli është shumë pozitiv, sepse është njëri nga faktorët e rëndësishëm të shoqërisë dhe të institucioneve shtetërore në përgjithësi.

1.9 Një këndvështrim

Siguria nuk duhet të jete vetëm synim në vetvete, ajo duhet të shërbejë mirëqenies së njerëzve, sepse vet demokracia shihet në thelbin e saj e lidhur me paqen dhe sigurinë. Për të funksionuar kjo, shtetet krijojnë struktura të ndryshme të sigurisë.

Dihet se shteti është i vetmi aktor në shoqëri që ka monopolin e ligjshëm të forcës dhe autoritetet e forcës japin llogari para autoriteteve të ligjshme demokratike. (Mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë. DCAF- (Komisioni për mbrojtje dhe siguri) buletin i DCAF.2006).

Roli dhe forma e organizimit të policisë në të gjitha shtetet është me rëndësi shumë të madhe për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike si dhe për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Në kuadër të këtij punimi studimor shtjellohet organizimi dhe roli i policisë në disa shtete, organizimi dhe roli i policisë në Kosovë si dhe institucionet e kontrollit policor në Kosovë. Po ashtu janë shtjelluar edhe format e organizimit të policisë në disa shtete të botës, historiku i policisë në Kosovë nga shpallja e pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912 e deri të ndërhyrja e trupave të KFOR-it, në Kosovë më 12 qershor 1999,

mandej trajtohet krijimi i Shërbimit Policor të Kosovës, detyrat e policisë së Republikës së Kosovës dhe në fund të këtij punimi trajtohen institucionet e kontrollit si komisioni parlamentare për siguri si mekanizëm i kontrollit parlamentar ndaj segmenteve të sigurisë në përgjithësi dhe me theks të veçantë i policisë së Kosovës dhe historiku i Inspektoratit Policor të Kosovës, detyrat e tyre dhe autorizimet e inspektorëve policor dhe fushat të cilat inspektohen nga inspektorët.

Arsyeja e përcaktimit për trajtim të kësaj teme bazohet në atë se publikime shkencore për policinë si një segment me rëndësi për luftimin e kriminalitetit nuk ka mjaftueshëm në Kosovë, si dhe duke pasur parasysh natyrën e punës të cilën e kryejnë pjesëtarët e policisë, iu ekspozohen për çdo ditë rreziqeve të natyrave të ndryshme dhe kryerjes së punëve me natyrë mjaft sensitive por me rëndësi të madhe për funksionimin e një shteti më motivoi shumë që ti qasem kësaj fushe për trajtim më të thellë.

Përfundimet e këtij studimi përmbajnë konstatimet kryesore mbi organizimet dhe rolin e policive në disa shtete dhe theks të veçante në Kosovës si dhe përfundimet në lidhje me mekanizmat e kontrollit të policisë në Kosovë.

Historia e policës çon në përfundimin se ajo është një prej shërbimeve më të vjetra të shoqërisë njerëzore, përkatësisht të shtetit. Si forma elementare e kontrollit shoqëror, policia është edhe më e vjetër se vet shteti.

Vështruar në mënyre etimologjike, shprehja polici (anglisht police; gjermanisht polizei; frëngjisht police) rrjedh nga fjala greke polis, politea e cila shënon drejtimin e qytetit, shtetit, kushtetutës. Siç duket edhe nga vetë fjala polis, e cila shënon qytetin-shtetin, në nocionin politesa është paraqitur gjithë veprimtaria shtetërore, ligjdhënëse, gjyqësore dhe

udhëheqja. Ky nocion u ka shërbyer edhe romakëve, të cilët e kanë përdorur si politia. Për Aristotelin, politia paraqet formën ideale të rregullimit shtetëror.

Megjithatë, në esencë, shprehjet politika dhe policia rrjedhin nga shprehja “Politesa”. (Dr. Ramo Maslesha, Policia dhe Shoqëria, Sarajevë/Prishtinë, 2008, faqe 11).

Shfaqja dhe zhvillimi i shkencës moderne mbi administratën ka krijuar hapësirë edhe për lindjen e shkencës mbi policinë. Ndryshimet që kanë ndodhur në shekuj 18 e 19, nën ndikimin e klasës qytetare, si dhe zhvillimi i mendimit politiko-juridik, ka pasur ndikim të theksuar në theksimin e të drejtave qytetare.

Duke pasur parasysh se policia është njëra nga shërbimet më të lashta në shoqërinë njerëzore, respektivisht në shtet, ajo nëpër periudhat e ndryshme historike ka marrë kuptime të zgjeruara dhe divergjente. Sipas burimeve ekzistuese mendohet se fjala “police” së pari është lajmëruar në gjuhën franceze në vitin 1250 (Dr. Haris Halilovic, Dr. Elmedin Muratbegoviq, E Drejta Policore (Ligjërata te autorizuara) faqe 23).

KAPITULLI I DYTË

2. HISTORIKU I POLICISË

Policia në të gjitha vendet e botës për të qenë sa ma efikase në luftën kundër krimit në përgjithësi dhe në veçanti atij të organizuar, bashkëpunon, ndërton mekanizma të përbashkët për të luftuar sa më mirë dhe në mënyrë më efikase fenomenet kriminale. Varësisht nga rrethanat nëpër të cilat kanë kaluar shtetet edhe sistemet policore të tyre nuk

kanë qenë imune ndaj ndikimeve të cilat janë shfaqur në ndërtimin e policive të tyre në aspektin e ndërtimit të sistemeve policore të brendshme, duke ndikuar në ndërtimin e sistemeve policore liberale apo më pak liberale. (Prof. Mr. sc. Haziri Fatos, E Drejta e Policisë. 2007. Fq. 19).

2.1 Organizimet e institucionit të policisë në disa shtete në pika të shkurtra

Në vijim do të elaborojmë disa nga organizimet e policive të shteteve ballkanike duke u nxjerr në pah pikat e përbashkëta dhe ato ndarëse ndërmjet këtyre sistemeve policore të cilat do të cekën në vazhdim:

Policia e Shqipërisë është institucion i administratës shtetërore, e cila ka për mision të mbrojë rendin dhe sigurinë publike, si dhe të garantoj zbatimin e ligjit. Policia e shtetit të Shqipërisë sipas ligjit është institucion i administratës publike, strukturë e Ministrisë së Brendshme. Për të realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në bazë të ligjit, policisë iu janë dhënë kompetencat në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike, hetimin dhe zbulimin e veprave penale dhe kryesve të saj. Policia në Shqipëri është njëra nga institucionet kyçe që merret me ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, ofrimin e sigurisë për të gjithë qytetarët dhe hetimin e veprave penale dhe të kryesve të saj.

Kontrolli i brendshëm policor në Shqipëri ka edhe rolin ekzekutiv duke u fokusuar në atë se ata kanë të drejtën e arrestimit dhe shoqërimin në objektet policore dhe Gjykata-prokurori. (Dr. Bajram Yzeiri, Menaxhimi i Policisë, Tiranë, 2003, faqe 17).

Misioni i SHKB-së (Shërbimi i kontrollit të brendshëm):

Misioni i SHKB-së është t'i garantojë komunitetit një shërbim policor të përgjegjshëm dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara".

Tre shtyllat ku mbështetet veprimtaria e SHKB-së

1. Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi paraprak i veprave penale të kryer nga punonjësit e policisë së shtetit, pavarësisht nga funksioni dhe grada.
2. Inspektimi i punës së të gjitha strukturave të Policisë së Shtetit, për përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara, për garantimin e përgjegjshmërisë, efektshmërisë dhe efikasitetit të tyre.
3. Kryerja e testit të integritetit për punonjësit e Policisë së Shtetit, i cili konsiston në aplikimin e teknikave dhe metodave që shërbejnë për verifikimin e etikës dhe integritetin e një punonjësi të Policisë së Shtetit.

"Kontribuoni në luftën kundër korrupsionit, duke e denoncuar atë".

“Denonconi çdo rast të sjelljeve të këqija të punonjësve të policisë shtetit, kudo që ndodheni”. Për këtë Shteti ju siguron se do të ruajnë fshehtësinë dhe menjëherë do të gjenden pranë jush deri në sqarimin e plotë të problemit që ju do të keni, duke goditur me forcë dhe pa hezitim rastet kur punonjës të veçantë policie abuzojnë me detyrën duke kryer veprime të kundërligjshme dhe korruptive, që cenojnë etikën dhe imazhin e Policisë së Shtetit.

SHKB-ja disponon fond buxhetor të posaçëm për të shpërblyer personat që denoncojnë korrupsionin.

Policia e Sllovenisë është e organizuar në katër nivele. Niveli i parë i Ministrisë së Punëve të Brendshme, pastaj Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, pasojnë Drejtoritë

Regjionale dhe Stacionet Policore. Policia Sllovene është e themeluar me qëllim të ruajtjes së sistemit politik, demokratik, juridik e kushtetues shtetëror dhe për të mbrojtur liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Mbi bazën e kësaj ndarje në katër nivele të funksionimit të policisë sllovene vërehet qartë se sistemi policor në këtë shtete është i decentralizuar dhe i bartur në nivele më të ultë. (Prof. Mr. sc. Haziri Fatos, E Drejta e Policisë. 2007).

Policia e Kroacisë është shërbim policor publik i Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila i ushtron punët policore të përcaktuara me ligj. Format themelore organizative janë dy: Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoritë e policisë, për të kryer detyrat me efikasitet formohen edhe Drejtoritë e policisë rajonale dhe stacionet policore. Për policinë përdoren emërtime të ndryshme si institucion, por rëndësia dhe funksionet janë të njëjta apo të ngjashme në të gjitha vendet e botës. (Prof. Mr. sc. Haziri Fatos, E Drejta e Policisë. 2007).

Policia e Hungarisë është pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, por karakteristik e këtij shteti është se zbatimi i ligjit ndahet ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Financave, në të parën bëjnë pjesë shërbimi policor dhe policia kufitare, ndërsa në Ministrinë e Financave është i vendosur shërbimi doganor dhe shërbimi tatimor. Puna e policisë në Hungari është e organizuar në tri nivele: Niveli shtetëror (shtabi), nivelet regjionale dhe nivelet lokale të funksionimit të policisë. (Prof. Mr. sc. Haziri Fatos, E Drejta e Policisë. 2007).

Zhvillimi i sistemit policor në SHBA ka pasur gati fazën identike të zhvillimit të cilën e ka karakterizuar veprimin policor në Angli. Format e para të veprimit të organizuar të

policisë janë bazuar në vendet verilindore. Mirëpo, në Boston për herë të parë janë formuar patrullat e natës – rojet, me 1636.

Patrulla të ngjashme, por me emrin “patrulla shëtitëse”, janë formuar në Nju Jork më 1658. Detyra e tyre, në një masë të konsiderueshme ka dalluar kundruall seksioneve të policive të formuara në veri dhe në lindje të vendit. Duke realizuar veprimtarinë patrulluese në orët e natës, patrulla është angazhuar për zgjidhjen e problemit të sigurimit të qytetarëve.

Ndërkaq, forma e këtyllë e organizimit të patrullave, vërehet edhe në Filadelfia, e cila u themelua në vitin 1700. Sipas shembullit që ekzistonte në Angli, nëpunësit policorë ishin të pa aftë, duke iu dhënë alkoolit, derisa gjatë kohës që duhej të kryheshin aktivitete të patrullimit gjatë orëve të natës, ata flinin, vërehej mos interesimi gjithnjë e më prezent për çështje të sigurimit, etj.

Pa përgjegjësinë ata e kanë shprehur edhe me rastin e ndëshkimeve të individëve për shkaqe të shkeljeve të lehta me mbajtje të kujdestarisë (rojës), duke e sjellë në këtë mënyrë shërbimin deri në shkallën e formalizmit të rëndomtë. Situata e tillë ka imponuar nevojën e vënies së rojeve të ditës.

Kështu, roja e parë ditore është formuar më 1833 në Filadelfia, kurse më 1844 në Nju Jork ka filluar të mbahet shërbimi me forca të policisë ditore. Përbërjen e theksuar policore e kanë përfaqësuar 16 policë, kurse forcat policore të natës i kanë bërë 12 kapedanë, 24 ndihmës të kapitenëve dhe 1096 rojtarë.

Në vitin 1844, pushteti i Nju Jorkut ka miratuar Ligjin sipas të cilit policia ditore dhe ajo e natës, me një numër prej 800 anëtarëve, vihet nën komandën e shefit të policisë, të cilin

e zgjidh krye bashkiaku i qytetit me bekimin e Këshillit. Radhitja e këtillë e policisë ka imponuar shumë çështje që kishin të bëjnë me kontroversat lidhur me uniformën, si dhe a duhet të armatohet përbërja policore, duke i autorizuar që të përdorin shkallën gjegjëse të masave të dhunës me qëllim të burgosjes së suksesshme të shkelësve të rendit.

Për dallim nga qytetarët, pjesëtarët e policisë kanë shprehur pakënaqësinë për shkak të kërkesave të theksuara për bartjen e uniformës. Ata kanë konsideruar se uniforma, përkatësisht, bartja e saj gjatë realizimit të shërbimit policor, ka përcaktime nënçmuese, duke i bërë ata më të vërejtur në rrugë.

Këtë periudhë e karakterizon bartja dhe përdorimi i armëve të zjarrit në mjediset urbane, gjë e cila gjendjen e sigurisë e ndërlikon edhe më shumë.

Meqë nuk ishin sa duhet të aftësuar në aspektin profesional për paraqitje operative kundruall të gjitha formave të dhunës, policët nuk kanë qenë në gjendje të japin vlerësime të rëndësishme të cilat do të udhëzonin në metodologjinë e ndërmarrjes së masave gjegjëse në rrethana të caktuara. Për këtë arsye kanë qenë të detyruar të bartin armë zjarri, sado që dispozitat dhe opinioni publik nuk ua ka lejuar këtë. Në këtë mënyrë, në SHBA gjithnjë e më shumë është praktikuar bartja e armëve gjatë kryerjes së punëve të policisë.

Kritikat dhe qëndrimet antagoniste rreth uniformës dhe armatimit, edhe një kohë të gjatë kanë qenë prezentë, aq më parë kur qytete të mëdha policia ka qenë në shënjestër të qytetarëve për shkak të konflikteve të ndërsjella, gjë e cila nuk ka lënë përshtypje të volitshme si sistem unik policor. Këto raporte edhe me shumë i ka ngarkuar edhe mënyra e ndryshimit dhe plotësimit të diçka seksioneve me kuadro të paafte dhe joprofesionale.

Përbërja e tanishme e organizatave policore në SHBA, është shprehje e aspekteve pikërisht të përmendura, struktura organizative e të cilave është rrjedhojë e organizatave

dhe e karakterit të sistemit politik, gjegjësisht, e pushtetit shtetëror. Në këtë kuptim mund të themi se karakteri i organizimit të pushtetit në të gjitha nivelet me autonomi të theksuar e, posaçërisht, pabarazia në nivelet e vetëqeverisjes lokale, të niveleve të qarqeve e qyteteve, kanë bërë atë që edhe SHBA-të të mos kenë organizatën unike policore. Përveç kësaj, gjendja heterogjene ligjore e policore, gjeneron antagonizma në mes të shërbimeve të caktuara, gjë e cila shkakton probleme të reja në pikëpamje të organizimit e funksionimit.

Në aparatën policore të SHBA-ve hyjnë organizatat policore në nivel të qeverisë federale. Nevoja e organizimit të policisë në nivel federal të natyrës së shoqërisë amerikane, të urbanizimit të shpejtë, të specifikave të mëdha sociale, të paraqitjes së dislokimit të të gjitha formave të veprave më të rënda të kriminalitetit të organizuar, etj, sikundër edhe në shtimin e funksioneve shtetërore.

Në nivel të qeverisë federale janë instaluar institucionet policore në kompetencë të Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Jurisprudencës, të Drejtorisë së Shërbimit Postar, sikundër edhe Mareshalët Federal, e që më tutje kemi:

Organizatata policore të shteteve të caktuara federale

Organizatata policore të qarqeve (3.000 qarqe)

Organizatata policore në qytete – 10.000 qytete të mëdha dhe 1.000 qytete të vogla, dhe

Organizatata policore në më shumë se 15.000 lokalitete e fshatra.

Në SHBA për shkak të cekurave më lartë ka qenë e domosdoshme të formohen edhe Njësi për kontrollin e policisë se shtetit është organizuar sipas shteteve federale, të cilat kanë pasur mënyrën e kontrollit po thuajse të ngjashëm dhe është quajtur Inspektion, audit and

review (Dr. Frank Harris, The Role of Capacity – Building in Police Reform, Prishtinë 2005, Inspektimi, auditimi dhe kontrolli).

Kryerja e detyrave të tjera, të cilat me ligj i janë caktuar Shërbimit Policor të Kosovës (UNMIK, 2005: 3)

Detyrat dhe përgjegjësit e SHPK-së janë përcaktuar duke u mbështetur në Kodin Evropian të Etikës Policore, i cili përcakton kornizën ligjore të policisë nën sundimin e ligjit.

Policia është organ publik që duhet të themelohet me ligj. Operacionet policore gjithmonë duhet të kryhen në pajtim me ligjin kombëtarë dhe standardet ndërkombëtare të pranuar nga shteti. Legjislacioni që udhëheqë policinë duhet të jetë i qasshëm për publikun dhe mjaftueshëm i qartë dhe preciz, dhe nëse është e nevojshme, i mbështetur nga rregullore të qarta po ashtu të qasshme nga publiku.

2.2 Historiku i policisë në Kosovë

Historiku i policisë në Kosovë, do të trajtohet prej periudhës së shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntori 1912, kur territori i Kosovës mbeti jashtë kufijve zyrtarë të Shqipërisë. Vendi ynë mbeti nën sundimin serbë për një periudhë të gjatë prej 28 nëntor 1912, e deri më 12 qershor 1999, kur forcat e Organizata e Aleancës Veri Atlantik (NATO), duke bombarduar nga ajri, për shtatëdhjetë e tetë ditë rresht e detyruan Serbin që të nënshkruaj tërheqjen e ushtrisë serbe, nga Kosova. Pranuan kapitullimin dhe hyrjen e forcave të NATO-së, që do të quheshin “Kosova Force” (KFOR).

Gjithashtu Kosova pas luftës së dytë botërore kundër vullnetit të popullit shumicë, u aneksua nga ish-republika federative popullore e Jugosllavisë.

Sipas kushtetutës së asaj kohe, të vitit 1946, Kosova ishte e definuar si njësi autonome territoriale-administrative brenda Serbisë, e quajtur “Çarku Autonom i Kosovës”. Kosova nuk e kishte statusin e krahinës, të cilën e kishte Vojvodina në atë kohë. Kosova ishte në pozitë shumë të pa volitshme dhe ishte e diskriminuar në të gjitha aspektet. Në disa periudha kohore, pas viteve 1974, pozita e shqiptarëve në Kosovë fillon të përmirësohet në polici, për të filluar që të keqësohej, me suprimimin e autonomisë së Kosovës në muajin mars 1989. Gjatë periudhës kur, Kosova ishte nën sundimin serbë, punët e policisë në Kosovë, më shumë janë ushtruar në formë të dhunës, nënshtrimit, represionit, fyerjes, dhe arrestimeve pa ndonjë bazë ligjore.

Brenda kësaj periudhe të errët kishte qëllime të intensitetit të ushtrimit të dhunës. Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, në muajin mars 1989, filluan burgosjet me aktakuza të montuara deri te vrasjet pa gjyq.

Të gjitha këto i bënin me qëllim që të shqiptarët shumicë, të mbjellin ndjenjën e pasigurisë dhe frikës, ti detyronin të lëshonin trojet dhe të mërgonin në ndonjë vend fqinjë, apo në shtetet e Evropës perëndimore.

Si rezultat i kësaj gjendje, në mënyrë brutale shkeleshin lirit dhe të drejtat e njeriut dhe bëhej një diskriminim i madh ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Vlen të theksohet se në vitin 1946 pas luftës së dytë botërore me urdhër të Josip Broz Titos ish kryetar i ish Jugosllavisë u formua OZNA (Odeljak za zashtitu naroda – Njësia për mbrojtjen e qytetarëve), e cila ka kryer punët policore. Më 1966 OZNA u shndërrua në UDB (Unutrashnja drzhavana bezbednost – siguria e brendshme e shtetit), e cila ishte famëkeqe për popullin shqiptar. Këtu mund të cekim dhunën – rasti i aksionit të armëve në kohën e A. Rankoviqit, shpërnguljen masive në vende tjera si Turqi etj.

Burgosjen, vrasjet, pushkatimet, të cilin aktivitet UDB e vazhdoi pandërprerë, por me forma dhe metoda të ndryshme.

Një hap i parë i cili mundet të konsiderohej si një dritë në fund të tunelit, në atë kohë drejt përmirësimit të pozitës së popullatës shqiptare, sa i përket përfaqësimit në strukturat e policisë së asaj kohe është hapja e shkollës së policisë në Vushtrri në vitin 1970. Ky ishte një hap i madh drejt hapave të tjerë, për përmirësimin e pozitës së shqiptarëve në polici. Pozitë pak më e avancuar në historinë e policisë, ishte periudha pas vitit 1970, e deri në vitin 1989 përfaqësimi i shqiptarëve në polici ishte më i mirë.

Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës struktura nacionale e policisë filloi të ndryshohej në mënyrë drastike në favor të nacionalitetit serb në Kosovë.

Suprimimi i autonomisë së Kosovës në muajin mars të vitit 1989, dhe masat e dhunshme që i zbatoi regjimi i kriminelit Sllobodan Millosheviçit, detyruan shumicën e policëve shqiptarë të braktisin punën. Përveç një numër, shumë i vogël që vazhduan të punojnë për pushtetin e atëhershëm dhe kundër popullit të vet, të cilët quheshin kolaboracionist “bashkëpunëtor”.

Kjo ndikoi që tani, strukturat policore të pushtuesit ishin, edhe më të lira që të veprojnë kundër popullatës shumicë, dhe të kryejnë torturime, burgosje, rrahje dhe vrasje ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Me aprovimin e Ligjit nr.03/L-035 për Policinë nga Kuvendi i Kosovës, shfuqizohet Rregullorja nr. 2005/54 mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës e aprovuar nga PSSP-ja sipas së cilës policia njihej si SHPK dhe përcaktonte pushtetin e PSSP-së mbi SHPK-në. “Shërbimi Policor i Kosovës do të funksionojë nën autorizimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe nën kontrollin dhe

mbikëqyrjen e Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut (UNMIK, 2005:3). Kurse Ligji i nr.03/L-035 për Policinë, neni 4 themelimi i policisë përcakton:

‘Me anë të këtij ligji themelohet Policia e Republikës së Kosovës si shërbim publik në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, policia është person juridik dhe policia do të veprojë nëpërmjet zinxhirit të unifikuar komandues në tërë Republikën e Kosovës’. (Ligji për Policinë, 2008:2).

Me aprovimin e Ligjit i nr.03/L-035 për Policinë, PK-ja themelohet si Polici e Kosovës dhe nuk është më tutje nën kompetencat e Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut. Kjo në fakt ka qenë edhe qëllimi i këtij ligji.

Qëllimi i këtij Ligji është themelimi i Policisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme policisë), përshkrimi i autorizimeve dhe i detyrave të saj, përcaktimi i strukturës organizative, rregullimi i çështjeve të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës. (Ligji për Policinë, 2008: Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të policisë të përcaktuara me nenin 10 të ligjit për policinë).

Nga kjo shihet se detyrat e policisë të përcaktuara me Ligjin i nr.03/L-035 për Policinë dhe Rregullorja nr. 2005/54 mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës në parim nuk ndryshojnë. Për më tepër edhe me ligjin aktual për policinë Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të policisë të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji janë thuajse plotësisht të njëjta me ligjin e kaluar:

Më 06.09.1999 Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Organizata Evropiane për Siguri dhe Bashkëpunim (OSBE) në Qendrën e Trajnimeve të Policisë filloj me gjeneratën e parë të policisë në të cilën kanë qenë të përfshirë 187 (njëqind e tetëdhjetë e shtate) kadet, ndër ta është edhe mentori i kësaj teme dr. Xhemajl Ademaj me

numër identifikues 0001, pra kadeti dhe zyrtari i parë i Policisë së Kosovës, dhe kandidati i kësaj teme me numër të kadetit dhe zyrtarit policor 0049. Pas trajnimeve tetë javore në Vushtrri u caktuan në punë dhe detyrat e shpërndara në tërë Kosovën, në të cilën gjeneratë kanë qenë të përfshirë etnitë dhe gjinitë e ndryshme.

Policia e Kosovës organizohet në nivel qendror dhe lokal. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është nivel qendror përgjegjës për tërë Republikën e Kosovës.

Niveli lokal përfshin Drejtoritë Rajonale të Policisë përgjegjës për rajonet e përbëra nga komunat e caktuara, stacionet policore që janë përgjegjëse për policinë lokale në secilin komunë dhe nënstacionet policore të cilat janë përgjegjëse për policinë lokale brenda zonave të caktuara të një komune.

Duke analizuar ligjin për policinë e Republikës së Kosovës shihet qartë se ka dy nivele të funksionimit të policisë, niveli qendror dhe rajonal, ku në kuadër të rajoneve bëjnë pjesë stacionet policore dhe nënstacionet policore të policisë së Kosovës. Varësisht prej sistemit juridik dhe të organizimit shtetëror kemi edhe format e organizimi policor. (Prof. Mr. sc. Haziri Fatos, E Drejta e Policisë. 2007. fq 29).

Mirëpo, pas Luftës së Dytë Botërore shihej qartë se çështjet e dinamizmit të jetës në përgjithësi, si dhe automatizimi i teknikës e teknologjisë, do të zhvillohet edhe më shumë në të ardhmen, pa dyshim ka shtruar nevojën e organizimeve të ndryshme në asociacione ndërmjet shteteve rajonale dhe mbarë botërore siç janë: Evropoli, Interpoli, me qëllim të luftimit të kriminalitetit trans-nacional sa ma lehtë që është e mundur.

2.3 Organizimet policore ndërshtetërore-ndërkombëtare

Shtetet nëpërmjet institucioneve të tyre policore dhe institucioneve tjera që merren me çështjen e sigurisë organizohen dhe koordinohet ndërmjet vete, si dhe ndihmojnë njëra tjetrën në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit me qenie njerëzore si dhe kontrabandimit të gjësendeve me vlera të larta materiale. Ky koordinim bëhet nga ana e këtyre organizmave të cilët janë ndërtuar enkas për këtë çështje si Evropoli dhe Interpoli, në vijim do t'i elaborojmë më gjerë:

2.3.1 Roli i Interpolit në luftimin e kriminalitetit në Kosovë

Para vitit 2008, Interpol-i ka vepruar në Kosovë në kuadër të misionit të Kombeve të Bashkuara, UNMIK, në bazë të Rezolutës R/1244 të Këshillit të Sigurimit.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, aktiviteti i degës së Interpol-it në Kosovë ka vepruar si i ndarë dhe tani parashikohet të jetë në kuadër të strukturës organizative të Policisë së Kosovës. Kjo nuk është aktualizuar ende, për shkak të pengesave lidhur me statusin e Kosovës në OKB. Megjithatë, Interpol-i funksionon në Kosovë, në kuadër të degës së UNMIK-ut dhe ka dhënë një kontribut të çmuar në luftimin e krimit në Kosovë. Kosova, edhe pse ende nuk është anëtare e shumë organizatave ndërkombëtare, pra, as e Interpol-it, ka zhvilluar e zhvillon bashkëpunim të rregullt në fushën e policisë, si me Interpol-in, dhe nëpërmjet tij edhe me shtetet e rajonit, në bazë të marrëveshjeve bilaterale që ka nënshkruar.

Zyra e Interpol-it në Kosovë ka lidhje të ngushta me Drejtorinë për Luftimin e Krimeve të Rënda në Policinë e Kosovës dhe rezultatet e këtij bashkëpunimi nuk kanë

munguar. Vetëm gjatë vitit 2008 janë hetuar bashkërisht 35 raste dhe janë zhvilluar shumë aktivitete hetimore me theks të veçantë në rrafshin e BNP. Përmes Interpolit janë bërë 285 konfirmime (Raporti Vjetor i PK-së, 2008:13). Ndhmën e zyrës ndërlidhëse të Interpolit e ka pasur edhe Njësia për Hetimin e krimeve të luftës, duke dhënë kontribut sidomos në zbulimin dhe identifikimin e viktimave të luftës në Kosovë. Kjo zyrë ka ndihmuar, gjithashtu, edhe në luftimin e krimit me karakter ndërkombëtar në Kosovë, përmes një bashkëpunimi efikas. (Raporti vjetor i PK-së, 2008:13).

Aktivitetet e Zyrës ndërlidhëse të Interpol-it në Kosovë kanë qenë të fokusuar, gjithashtu, në kërkesat e proceduara ndër vite. Në vitin 2009 kanë qenë 5432 kërkesa, ndërsa në vitin 2010 ishin 5300. Kërkesa ka pasur edhe për shpalljen e personave të kërkuar (2, në vitin 2009 dhe 24, në 2010); për ekstradimet (5, në vitin 2009 dhe 5, në vitin 2010), si dhe për gjetjet e veturave (59, në vitin 2009 dhe 51, në vitin 2010) (Raporti vjetor i PK-së, 2010: 27).

Me këtë bashkëpunim të frytshëm të zyrës së Interpol-it me Policinë e Kosovës, me pamundësinë e kësaj të fundit për të komunikuar drejtpërdrejt me institucionet ndërkombëtare, si Interpol dhe Evropol, Policia e Kosovë has në shumë pengesa në luftimin e formave të ndryshme të krimit. Konkretisht, edhe pse Kosova bashkëpunonte me Interpol-in përmes UNMIK-ut, ajo nuk ka mund të shfrytëzojë bazën e të dhënave EASF ose baza të tjera të të dhënave, që i ka dhe i shfrytëzon Interpol-i.

Bazuar në pengesa, Qeveria e Republikës së Kosovës ka si prioritet dhe objektiv të saj edhe anëtarësimin në Interpol. Ajo ka aplikuar për pranimin e saj në këtë organizatë, duke u asistuar për këtë edhe nga ILECU, i cili ka ndihmuar në formulimin e kërkesës së Kosovës për anëtarësim në Interpol. Pasi këtë kërkesë e nënshkroi kryeministri i Kosovës,

ajo u dërgua në Lion, nga Ministria e Punëve të Brendshme, përmes kanaleve të vetë Interpol-it. Në datat 8-10 qershor 2015 Komiteti Ekzekutiv në Lion është mbledhur për këtë çështje, por pa epilog pozitiv për Kosovën.

Interpoli është organizata më e madhe ndërkombëtare e policisë dhe më e rëndësishmja, ideja për themelimin e kësaj organizate për herë të parë u paraqit nga Shoqata Ndërkombëtare për të Drejtën Penale, në Hamburg të Gjermanisë më 1905. Në Kuvendin e përgjithshëm të komisionit për bashkëpunim policor ndërkombëtar në vitin 1956 u aprovua statuti i ri, dhe u akceptua emërtimi i ri Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminalistike – INTERPOL, selia e së cilës gjendet në Paris. Nëpërmjet këtyre asociacioneve është mundësuar luftimi më efikas i kriminalitetit përmes bashkëpunimeve ndërmjet shteteve, me qëllim të shkëmbimit të informatave dhe ofrimit të ndihmës reciproke ndërmjet shteteve, për të lehtësuar hetimin dhe kapjen e kryerësve të veprave penale, pa marrë parasysh vendin ku gjenden apo ku kanë kryer veprën penale kryesit.

(Prof. Dr. sc. Latifi, Vesel. Kriminalistika, Prishtinë. 2006. fq 21, Bogoljub Milosavljeviç, Nauka o policiji” Mr Fitim Shishani, Roli i Policisë në Parandalimin e Kriminalitetit, Prishtinë, 2006).

2.3.2 Organizata e Inteligjencës Evropiane - Evropol

Evropol është një organizatë mjaft e re. Ideja e krijimit të një agjencie të specializuar të Inteligjencës Evropiane për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar policor u hodh në fillim të viteve nëntëdhjetë (Martenczuk, 2008: 368) dhe, në vitin 1992, në Traktatin e Mاستrihtit

për Unionin Evropian, u miratua themelimi i Evropol-it. Zyra Qendrore, Drejtoria e Evropol-it ndodhet në Hagë, të Holandës.

Themelimi i Evropolit është miratuar në traktatin e Mاستrihtit për Unionin Evropian më 1992. Fillimisht e përfshirë vetëm në luftën kundër drogës, organizata ka zhvilluar detyrat e saj dhe tani merret me krimet, tema bazike e të cilave është paraparë në konventën e Evropolit, e cila ka hyrë në fuqi më 1998 (Madsen, 2009: 98-99)

Në zhvillimin e Evropol-it mund të identifikohen tri faza. Faza e parë, përfshin periudhën nga viti 1999 deri në vitin 2006. Në këtë kohë, kjo organizatë që e përfshirë vetëm në luftën kundër drogës dhe bashkëpunimi i policive ende dominohej kryesisht nga marrja e vendimeve ndërqeveritare. Për këtë arsye dhe, për shkak të origjinës ndërqeveritare të strukturave të bashkëpunimit të policisë që i paraprinë Evropol-it, roli i Parlamentit Evropian në mbikëqyrjen e tij ishte i kufizuar.

Në një fazë të dytë, nga viti 2006 deri në vitin 2009, korniza ligjore e Evropol-it u ndryshua krejtësisht dhe një vendim i Këshillit të Evropës, i 6 prillit 2009, e transformoi Evropol-in, nga 1 janari 2010, në një agjenci të BE-së, që financohet nga buxheti i Komunitetit Evropian dhe jo nga kontributet e shteteve anëtare, siç e përcaktonte Konventa e Evropol-it.

Faza e tretë është në vazhdim e sipër. Në këtë fazë do të përcaktohet e ardhmja e Evropol-it (Crum & Fossum, 2013:88). Tani, një rregullore e re ka zëvendësuar Vendimin e Këshillit, me qëllim zbatimin e dispozitave të reja të Traktatit të Lisbonës, sidomos, duke iu referuar pjesëmarrjes së parlamenteve kombëtare dhe Parlamentit Evropian në monitorimin politik të agjencisë.

2.3.2.1. Roli dhe struktura e Zyrës Policore – Europol

Zyra Evropiane e Policisë (Europol) është një organizatë policore ndërkombëtare, e cila u formua për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit në BE, me 1993 dhe me fillimin e operacioneve të njësisë së drogave të Evropolit në vitin 1994 (Occhipinti, 2003: 51), në mënyrë që të parandalohet dhe të luftohet kriminaliteti i rëndë ndërkombëtar. I përshtatur brenda kontekstit të Traktatit të Bashkimit Europian, mandati i Europol-it përfshin luftimin e të gjitha formave të rënda të krimit ndërkombëtar, duke përfshirë edhe terrorizmin ndërkombëtar (Deflem, 2006: 336). Europol nuk u krijua për t'u marrë me vepra lokale apo të vogla, por për të dhënë një dimension evropian për hetimin e krimit (Cools, et al, 2010: 63). Ndërsa organizatat e tjera ndërkombëtare policore janë formuar jashtë kontekstit të ndonjë organi politik ndërkombëtar, mandati i Europol-it ka një specifikë, ai është përcaktuar në mënyrë të qartë nga BE-ja dhe operacionet e saj mbikëqyren nga organet rregullatorë të BE-së. Megjithatë, pavarësisht nga fakti se Europol-i është themeluar brenda strukturave politike dhe ligjore të BE-së, është argumentuar dhe provuar se organizata ka tipare të rëndësishme të ekspertizës profesionale, të ngjashme me ato që i karakterizojnë organizatat e tjera ndërkombëtare policore (Deflem, 2006: 336).

Objektivat e Europol-it janë që të përmirësojë efektivitetin dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve policore të vendeve anëtare të BE-së. Në përputhje me to, edhe mandati i tij është zgjeruar dhe tani Europol-i merret me një gamë të gjerë të luftimit të formave të ndryshme të kriminalitetit. Numri i nismave për bashkëpunim policor dhe gjyqësor në Bashkimin Evropian, për çështjet kriminale, është mbresëlënëse. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit (1999) ky set politikash u ristrukturua nën termin “Zona e Lirisë,

Sigurisë dhe Drejtësisë” (Qesaraku, 2008: 4). Kontributi i Evropolit jepet në dy forma të veçanta bashkëpunimi: Aktivitetet e ekipeve hetimore të përbashkëta dhe pjesëmarrja e tij në këto aktivitete (Cools, et al, 2009: 329). Megjithatë, korniza ligjore e Europol-it është subjekt i një debati të vazhdueshëm, lidhur me format e ndryshme në të cilat do të mund të vendosen dispozitat e Traktatit të Lisbonës (Crum & Fossum, 2013: 88).

Evropoli është polici zyrtare e Evropës, e cila është e paraparë edhe me kontratën e Bashkimit Evropian (BE-së), themelimi i këtij forumi policor u bë në vitin 1995 deri më 1999 dhe selia e tij gjendet në Hagë të Holandës. Përmes Evropolit shtetet anëtare të BE-së synojnë që zyrat kundër krimit të përmirësojnë dhe të nxisin bashkëpunimin për mbrojtje dhe luftim të terrorizmit, të tregtisë me drogë ilegale dhe luftimin e formave të rënda të kriminalitetit ndërnacional. Evropoli ndryshe njihet edhe si polici Evropiane e cila ka për qëllim luftimin e kriminalitetit në shtetet e Evropës, si dhe ka për qëllim parandalimin e krimeve dhe zbulimin e kryesve. Pra me fjalë të tjera merret me luftimin e kriminalitetit duke ndihmuar në dhënien e informacioneve të cilat do të ishin të dobishme në luftë kundër krimit. (Mr. Sc. Fatos Haziri, E Drejta e Policisë, 2010, faqe 147).

2.3 Format e organizimit të policisë në disa shtete

Në librin e autorit “Bogoljub Milosavljeviç, Nauka o policiji” përmenden këto forma të organizimeve policore dhe në shkencë, e cila i studion çështjet nga lëmi i policisë:

- * Sistemi i Centralizuar i cili aplikohet në Itali dhe Rusi;
- * Sistemi i Decentralizuar dhe i Koordinuar i cili aplikohet në Britaninë e Madhe, Holandë, Kanada, Gjermanin, Indinë etj.;
- * Sistemi Unik i Koordinuar i cili aplikohet në Francë, Finlandë etj.;

* Sistemi i Decentralizuar i Thjeshtë i cili aplikohet në Zvicër, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Belgjikë;

* Sistemi Unik i Centralizuar i cili aplikohet në Slloveni, Irlandë, Maqedoni, Estoni, Letoni, Shqipëri, Kroaci etj.

Në bazë të strukturës organizative, dhe ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive për pjesëtarët e policisë, sipas parimeve dhe procedurave në bazë të cilave vepron policia. Sa i përket formës së funksionimit të policisë së Kosovës, konsideroj se policia e Kosovës si organizatë policore më shumë shkon nga sistemi unik i centralizuar, i cili aplikohet dhe në shtetet fqinje si Shqipëria, Maqedonia dhe Sllovenia.

Në kuptimin organizativ, policia e Britanisë së Madhe është ndërtuar mbi baza rreptësishtë të decentralizuara. Qeveria është një strukturë e përbërë prej ndryshimeve shumë të theksuara dhe kjo paraqet një shembull eklatant të decentralizimit të strukturës organizative. Ajo, para së gjithash, kushtëzohet nga rregullimi politik, gjegjësisht nga rregullimi i pushtetit shtetëror, nga proceset zhvillimore historike dhe nga ndarja administrative. Kështu, organizimi i policisë është bërë në pajtim me organizmin territorial, sipas rrethanave administrative. Në këtë kuptim, mund të flitet për disa nivele të organizmit të forcave të policisë, e këto janë: Policia e rretheve (grafovive), Policia e qyteteve të mëdha, Policia e kombinuar, Policia metropolitane, Shërbime tjera të policisë. (Mr Fitim Shishani, Roli i Policisë në Parandalimin e Kriminalitetit, Prishtinë, 2006, faqe 24).

2.4 Kuptimi, përkufizimi dhe definicioni i policisë

Shfaqja dhe zhvillimi i shkencës moderne mbi administratën ka krijuar hapësirë edhe për lindjen e shkencës mbi policinë. Ndryshimet që kanë ndodhur në shekuj 18 e 19, nën ndikimin e klasës qytetare, si dhe zhvillimi i mendimit politiko-juridik, ka pasur ndikim të theksuar në theksimin e të drejtave qytetare. (Prof. Mr. sc. Haziri Fatos, E Drejta e Policisë. 2007. fq.27).

Policia është organ shtetëror që kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, për mbajtjen e rendit dhe të qetësisë publike si dhe për sigurimin e rendit të caktuar juridik. Një kohë të gjatë nocioni i policisë është njëjtësuar me kuptimin e administrimit të brendshëm, duke përfshirë aktivitetin e tërësishëm shtetërorë, përveç gjyqësisë dhe ushtrisë. Më vonë, në kohën e zhvillimit të shteteve borgjeze, aktiviteti policor kufizohet në punët e brendshme, respektivisht vetëm në ato dukuri të cilat paraqesin rrezikshmëri për rendin publik.

Nocioni polici, në kuptimin më të gjerë, nënkupton sistemin e trupave të veçanta të administratës së brendshme, të cilat, për kryerjen e detyrave të fushëveprimit të tyre, përdorin edhe mjetet e detyrimit institucional.

Në kuptimin objektiv, policia është strukturë mbrojtëse (garantuese) e rendit publik, e cila e kryen funksionin e saj mbrojtës me mjete të detyrimit. Në kuptimin funksional, kryesisht, është pranuar ndarja e policisë në polici administrative (drejtuese) dhe në polici kriminalistike (gjyqësore) (Modly, Karajliq, 2002: 455).

2.5 Dispozitat ligjore lidhur me rolin dhe punën e policisë

Sipas Miletiqit, policia ka katër funksione në shoqërinë bashkëkohore:

Funksion drejtues,

Funksion penal,

Funksion kundërvajtës, dhe

Funksion normativ.

I njëjti autor thekson se:

Policia e realizon funksionin e saj drejtues me kryerjen e aktiviteteve drejtuese (grupit të punëve drejtuese) nga fushëveprimi dhe kompetencat e saj, të cilat janë të përcaktuara me ligj; (Miletiqi. Nauka o Policiju, Beograd, 2003: fq, 66-88).

Policia e kryen funksionin e saj penal duke u marrë me parandalimin e aktiviteteve penale si edhe me luftimin e aktiviteteve të kryesve të veprave penale;

Policia e realizon funksionin e saj kundërvajtës duke kryer aktivitete që kanë të bëjnë me parandalimin kundërvajtjeve, zbulimin dhe kallëzimin e kundërvajtjes dhe kapjen e dënimit e autorëve të veprave kundërvajtësve që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë;

Policia e ushtron funksionin e saj normativ gjatë kryerjes së punëve nga fushëveprimi i saj, gjegjësisht gjatë interpretimit të rregullave policore, të cilin e bën gjatë zbatimit të tyre. Ajo e bën këtë edhe duke testuar efikasitetin e saj në praktikë. Në praktikë, policia është në situatë që të verifikojë realizimin e objektivave të përcaktuara me normat e miratuara, të verifikojë rolin e këtyre normave dhe të konstatojë se a janë ato norma përkatëse dhe e duhet të ndryshohen.

Objektivat kryesore të Policisë së Kosovës janë:

Të mbrojnë jetën dhe pronën;

Të mbajë rendin dhe qetësinë publike;

Të parandalojë dhe zbulojë krimin;

Të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut;

T'i trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë qytetaret pa dallim, race, ngjyre, religjioni, gjinie dhe moshe. (Ligji për Policinë Nr. 03/L-035 dhe Kodi i Etikës të Policisë së Kosovës, Prishtinë, 2009).

2.5.1 Detyrat më të rëndësishme që i kryen Drejtoria e Policisë janë:

Të përcjellë dhe analizojnë situatën e sigurisë dhe dukuritë që i shkojnë për shtati zhvillimit të kriminalitetit, të organizojë, harmonizojë, orientojnë dhe mbikëqyrë punën e stacioneve të policisë, të marrë pjesë në mënyrë direkte në kryerjen e punëve komplekse nga fushëveprimi i punës së stacionit të policisë, ndërmerr dhe zbaton masat e caktuara në kontrollin e kufirit dhe bën sigurimin e kufirit shtetëror, ndërmerr masa për mbrojtjen e personave dhe objekteve të caktuara, i kryen punët tjera të caktuara me dispozita të veçanta. (Kodi i Procedurës Penale të Kosovës).

2.5.2 Misioni i policisë:

Mision themelor i policisë është edhe vet strategjia e sigurisë kombëtare që do të thotë: ushtrimi i sovranitetit- mbrojtjen e Kushtetutës, mbrojtjen e pavarësisë dhe integritetin territorial, mbrojtjen e jetës dhe pasurisë, zhvillimin e pandërprerë demokratik dhe

prosperitetin ekonomik, mbrojtjen e dinjitetit dhe vlerave kombëtare si dhe anëtarësimin në strukturat ndërkombëtare.

2.5.3 Organizimi dhe struktura e Policisë së Kosovës

Policia është e organizuar në mënyrë të tillë që të gëzojë respektin e publikut si një strukturë profesionale për mbrojtjen e ligjit dhe sigurimin e shërbimeve për publikun. Struktura organizative e policisë vepron apo funksionon në bazë të dy niveleve të organizimit: në nivelin qendror dhe në nivelin lokal (niveli lokal përfshin edhe nivelin rajonal). Organizimi i Policisë bëhet sipas sistemit të qartë të komandimit brenda Policisë. Duhet të jetë gjithnjë e mundshme të vërtetohet se tek cili epror qëndron përgjegjësia për veprimet ose mosveprimet e personelit të Policisë.

Policia e Kosovës organizohet në nivel qendror dhe lokal. Drejtoria e përgjithshme e policisë është nivel qendror përgjegjës për tërë Republikën e Kosovës. Niveli lokal përfshin Drejtorit Rajonale të policisë përgjegjës për rajonet e përbëra nga komunat e caktuara, stacionet policore që janë përgjegjëse për policinë lokale në secilin komunë dhe nënstacionet policore të cilat janë përgjegjëse për policinë lokale brenda zonave të caktuara të një komune. Duke analizuar ligjin për policinë e Republikës së Kosovës shihet qartë se ka dy nivele të funksionimit të policisë, niveli qendror dhe rajonal, ku në kuadër të rajoneve bëjnë pjesë stacionet policore dhe nënstacionet policore të policisë së Kosovës. Varësisht prej sistemit juridik dhe të organizimit shtetëror kemi edhe format e organizimi policor. (Gjendarmëria, carabinieri, sherif, agent privat, etj.). (Mr. Fitim Shishani, Roli i Policisë në Parandalimin e Kriminalitetit, Prishtinë, 2006, faqe 19).

Për të siguruar një mbikëqyrje profesionale dhe të suksesshme çdo organizatë duhet dhe ka menaxherët të cilët menaxhojnë dhe mbajnë kontroll në organizatën e vetë. Për këtë duhet të njoftohemi edhe me autorizimet që ka menaxhmenti.

2.6 Kuptimi i menaxherit dhe menaxhimit

Së pari, të gjithë ata punojnë në një organizate. Organizatat janë një grumbullim njerëzish që punojnë së bashku dhe koordinojnë veprimet e tyre që të arrijnë një game të gjere objektivash ose rezultatesh të dëshiruara për të ardhmen.

Së dyti, menaxheret, janë personat përgjegjës për mbikëqyrjen dhe përdorimin e forcave njerëzore dhe burimeve të tjera të organizatës për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj.

Ndërsa, menaxhimi është procesi i planifikimit, organizimit, drejtimit, dhe kontrollit të forcave njerëzore dhe burimeve të tjera për të realizuar objektivat e organizatës në mënyrë sa më efikase dhe efektive.

Burimet e një organizate përfshijnë pasuri të tilla si: njerëzit dhe dijet e aftësitë e tyre; makineria, materialet, kompjuterit dhe teknologjia e informacionit, dhe kapitali financiar.

Funksionet e menaxherit

Detyra e menaxherit është të ndihmojë organizatën e tij të përdorë sa më mire burimet e saj për të arritur objektivat e caktuara.

Si i realizojnë menaxheret këto objektiva?

Ata e bëjnë këtë duke kryer katër funksione kryesore manaxheriale: planifikimin, organizimin, drejtimin dhe kontrollin.

2.6.1 Planifikimi

Planifikimi është procesi që menaxheret përdorin për të identifikuar dhe përzgjedhur objektivat e përshtatshme dhe rrugën e veprimeve për realizimin e tyre.

Eksitojnë tre hapa në procesin e planifikimit:

1. Përcaktimi i objektiveve që do të ndjeke organizata;
2. Përcaktimi i rrugës së veprimeve që do të merren për arritjen e këtyre objektiveve;
3. Marrja e vendimeve mbi alokimin/shpërndarjen e burimeve të organizatës për arritjen e këtyre objektiveve.

2.6.2 Organizimi

Organizimi është procesi me të cilin menaxheret ndërtojnë një strukturë të marrëdhënieve të punës që i lejon anëtarët e organizatës të ndërveprojnë dhe kooperojnë me njëri tjetrin për të arritur objektivat e organizatës. Organizimi përfshin grupin e njerëzve nëpër departamente, drejtori apo sektorë në përputhje me llojin e detyrës specifike të punës që ata kryejnë.

Gjatë organizimit menaxherët gjithashtu përcaktojnë linjat e autoritetit dhe të përgjegjësisë midis individëve dhe grupeve të ndryshme, dhe ata vendosin gjithashtu se si t'i koordinojnë sa më mirë burimet e organizatës dhe veçanërisht burimet njerëzore të saj. Rezultat i organizimit është ngritja e një strukture organizative, e cila përbën një sistem formal të detyrave dhe marrëdhënieve të raportimit që koordinon dhe motivon anëtarët e organizatës në mënyrë të tillë që ata punojnë së bashku për të arritur objektivat e organizatës.

Struktura organizative përcakton se si mund të përdoren më mirë burimet e një organizate për të krijuar të mira materiale dhe shërbime.

2.6.3 Drejtimi/lidershipi

Gjatë drejtimit menaxherët jo vetëm artikulojnë një vizion të qartë për anëtarët e organizatës, i cili duhet ndjekur, por ata gjithashtu i japin energji dhe i mundësojnë anëtarët e organizatës që ata të kuptojnë rolin e tyre dhe të marrin pjesë aktive në arritjen e objektivave të organizatës.

Lidershipi varet nga përdorimi i pushtetit/autoritetit, influencës, vizionit, bindjes dhe aftësitë komunikuese të menaxherëve për të koordinuar sjelljet e individëve dhe grupeve të veçanta në mënyrë të tillë që të gjitha aktivitetet dhe përpjekjet e tyre të janë në harmoni të plotë. Liderët gjithashtu i inkurajojnë punonjësit që të punojnë me një nivel të lartë performancë. Rezultat i lidërshiptit është pasja e anëtarëve me motivim dhe angazhim të lartë për të realizuar detyrat e tyre.

2.6.4 Kontrolli

Në funksionin e tyre të kontrollit, menaxherët vlerësojnë se sa mirë një organizatë po i realizon objektivat e saj dhe merr masa për të ruajtur dhe përmirësuar performancën.

Për shembull, menaxherët monitorojnë performancën e individëve, departamenteve dhe të organizatës në tërësi për të parë nëse ata janë duke i plotësuar standardet e dëshiruara të performancës. Rezultat i procesit të kontrollit është aftësia për të matur performancën në mënyrë sa më të saktë dhe për të rregulluar efikasitetin dhe efektivitetin e organizatës. Për

të ushtruar kontrollin menaxherët duhet të vendosin cilat objektiva të matin - mbase objektivat që kanë lidhje me produktivitetin, cilësinë dhe shërbimin ndaj klientëve-dhe pastaj duhet të ndërtojnë sistemet e informacionit dhe të kontrollit që sigurojnë të dhëna për të cilat ata kanë nevojë për të vlerësuar performancën.

Funksioni i kontrollit i lejon gjithashtu menaxherët të vlerësojnë se sa mirë janë duke punuar ata vet dhe punonjësit e tjerë në tërë funksionet e tjera të menaxhimit-planifikimin, organizimin dhe drejtimin-dhe të marrin masa korrigjimi.

2.7 Parimet e punës së policisë

Parimet e punës së policisë në përgjithësi janë:

Parimi i ligjshmërisë;

Parimi i objektivitetit;

Parimi i efikasitetit;

Parimi i proporcionalitetit.

Parimet e policisë përcaktohen me Ligjin për Policinë; ligjit të aplikueshëm dhe me akte nënligjore të nxjerra në bazë të ligjit. (Doracaku i parimeve dhe procedurave të Policisë Kosovës, Prishtinë, 2007).

- Policia e Kosovës është shërbim publik i krijuar në bazë të ligjit;
- Veprimet PK-së duhet gjithmonë të udhëhiqen në pajtim me ligjin;
- PK-së duhet të jetë e pavarur për veprimet gjatë kryerjes së detyrave të dhëna policore;
- PK-së duhet të pasqyrojë karakterin shumetnik të Kosovës dhe nevojën për përfaqësim të barabartë të të gjitha bashkësive në Kosovë;

- PK-së duhet të integrohet në shoqëri dhe të jetë transparente ndaj shoqërisë që i shërben;
- PK-së dhe udhëheqësit e saj duhet të decentralizohen sa më shumë që është e mundur në mënyrë që të rrisin bashkëpunimin e ngushtë dhe komunikimin me shoqërinë, veçanërisht me bashkësitë shoqërore lokale;
- PK-së duhet të vendos bashkëpunimin me institucionet tjera, organet tjera shtetërore si dhe me organizatat joqeveritare në mënyrë që të jetë sa më profesionale, efektive dhe efikase;
- Korrupsioni brenda PK-së duhet të konsiderohet si një kërcënim i pandërprerë për parimet e etikës. Masa efektive duhet të ndërmerren në organizim duke përfshirë edhe njësitë e specializuara për parandalimin e korrupsionit.

2.7.1 Etika policore

Kodi i Etikës policore të Kosovës është shprehje e vullnetit dhe përmbledhje e përgjithshme e parimeve bazë për të gjithë zyrtarët policor të Policisë së Kosovës me të cilat rregullohen:

Objektivat e policisë; Baza e ligjore të policisë; Roli i Policisë në sistemin e drejtësisë penale si dhe raportet e Policisë me organet e drejtësisë; Strukturën organizative të Policisë; Marrëdhëniet e punës; Trajnimi i personelit dhe Hetimet.

Objektivat kryesore të Policisë së Kosovës janë:

Të mbrojt jetën dhe pronën;

Të mbaj rendin dhe qetësin publike;

Të parandaloj dhe zbulojë krimin;

Të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut;

T'i trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët pa dallim, race, ngjyre, religjioni, gjinie dhe moshe. (Kodi i Etikës të Policisë së Kosovës, Prishtinë, 2009).

Policia e Kosovës, është shërbim publik i themeluar në bazë të ligjit, ku si detyrë primare e Policisë dhe e çdo zyrtari policor, është mbrojtja e të gjithë personave të Kosovës dhe sigurinë e pronës, përmes zbatimit të ligjeve, kryesore ndër to është zbatimi i standardeve ndërkombëtare të qeverisjes demokratike.

Gjatë ushtrimit të autorizimeve, zyrtari policor mund të përdorë forcën, e cila duhet të jetë e arsyeshme, proporcionale dhe e domosdoshme. Autorizimi për përdorimin e forcës duhet të shfrytëzohet si mjet i fundit dhe vetëm për të arritur një objektiv ligjorë të Policisë. Gjatë zbatimit të autorizimeve, të detyrave dhe procedurave zyrtare në raport me qytetarët, zyrtari policor duhet të veprojë me vendosmëri por njëkohësisht të jetë i përmbajtur, i kujdesshëm, të mos cenoj nderin e prestigjin dhe të mos i shqetësoj pa nevojë ose mos t'iu imponoj atyre obligime të panevojshme. Vëmendje të veçantë zyrtari policor duhet t'iu kushtojë personave që kanë nevojë për ndihmë dhe kujdes të shtuar. Kur prej zyrtarit policor kërkohet kryerja e detyrës që është në kundërshtim me rregulloret apo autorizimet e tij, ai është i obliguar ta refuzojë detyrën dhe të veprojë sipas rregulloreve që e rregullojnë këtë fushë. Zyrtarit policor nuk mund t'i imponohet kryerja e një detyrë të tillë, t'i shqiptohet ndonjë masë disiplinore ose sanksion tjetër për shkak të refuzimit të kryerjes së ndonjë akti kundërligjor.

Personeli policor duhet të zbatoj me rigorozitet urdhrat e dhëna nga eprorët, por gjithashtu duhet të ketë të drejtë të mos zbatojnë urdhra të cilat janë qartësisht të paligjshëm dhe të njoftoj për këto urdhra pa pasur frikë se do të ndëshkohet.

Masat hetimore penale duhet të ndërmerret kundër personit vetëm në bazë të dyshimit të arsyeshëm për krimin;

Zyrtaret policor duhet ta respektojë principin që çdokush që është i akuzuar për veprë penale, duhet të konsiderohet i pafajshëm derisa të dënohet nga gjyqi; zyrtarët policorë duhet të ketë parasysh lëndueshmërinë dhe nevojat specifike të viktimave dhe dëshmitarëve prandaj duhet të sigurojë mbrojtjen e nevojshme dhe të garantojë sigurinë e tyre. (Rregullorja 2005/54, Parimet dhe Procedurat e SHPK-së).

2.8 Bashkëpunimi i policisë

Bashkëpunimi i Policisë së Kosovës është i domosdoshëm si ai brendshëm, rajonal dhe ndërkombëtar:

Bashkëpunimi Polici – Ministri

Bashkëpunimi me Prokurori dhe Gjykata,

Bashkëpunimi me Komunitetin – qytetarët,

Me institucione qendrore dhe lokale,

Me organizata qeveritare dhe OJQ,

Me kompani publike etj.

Bashkëpunimi rajonal është i rëndësisë se veçantë për shumë aspekte të sigurisë, duke filluar nga ruajtja e kufirit, parandalimit të krimeve të ndryshme, kalimeve ilegale të kufirit, kontrabandës me emigrant, me armë, drogë, krimin të organizuar, veprave terroriste, diversantë dhe veprave tjera të inkriminuara e që është interes dy apo shumë palësh për parandalim duke besuar se krimi - kriminaliteti nuk njih kufi, religjion apo

përkatësi nacionale. Në këtë kuptim, në aspektin e përgjithshëm këtë mund ta quajmë edhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në fushën kriminale mbështetet në katër konventa të Këshillit të Evropës: (Dr. Hans Born, Mbikëqyrja Parlamentare në Fushën e Sigurisë, Gjenevë, 2003, faqe 61).

Konventa e Ekstradimit (STE 24)

Konventa e Ndihmës Juridike në fushën penale (STE 30)

Konventa e Transmetimit të Procedurave Represive (STE 73), dhe

Konventa e Transferimit të Personave të dënuar (STE 70 dhe 112).

Gjithashtu ai mbështetet edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të stupefiantëve dhe substancave psikotrope, nga e cila burojnë dy konventa të tjera të Këshillit të Evropës:

“Mbi falsifikimin e parasë, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e fitimeve që burojnë nga trafiku i tyre”, dhe “Marrëveshja mbi trafikun e paligjshëm të këtyre substancave me anë të detit”.

Bashkëpunimi në përgjithësi është i nevojshëm për të gjitha policitë e vendeve të cilat kanë mision sigurinë e shtetit nga të gjitha veprimet kriminale, të dënueshme me Ligjet dhe me Konventat ndërkombëtare e të cilat janë edhe destabilizues i një vendi. (Kodi Evropian i Etikes Policore).

2.8.1 Bashkëpunimi me Interpolin dhe Evropolin

Kur është çështja tek krimi trans nacional, parandalimi përfshin një përpjekje që ta bëjë një aktivitet të rrezikshëm duke reduktuar strehët e sigurta dhe shikimin e kufijve ashtu siç e bëjnë kriminelët relativisht në mënyrë të padukshme.

Kështu që, policitë nga shtetet që ofrojnë strehë të sigurta, ato që sigurojnë kërkesën për shërbimet që organizatat kriminale trans nacionale furnizohen, dhe ato që shërbejnë si transit dhe ato që ofrojnë lejueshmëri operative, duhet të gjitha të bashkëpunojnë që të forcojnë rrjetin.

Kërkesa për bashkëpunim ndërkombëtar në mes të shërbimeve të policive kombëtare e ka bërë shumë të qartë një linjë të mjedisit me ankth në lidhje me sfidat e sigurisë të tilla si terrorizmi, armët, drogat dhe trafikimi i qenieve njerëzore, krimi kompjuterik ose korrupsioni.

Janë dy kategori të pengesave për bashkëpunimin ndërkombëtarë të policisë: (1) qasja tradicionale nacionaliste e policisë, dhe (2) mungesa e institucioneve nacionale të strukturave që ta lehtësojnë ndarjen e inteligjencës brenda dhe jashtë shtetit. Tradita, mosha e vjetër, pengesat për bashkëpunim ndërkombëtar zhvillohen paralelisht me ato në nivel kombëtar. Luftërat e ashpra midis oficerëve të policisë dhe agjencive federale/nacionale dhe agjencive lokale/regjionale, gjithmonë kanë penguar shkëmbimin e informacioneve dhe bashkëpunimin midis kolegëve. Këto rrjedhin nga mosbesimi midis kolegëve, madje edhe në nivel kombëtar.

Në nivel ndërkombëtarë, një mungesë e besimit rrjedh nga frika se informacioni, nëse shpërndahet, do të keqpërdoret (p.sh. nuk trajtohet në atë mënyrë që bëhet provë e

pranueshme në gjyq) apo edhe të “humbet” tek krimi trans nacional. Problemi është komplikuar nga fakti se bashkëpunimi me shërbimet e policisë kombëtare kërkojnë nga sistemet nacionale që ta mundësojnë rrjedhën e informacionit. Për këtë arsye, zbatimi i një politike që të bashkëpunojnë në çështjet e zbatimit të ligjit kërkon zhvillimin e sistemeve kombëtare të rrjedhjeve të informacionit, përmes së cilës mbledhjet nga shërbimet e fshehta të policisë do të ndërtojnë kanale që të udhëtojnë në një zyre kombëtare policore të centralizuar, e cila nga ana e saj do të jetë në pozicion për shkëmbimin e informacioneve me zyrat e jashtme ose me organizatat ndërkombëtare të bashkëpunimit policorë.

Mendimet gjithashtu duhet të zhvendosen nga një kulturë nacionaliste që udhëhiqet nga kodi i fshehtësisë, për atë që është e hapur për shkëmbimin e informatave të ndjeshme me kolegët përtej kufijve. Dhe së fundi, politika duhet të pasqyroj angazhimin e shtetit për bashkëpunim duke reflektuar një prirje drejt harmonizimit që ta sigurojnë pajtueshmërinë e informimit dhe teknikave për mbledhjen e provave. Kjo është e tëra si një interes i bërjes së mbledhjes së provave në një shtet dhe të pranueshme në gjykatën e shtetit tjetër, për reduktimin e një mjedisi tolerant për krimet trans nacionale. (Dr. Werner Wajdenfeld, Dr. Wolfgang Wessels, Evropa prek A – ZH, Prishtine 2004, faqe 87).

Për zgjidhjen e këtyre pengesave, janë krijuar organizatat ndërkombëtare të bashkëpunimit të policisë.

INTERPOLI u krijua për të lehtësuar bashkëpunimin e shërbimeve të policive kombëtare në të gjithë botën. EVROPOLI filloi operacionin e plotë në vitin 1998 për kompensimin e erozionit të kufijve që kishin rezultuar nga marrëveshjet e Shengenit dhe marrëveshjet e tjera të Unionit Evropian.

INTERPOLI dhe EVROPOLI kanë personel, Sekretariate dhe zyra ndërlidhëse ndërkombëtare, roli i të cilave është që të mbledhin dhe të analizojnë informatat policore kombëtare të mbledhura nga hetuesit e policisë, dhe vullnetarisht të shpërndahen nëpër shtete të ndryshme. Analizat e krimeve, të kryera nga këto Organizata Ndërkombëtare kanë shpikur “inteligjencën e mbaruar”, e cila ofron një perspektivë të madhe për shërbimet e policisë kombëtare që e përdorin këtë burim me vlerë. Një perspektivë e madhe vjen nga hartimi i informacionit mbi aktivitetin kriminal në shtete të ndryshme që është analizuar dhe që siguron një “mbi perspektivë të shtetit”, që e përshkruan modus operandi, tendencat dhe vlerësimet e bazuara në kërcënime ku aktivitetet kriminale marrin vend, ku autorët gjejnë burime për t’u angazhuar në veprimtari të tilla, dhe ku ata gjejnë strehë të sigurt për të kërkuar mosndëshkim. Të gjitha këto aktivitete zhvillohen në pjesë të ndryshme të botës.

Organizatat Ndërkombëtare për Bashkëpunim Policor (IPCO s) luajnë tri role që e rrisin aftësinë e shteteve përkatëse për luftimin e krimit trans-nacional.

IPCO ka rritur nivelet e informimit, si shqetësim nga autoritetet politike dhe operative kombëtare mbi krimin trans nacional dhe një qasje multilaterale për ta luftuar atë.

Për adresimin e normave të ulëta të pjesëmarrjes, Interpoli dhe Evropoli kanë prezantuar iniciativa për promovimin e mirëkuptimit të vendeve, me kërcënimet që ato përballen, politikat që duhet t’i miratojnë me sigurinë e tyre kombëtare, dhe atë të anëtarëve të tyre të tjerë, si dhe procedurat dhe strukturat ose institucionet e tjera që ata duhet t’i vënë në vend, me qëllim që t’i zbatojnë politikat që janë të formuluar rreth bashkëpunimit ndërkombëtar. Evropoli dhe Interpoli organizojnë takime, simpoziume, grupe pune dhe komisione ad-hoc. Përveç dhënies së mundësive të rrjetit me vlerë, që të krijojnë

marrëdhënie personale dhe bashkëveprime ballë për ballë, këto konferenca japin një mesatare për shtetet që t'i gjejnë udhëzimet për formimin e politikave.

Takimet operationale, i japin një fushe oficerëve dhe një shans për të marrë ekspertiza nga të tjerët dhe për të krijuar qasje për hetime të përbashkëta.

Interpoli ndikon në kapacitetin e shteteve dhe në gjasat që kolegët e huaj të policisë do të ndajnë informacione nëpërmjet disa programeve.

“Mbarimi i Zbulimit” që është i pakompletuar, për shkak të dështimit të disa shteteve që të shkëmbejnë informacione, është i pasaktë dhe vlera e saj tek autoritetet kombëtare të policisë është i kufizuar. Programi rajonal modernizues dhe Marrëveshja e modelit të bashkëpunimit janë nismat që janë zbatuar nga Interpoli në njohjen se kapaciteti i pamjaftueshëm kombëtar ka pasur ndikim në bashkëpunim, dhe nga ana tjetër, në cilësinë e prodhimit të IPCO-s. Këto programe ofrojnë udhëzimin, trajnimin, dhe madje edhe burimet për shtetet që janë të gatshme për të krijuar kanale për bashkëpunim, por të cilat nuk kanë kompetencë ose burime të nevojshme.

Programi Rajonal Modernizues ofron asistencë në ngritjen e Zyrave Qendrore Kombëtare (zyra ndërlidhëse që lehtësojnë komunikimin në mes të autoriteteve kombëtare dhe Interpolit), si dhe Marrëveshja e Modelit të Bashkëpunimit shërben si një udhëzues për marrëveshjen e bashkëpunimit dypalëshe për shtetet që janë të gatshme të fillojnë marrëdhënie pune me një shtet tjetër.

Evropoli angazhohet edhe në fushën e trajnimit që ta rrisë suksesin e operationeve kundër veprimtarive kriminale trans nacionale. Evropoli është në një pozicion unik për të siguruar këtë trajnim, duke marrë mësimet e nxjerra nga shtetet individuale dhe për të komunikuar me tërë anëtarësinë. (Mr. Sc. Fatos Haziri, E Drejta Policisë, Prishtinë 2007, faqe 190).

Përveç kësaj qasje operative në ndërtimin e kapaciteteve, Evropolit është e angazhuar edhe në zgjerimin e bashkëpunimit ekzistues ndërkombëtar të policisë. Ndihma e ndërsjellë juridike në çështjet penale të Traktatit të vitit 2000, është një përpjekje për t'i pajtuar dy kanale të dallueshme për bashkëpunim policor: kanali i drejtpërdrejtë në nivelin policor, dhe kanalet gjyqësore që përbëjnë aparatën e zbatimit të ligjit. Këto dy kanale të lidhura e lejojnë Evropolin që të komunikojë më shpejtë me shtetet anëtare duke harmonizuar raportet hetuese, dhe duke i bërë ato më të lehta që të kuptohen dhe të përdoren me kalimin e kohës. Traktati ofron për bashkëpunim të zgjeruar me koordinimin e ekipeve të përbashkëta, ndjekje të përbashkët satelitore në mënyrë që të lehtësojë transferimin e provave dhe ndjekjet e aktiviteteve nga një shtet anëtarë të një tjetër, një mekanizëm (score board) të Evropolit i cili kryen një auditim të informacionit kombëtar për ndarjen e sistemeve, dhe të drejtën që shtetet anëtare të kërkojnë nismën e një hetimi. (Po aty).

Së fundi, EUROPOL dhe INTERPOL përhapin “mbarimin e inteligjencës” që rrjedh nga hartimi dhe analiza e zbulimit të përbashkët vullnetarisht të mbledhur nga autoritetet kombëtare të zbatimit të ligjit.

Nëpërmjet kësaj analize, stafet e tyre identifikojnë trendët aktuale dhe të ardhmen e kriminalitetit dhe fushat me interes të përbashkët në kushte gjeografike dhe në lloje të ndryshme të krimit. Shpërndarja e informacionit bëhet përmes një sistemi të kompjuterizuar të sofistikuar për shkëmbimin e informacionit nëpërmjet një sistemi të bazës së të dhënave të mbrojtura, në të cilat autoritetet kompetente kanë qasje në një zyre qendrore kombëtare. Përveç që shërbejnë si një mjet për të dërguar informata rreth aktiviteteve kriminale, hetimeve apo operacioneve tjera të shteteve anëtare, sistemi i shkëmbimit të informacionit është në dispozicion për shtetet anëtare që të komunikojnë

drejtpërdrejt në rast se do të kërkojnë një informacion nga fusha tjetër, p.sh. për rekordet penale të kryerësit nga një shtet në shtetin tjetër.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i organizatave policore gëzon një aftësi unike për të lehtësuar bashkëpunimin në mes të shërbimeve kombëtare, megjithatë, perspektiva e “mbi shtetit” do të jetë e limituar dhe me më pak vlerë për të gjithë anëtarët nëse disa vende anëtare nuk japin informacione. Normat pjesëmarrëse kanë qenë relativisht të ulëta. Në vitin 2001, EUROPOL ka gëzuar bashkëpunim sistematik me vetëm 6, nga 15 shtetet anëtare. Disa shtete kanë punuar për ta përmirësuar aftësinë e tyre për të marrë pjesë. Rasti i Francës, e cila ka qenë e ngadalshme për të marrë pjesë, tregon që kur shqetësohen në lidhje me krimin trans nacional dhe instrumentet për ta luftuar atë janë të kombinuara me shqetësimet që IPCO-ja është duke fituar shumë fuqi ekzekutive mbi shtetet dhe politikën, dhe qëndrimet e tyre mund të ndryshojnë gradualisht.

2.9 Krijimi i policisë së Kosovës dhe kontrollit policor

Pas ndërhyrjes së trupave të Organizatës së Aleancës Veri-Atlantike (NATO), më 24 mars 1999, me anë të sulmeve ajrore dhe futjes së trupave të KFOR-it në Kosovë më 12 qershor 1999, vendi ynë ishte në një situatë të jashtëzakonshme. Për rendin dhe qetësinë kujdesej KFOR-i, derisa u vendos Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), e në kuadër të së cilit u vendos edhe policia e UNMIK-ut. Ruajtja e rendit dhe e qetësisë ishte një sfidë, e cila nuk ishte edhe aq e lehtë, ngase Kosova kishte mbetur në një gjendje kaotike, pas luftës së ashpër të zhvilluar ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) e forcave të NATO-s nga njëra anë dhe forcave serbe nga ana tjetër.

Në bazë të Marrëveshjes së Kumanovës, e cila u arrit ndërmjet udhëheqësve të ushtrisë serbe dhe gjeneralit anglez, Xhekson me bashkëpunëtorët e tij, i cili pritej se do t'i udhëhiqte forcat e KFOR-it në Kosovë, ishte paraparë edhe ngritja e një administrate ndërkombëtare me qëllim që të merret me administrimin e Kosovës, e në kuadër të saj parashihej edhe formimi i policisë së UNMIK-ut.

Policia e UNMIK-ut, do të kujdeset për sigurinë dhe rendin në Kosovë, derisa të formohet, trajnohet dhe të barteshin kompetencat të Policia e Kosovës, që u emërtua si Shërbimi Policor i Kosovës, të cilën punë të rëndë e mori përsipër që ta bëjë Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Pranimi i parë i kadetëve për policë të ShPK-së u bë me 6 shtator 1999. Kjo ishte gjenerata e parë e ShPK-së, e cila diplomoi më 16 tetor 1999, në numër prej 176 kadetëve, të cilët zhvilluan trajnimet në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës (ShShPK) në Vushtrri. Pas kësaj, do të vazhdohet me pranimin e gjeneratave të tjera për policë. Pas përfundimit të trajnimit me sukses në ShShPK-në, pjesëtarët e këtij shërbimi vazhdojnë me programin e Trajnimit Fushor në stacionet policore, me trajnerë të certifikuar. Kosova, për herë të parë në historinë e vet, me ndihmën e faktorit ndërkombëtar krijoi policinë në përputhje me strukturën nacionale të popullsisë së Kosovës. Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës (MPB), juridikisht është themeluar më 20 dhjetor 2005, me Rregulloren e UNMIK-ut/nr. 2005/53, fillimisht e cilësuar si “transferim i hershëm i kompetencave”, e më vonë bëhet edhe bartja e kompetencave e quajtur “transferimi i vonshëm i kompetencave”, apo faza e dytë, e cila bartje u bë me anë të Rregullores së UNMIK-ut/nr. 2006/26, të datës 27 prill 2006. Rëndësia e saj është, se ajo paraqet bartjen e kompetencave të ShPK-ja dhe se e ka shuar Shtyllën e parë (I), për Polici dhe Drejtësi.

Ka mbetur vetëm një zyre e ashtuquajtur “Zyra për Politika të Sundimit të Ligjit”. ShPK-ja është pjesë e strukturës së MPB-së, në Kosovë. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008 dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës me 15 qershor 2008 u krijuan rrethana të reja dhe të favorshme, si dhe u krijua baza juridiko-ligjore për ndërtimin e një force policore shtetërore e cila do të kujdesej për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike në kuadër të territorit të Republikës së Kosovës.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në kapitullin e XI, ku është i inkorporuar Sektori i Sigurisë, saktësisht në nenin 128 thuhet se Policia e Republikës së Kosovës mbanë përgjegjësi për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Një atribut i rëndësishëm që i jepet Policisë së Republikës së Kosovës është edhe përgjegjësia për kontrollin e kufirit në bashkëpunim të drejtpërdrejt me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare. Kushtetuta e Republikës së Kosovës gjithashtu parasheh se organizimi i brendshëm e Policisë së Kosovës rregullohet me anë të ligjit për Policinë. Ndërsa në ligjin për Policinë në nenin 4 pika1, thuhet se Policia e Republikës së Kosovës themelohet si shërbim publik në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Zyrtarët policor ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutën e Republikë së Kosovës, në ligjet e tjera në fuqi dhe në kodin e etikës policore i cili hartohet nga Policia e Republikës së Kosovës dhe miratohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Mirëpo Kodi i Etikës së Policisë së Kosovës patjetër duhet të jetë në përputhje me Kodin Evropian të Etikës Policore.

Në Ligjin për Policinë parashihen në mënyrë të saktë detyrat e përgjithshme të Policisë, dhe janë me sa vijon: Ta mbrojnë jetën, sigurinë dhe pronën e të gjithë personave; t'i

mbrojtje të drejtat dhe lirit themelore të tët gjithë personave; ta parandalojë rreziku ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike; t'i parandaloj dhe ti zbulojë veprat penale; t'i hetoj veprat penale; të ofroj mbikëqyrje dhe kontroll për sigurinë në komunikacion; të ofroj mbikëqyrje dhe kontroll të kufijve; të ofrojë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; si dhe të kryej detyra të tjera të parapara me ligjin në fuqi.

Për kryerjen e të gjitha këtyre punëve duhet një staf i përgatitur mirë profesionalisht, me një vizion të qartë dhe të vetëdijshëm për gjendjen që kemi trashëguar pas luftës së fundit në Kosovë. Policia e Kosovës si organizata më e re në rajon, me një përvojë vetëm disa vjeçare, të pas luftës, me vështirësi do t'i përballojë të gjitha këto detyra dhe përgjegjësi. Andaj Policia e Kosovës si mbrojtëse dhe promovuese e të drejtave të njeriut nuk do të kalojë, ashtu si çdo polici në botë, pa bërë edhe shkelje të po këtyre të drejtave. Çështja është se çka duhet bërë pasi që të shkelen këto të drejta nga ana e policëve, cili do të jetë ai organ i cili do të benë mbikëqyren e Policisë së Kosovës dhe ky organ a do të jetë në cilësi të kontrollit të brendshëm apo të jashtëm të policisë.

Fillimisht ky organ i kontrollit të zyrtarëve policor për shkeljet e rënda dhe të lehta disiplinore ishte pjesë e Policisë së Kosovës (pra pjesë e kontrollit të brendshëm). Të cilën punë e kryente njësitit i standardeve profesionale i cili ka funksionuar brenda Policisë së Kosovës dhe funksionon ende, por që nga 1 tetori 2007 heton vetëm shkeljet e lehta disiplinore ky njësit. Mirëpo, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, ideuan një model të kontrollit të jashtëm dhe të pavarur nga Policia, i cili model është marrë nga Britania e Madhe. Si formë e kontrollit të jashtëm të Policisë së Kosovës. Ky institucion

do të emërtohej si Inspektorati Policor i Kosovës (IPK-ja). IPK-ja, është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2005/54. Ky institucion është formuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të OKB-së, për të bërë kontrollime dhe inspektime të ShPK-së, si dhe hetimin e pohimeve për shkelje të rënda disiplinore nga policët ose personeli civil i ShPK-së.

Ndërsa, Urdhëresa administrative nr. 2006/9, në mënyrë të detajuar ka paraparë autorizimet dhe detyrat e inspektorëve policorë. IPK-ja, ka filluar punën në muajin korrik 2006, në përbërje fillimisht kishte 19 inspektorë dhe kryeshefin ekzekutiv, për tu zgjeruar më vonë në dy departamente me gjithsej rreth dyzet inspektor policor. Por edhe Inspektorati Policor i Kosovës nga 15 qershori 2008, pra me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, ka të miratuar legjislacionin e vetë, i njohur si Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës në bazë të cilit vepron dhe funksionon si agjension ekzekutiv ky institucion. Pra policinë duhet ta (kontrolloj) një mekanizëm i pavarur, i cili do të kujdeset që policia e Kosovës të jetë në hap me të priturat nga popullata, të punoj në mënyrë efikase dhe efektive dhe në harmoni me ligjet e aplikuara në Kosovë. Ky projekt i OSBE-së, dhe MPB-së do filloj së zbatuari nga 03 korriku i vitit 2006, fillimisht vetëm me departamentin e Inspektimit, i cili do të kryente inspektimin ndaj pjesëtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës dhe raportimin mbi punën dhe efikasitetin në arritjen e qëllimeve.

Për tu zgjeruar dhe funksionalizuar edhe departamentin e Hetimeve nga data 01 tetor 2007, zyrtarët e së cilit departamente do të merren me hetimin e akuzave për shkeljet e rënda disiplinore ndaj të gjithë punonjësve të policisë pa dallim grade, si dhe t'i rekomandoj Komisionit për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici, se çfarë mase disiplinore nëse është e nevojshme duhet të shqiptohet. (Ligji I Policisë së Kosovës).

2.9.1 Autorizimet e Përgjithshme të Inspektoratit Policor të Kosovës janë:

Të zhvillojë inspektime ndaj Policisë së Republikës së Kosovës dhe të raportojë mbi punën dhe efikasitetin në arritjen e qëllimeve të Policisë së Kosovës;

Të hetojë akuzat për shkelje të rënda disiplinore ndaj të gjithë punonjësve të policisë, pa dallim grade dhe të gjitha shkeljet e tjera ndaj pozitave të larta ekzekutive, dhe ti rekomandojë Komisionit për Emërimet të Larta dhe Disiplinë në Polici se çfarë mase disiplinore, nëse është e nevojshme duhet të shqiptohet.

Inspektorati Policor i Kosovës zhvillon Inspektime të dylojshme: Inspektimet e zakonshme, dhe inspektimet e jashtëzakonshme. (Ligji i Inspektoratit Policor të Kosovës). Ekzistojnë gjithsej 14 fusha në të cilat IPK-ja, duhet të bëjë inspektime dhe për secilën fushë duhet të kryhet nga një inspektim, për të cilin duhet të përpilohet një raport mbi gjendjen në atë fushë. Në fund të çdo viti kalendarik duhet t'i paraqitet ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, raporti vjetor i përmbledhur për të gjitha fushat.

Në raporte duhet të paraqitet gjendja reale dhe duhet të jepen rekomandimet nga ana e Inspektoratit Policor për ndryshimet që duhet bërë në fushat përkatëse. Rekomandimet që do të jepen duhet të jenë në pajtim me parimet e Kodit të Etikës Policore Evropiane dhe në synim për gjetjen e praktikave më të mira që do ta ndihmojnë Policinë e Republikës së Kosovës, që të arrijë nivelin e një policie demokratike dhe efektive në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike në vend dhe në luftimin e kriminalitetit transnacionl në bashkëpunim me policit e shteteve tjera. Policia e Republikës së Kosovës ka aspirata se së shpejti do të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare të cilat merren me luftimin e

kriminalitetit siç janë Interpol-i, dhe Evropol-i, anëtarësimi në këto organizata do ti kontribuonte në veçanti sigurisë në Kosovë dhe në përgjithësi edhe sigurisë në rajon.

KAPITULLI I TRETË

3. VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT/VËSHTRIM/

Në studime të ndryshme dhe në literaturën e botuar, shohim që analizimi i korrupsionit policor bëhet më së shumti përmes identifikimit dhe shqyrtimit të formave dhe llojeve të ndryshme të veprave-korruptive. Këto janë të shumëllojshme, të natyrave të ndryshme, në varësi të veprimeve jo të ligjshme që kryejnë zyrtarë të caktuar policorë gjatë kryerjes së detyrave të veçanta dhe operacioneve konkrete gjatë punës. Ndaj ato duhen njohur mirë nga drejtuesit e policisë dhe nga organet mbikëqyrëse të saj, me qëllim që të parandalohen dhe të zbulohen sa më parë. Për disa lloje veprash korruptive të zyrtarëve të policisë flasin në botimin e tyre edhe autorë, si Bayley dhe Perito:

“Si forma më të zakonshme të korrupsionit ishin evidencuar përpilimi i raporteve të falsifikuara dhe kryerja e paragjytimeve, mbrojtja e lojërave ilegale, vjedhja e drogës në rrugë, vjedhja e pasurisë së konfiskuar, pranimi i zbritjeve gjatë blerjes dhe shitja e informacioneve lidhur me operacionet policore.” (sipas autorëve: Bayley, Perito, 2011: 4).

Lidhur me sjelljen e zyrtarëve të zbatimit të ligjit, në raport me etikën profesionale, me keqpërdorimin e detyrës apo me shkeljet penale po zhvillohen gjithnjë e më shumë debate, diskutime dhe hulumtime, po shkruhet shumë në media, si dhe po bëhen në strukturat përkatëse analiza, raporte gjithnjë e më kritike dhe transparente.

Diskutimi i hapur dhe i argumentuar për problemet në këtë fushë, sigurisht, ka nxitur institucionet qeveritare përgjegjëse të ndërmarrin masa për forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm dhe sidomos për forcimin e integritetit të punonjësve policorë. Megjithatë, pavarësisht gjetjeve pozitive, hulumtimet sugjerojnë se

keqpërdorimet policore mbeten problem që duhet të adresohen nga politikë bërësit dhe profesionistët policorë. (Wiesburd, Greenspan, Hamilton, Williams, Bryant, 2000: 11).

Diskutimi i hapur dhe i argumentuar për problemet në këtë fushë, sigurisht, ka nxitur institucionet qeveritare përgjegjëse të ndërmarrin masa për forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm dhe sidomos për forcimin e integritetit të punonjësve policorë. Megjithatë, “pavarësisht gjetjeve pozitive, hulumtimet sugjerojnë se keqpërdorimet policore mbeten problem që duhet të adresohen nga politikë bërësit dhe profesionistët policorë. (Wiesburd, Greenspan, Hamilton, Williams, Bryant, 2000: 11).

Duke folur për shkaqet që ndikojnë në shfaqjen e veprave korruptive, “Korrupsioni ekziston, sepse shumë departamente nuk bëjnë punë të mirë gjatë punësimit, trajnimit, pagesës dhe disiplinimit të oficerëve të tyre”. (Williams, 2002: 97).

Është e vërtetë që, së paku, disa nga zyrtarët që përfshihen në aktivitete të paligjshme kanë arritur të shpëtojnë disi, për shkak të metave në procesin e punësimit dhe thjesht kanë vazhduar rrugën jo etike të tyre. Gjithsesi, ky shpjegim nuk mund të sqarojë përse edhe zyrtarë të mirë policorë përfshihen në keqpërdorim të detyrës”. (Fitch, 2011: 24).

Përkufizimet dhe konceptet e tipologjisë së devijimeve policore japin bazë për ekzaminimin e sjelljes së papërshtatshme policore dhe veçanërisht për prapavijën e saj kulturore.

Të kuptuarit e devijimeve policore dhe e rrënjëve të tyre kulturore është mjaft i rëndësishëm. Përmes të kuptuarit konceptual të formave të ndryshme të sjelljeve devijante, mund të udhëzojmë autoritetet policore në Turqi që të përqendrojnë qasje alternative të problematikës, në vend të teorive të thjeshta dhe të pabaza, si ajo e “mollës së kalbur” (Yldiz, 2001: 17).

Faktor i rëndësishëm për parandalimin e veprimeve korruptive të personelit policor janë edhe kontrolli dhe mbikëqyrja sistematike e personelit. Pa një mbikëqyrje adekuate nuk do të arrihen efektet e pritshme pozitive nga personeli policor. Mungesa e mbikëqyrjes prodhon pasoja negative në luftën kundër korrupsionit. Roli i mbikëqyrësve është vendimtar në menaxhimin e personelit, për ruajtjen e vlerave etike të punonjësve të policisë, për krijimin e një kulture të llogaridhënies dhe të transparencës, për forcimin e integritetit profesional dhe për parandalimin e korrupsionit dhe të sjelljeve tjera të kundërligjshme. Është e domosdoshme të theksohet se mbikëqyrësit duhet të jenë shembull për punonjësit që kanë në varësi, duke manifestuar cilësi, sjellje dhe qëndrime të standardeve të larta, që të kenë të drejtën morale dhe legjitime t'ua kërkojnë ato vartësve të tyre.

“Udhëheqja është gur themel i bazës morale të organizatës. Kjo është një e vërtetë historike. Udhëheqësit japin tonin, dhe përmes aktiviteteve dhe veprimeve të tyre ata e bëjnë model këtë sjellje për të gjithë tjerët.” (Ricucci, 2006: 192).

Lidhur me këtë, autorët Iannone thekson:

Mbikëqyrësi duhet të jetë në gjendje të kontrollojë veten para se të kontrollojë të tjerët. Nëse ai ndjek një sërë rregullash të veta, ndërkohë që kërkon nga vartësit të ndjekin model më rigoroz të sjelljes, ai nuk mund të presë nga ata që ta respektojnë. Nëse nuk ka vetë disiplinë, ai nuk do të mund të disiplinojë vartësit e vet siç duhet. Po kështu, nëse ai nuk ndjek urdhrat nga mbikëqyrësit e vet, vështirë se mund të presë që urdhrat e tij të zbatohen (Iannone, 2001: 212).

Një faktor tjetër me rëndësi të veçantë në parandalimin e rasteve të korrupsionit në polici është edhe organizimi i punës për zbatimin e detyrave nga personeli mbi bazën e disa standardeve të policisë. Por në praktikë, ndodh që gjatë ushtrimit të detyrës, zyrtarët policorë në shumë raste nuk kanë norma të shkruara se si duhet të veprojnë, si të sillen për çdo situatë dhe çfarë vendimi të marrin. Kjo bën që shpeshherë ata të veprojnë sipas mendimit të tyre. Mirëpo, në këto kushte ekziston mundësia që në parim të vij deri te keqpërdorimet dhe punonjësit e caktuar të policisë të orientohen në veprime devijuese, keqpërdorim të detyrës zyrtare, korruptive, arbitrare, të paligjshme etj. Në mungesë të disa rregullave të shkruara se si duhet të veprojnë në situata të ndryshme, punonjësit e policisë i japin vetes liri të pakufizuar veprimi, gjë që sjell kryerjen e veprimeve që i tejkalojnë kompetencat e tyre, por edhe të veprimeve të kundërligjshme. Duke e trajtuar këtë çështje, “Newburn” vë në dukje: Zyrtarët policorë kanë liri të konsiderueshme veprimi kur vendosin nëse do të zbatojnë ligje të caktuara në situata të caktuara, duke bërë të mundshme që këto vendime të ndikohen nga përfitimet materiale apo leverdi të tjera se sa nga të gjykuarit profesional. Një nga burimet kyç të veprimeve devijante janë resurset e disponueshme brenda organizatës policore. Në këtë situatë nuk është thelbësore vetëm ndryshueshmëria në përdorimin e lirisë së veprimit. Është, gjithashtu, fokusi i punës së policisë. Janë disa forma të punës së policisë që shoqërohen me mundësi më të mëdha dhe me gjasa më të mëdha për korrupsion. (Newburn, 1999: 16) .

Faktorët që ndikojnë në kryerjen e veprave të korrupsionit nga punonjësit e PK kërkon shkallë të lartë angazhimi të drejtuesve dhe të strukturave të kontrollit e të mbikëqyrjes mbi policinë. Një rol vendimtar për zhvillimin me sukses të kësaj lufte luan identifikimi i hershëm i faktorëve që ushqejnë korrupsionin në zyrtarët e policisë së Kosovës.

Në kryerjen e veprave penale nga zyrtarët e PK-së ndikojnë faktorë të përgjithshëm dhe faktorë të veçantë. Faktorët e përgjithshëm janë të njëjtë me ata që ndikojnë veprat kriminale dhe korrupsionin policor edhe në vende të tjera. Ata mund të grupohen si: faktorë individualë, kulturorë, institucionalë, të legjislacionit etj. Si faktor i veçantë janë rrethanat specifike siç janë kushtet e ndërtimit të policisë, kushtet infrastrukturore të një vendi i dalë pas lufte, sa ishin të aftë dhe profesional zyrtarët policor të UNMIK-ut, nga cilat vende vinin, prej ç ‘far shoqërie (shoqëri autokratike dhe shumë të korruptuara), pa përvojë të mjaftueshme që nuk kishin njohuri të caktuara me ligjin si në shtete tjera demokratike, të papërgatitur për një punë të dobishme, korrekte dhe profesionale, të cilët kishin mangësi të shumta në ngritjen dhe zhvillimin e policisë së Kosovës e të cilat ndikonin në përkeqësimin e gjërave më shumë, një shembull (një polic i UNMIK-ut, vet mua më ka thënë se ka ardhur për para e jo të punoj për ju).

Rrethanat në të cilat u krijua Policia e Kosovës deri në shpalljen e pavarësisë, kishte një vakum të ligjeve si dhe një mungesa e përvojës të një numri të stafit vendor etj., me ç ‘rast pati pasoja dhe mbeti një sfidë e madhe për Policinë e Kosovës në të ardhmen kur ekonomia e vendit ishte e dobët, papunësi e madhe dhe një situatë e brishtë politike kanë ndikuar negativisht në arritjen e standardeve të një policie demokratike. Bazuar në të cekurat më lartë mund të konstatojmë se shkas i devijimit të zyrtarëve - punonjësve policor ishte vet krijimi dhe themelimi i PK-së duke potencuar se në Kosovë kanë vepruar mbi 47 shtete me përvoja, kultura dhe standarde të ndryshme. .” (ICG, 2005: 23).

Në një raport të tij të vitit 2015, thuhet:

Sipas shumë studimeve, korrupsioni është një prej problemeve më të mëdha, mbetet fenomen shumë i përhapur në Kosovë me palë të ndryshme joqeveritare të interesit në

nivel vendor, si dhe në palë të ndryshme ndërkombëtare të interesit. Studimet ndërkombëtare rreth perceptimit të korrupsionit, po ashtu, tregojnë se perceptimi ka mbetur në të njëjtin nivel të ulët apo është përkeqësuar. (Këshilli i Evropës, 2015:22)

Prania e korrupsionit në institucione të tjera të shtetit, madje, edhe në qarqet e larta zyrtare, pa dyshim, ushtron ndikim edhe në policinë e Kosovës, e cila nuk është e shkëputur prej tyre. Për këtë ndikim flet edhe Këshilli i Evropës kur shqyrton gjendjen e korrupsionit në Kosovë. Por korrupsioni në polici ndikohet edhe nga niveli i korrupsionit në lidhshimin politik. Sipas disa autorëve që kanë studiuar korrupsionin policor: “Korrupsioni nuk mund të ekzistojë pa pasur një bashkëpunim aktiv të oficerëve të lartë policorë dhe figurave kryesore në hierarkinë politike”. (Thibault, Lynch, McBride, 2007: 35).

Gjithashtu, në nivelin e korrupsionit në PK ndikojnë edhe një sërë faktorësh të tjerë, si sistemet jo të shëndosha të llogaridhënies në prokurori dhe në gjykata; legjislacioni jo i plotë; aspekti demografik dhe gjeografik, që ka të bëjë me faktin se sa shpesh janë në kontakt qytetarët me zyrtarë policorë etj.

Sidoqoftë, faktorët kryesorë të përhapjes së korrupsionit policor duhet të kërkohen brenda vetë policisë.

Një ndër faktorët e brendshëm që lidhet me nivelin e korrupsionit policor është gjendja dhe performanca e kapaciteteve profesionale të policisë. Kjo ka të bëjë me politikat që ndiqen për rekrutimin dhe përzgjedhjen e personelit, për trajnimin dhe zhvillimin profesional të tij, në emërimet në postet e larta të policisë, gradimet, sistemet në vendet e duhura (personi i duhur në vendin e duhur ose mos e bartë at që nuk mund ta bartësh).

Mungesa e kontrollit dhe të mbikëqyrjes mbi vartësit lënë hapësirë që punonjësit policorë gjatë kryerjes së detyrës, joshen nga aferat korruptive, në mungesë të mbikëqyrjes, bien pre e tyre, shkelin ligjin, cenojnë detyrën, duke rrezikuar ndëshkimin por edhe duke prishur imazhin e policisë.

3.1 “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” - Neni 422 KPK

Nocioni penalo-juridik i shpërdorimit të pozitës zyrtare ose i kompetencave nënkupton ato sjellje të kundërligjshme të personave zyrtarë, gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, që kryhen me qëllim përfitimi për vete apo për një person tjetër.

Dispozita e nenit 422 konsideron veprë penale veprimet e personit zyrtar, që shfrytëzon detyrën apo autoritetin zyrtar, tejkalon kompetencat, që nuk përmbush detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që shkel rëndë të drejtat e personit tjetër.

“Kryesi i veprës penale shfrytëzon shërbimin, autorizimet e tij publike në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me interesat dhe qëllimet e shërbimit. Ai shfrytëzon në mënyrë të kundërligjshme mundësitë lidhur me pozitën e tij zyrtare apo me autorizimet”. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014: 1209).

Në KPK veprimi i kryerjes së kësaj veprë penale është përcaktuar në mënyrë alternative, në tri forma: shfrytëzimi (shpërdorim) i pozitës zyrtare apo kompetencave; tejkalimi i autorizimeve zyrtare; dhe mos përmbushja e detyrave zyrtare (moskryerja e detyrimeve zyrtare). Shembull tipik janë keqpërdorimet e detyrës zyrtare, lidhur me të ashtuquajturat kompetenca diskrecionale, kur personi zyrtar, me rastin e nxjerrjes së ndonjë akti ose të zgjidhjes së ndonjë rasti, është i autorizuar që, në mesin e shumë zgjidhjeve, të zgjedhë

atë që është më e arsyeshmja. Nëse personi zyrtar në këtë rast nuk udhëhiqet nga interesi i shërbimit, por e bazon vendimin në ndonjë interes të vetin ose të huaj, ai keqpërdor detyrën zyrtare, edhe pse vepron në kuadër të detyrës zyrtare. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014: 1211).

Vepra penale e moskryerjes së detyrës zyrtare kryhet edhe me mosveprim. Kjo ndodh, kur zyrtari nuk ndërmerr veprimin që është i detyruar ta ndërmarrë, ose kur këtë veprim e bën të tillë që të mos mund të arrihet qëllimi që do të arrihej.

Që të ekzistoj vepëra penale, është e nevojshme që autori të jetë i vetëdijshëm se me të ai do të arrijë për vete ose për një person tjetër çdo lloj përfitimi (material ose jo material) dhe se, kështu, i shkakton dëm një personi tjetër. Lidhur me këto raste, Schmallegger thekson: “Zyrtari publik, që, nën petkun e ligjit apo të kompetencës zyrtare, vepron në atë mënyrë që tejkalon kufijtë e kompetencave ligjore, mund të jetë fajtor për keqpërdorimin e tyre”. (Schmallegger, 2006: 474).

3.2 “Keqpërdorimi i informatës zyrtare” – Neni 423 KPK

Në Kodin Penal, shprehja “informatë zyrtare” nënkupton informatën në të cilën personi ka qasje si rezultat i detyrës apo punës së tij dhe e cila nuk është bërë publike.

Dispozita e nenit 423 konsideron vepër penale veprimet që ndërmerr personi zyrtar duke keqpërdorur me dashje informatën zyrtare, me qëllim që të përfitojë për vete apo për një person tjetër ndonjë përparësi që nuk i takon.

Llojet më të shpeshta të veprave penale të evidencuara në policinë e Kosovës janë :

1. Korrupsion zyrtar: 325

2. Rrezikim i trafikut publik: 197
3. Lëndim i lehtë trupor: 167
4. Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare: 122
5. Kanosje: 89 (Burimi: Policia e Kosovës).

Hetimet penale të iniciuara ndaj zyrtarëve të PK për korrupsion:

Hetimet penale kundër zyrtarëve të PK-së janë iniciuar në mënyrë të vazhdueshme dhe me intensitet të ndryshëm nga viti në vit. Nga 1289 raste penale të evidencuara në periudhën 2010-2015, 325 raste apo 25% janë nga fusha e korrupsionit zyrtar.

Dinamika e veprave penale të korrupsionit zyrtar, në vitet 2010-2015:

Dinamika e këtyre veprave në vite është e tillë që ato kanë ardhur në rritje. Ndonëse në ndonjë vit ato janë ulur, shohim që në krahasim me vitin 2010, numri i tyre është shumë më i madh. Ndërsa në vitin 2010, ka pasur 31 raste, në vitin 2011 kemi 40 raste, në vitin 2012 kemi 58 raste, në vitin 2013 kemi 51 raste, në vitin 2014 kemi 83 raste dhe në vitin 2015 kemi 62 raste. Siç shihet edhe nga grafiku, në vitin 2014 shënohet numri më i madh, afro trefishi i vitit 2010, kurse në vitin 2015 është dyfishi i veprave të evidencuara në vitin 2010.

Të dhënat e paraqitura tregojnë se në numrin total të veprave penale në fushën e korrupsionit zyrtar, vendin më të madh e zë “Keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit”, me 63.6%. Kjo shifër e madhe, tregon se në radhët e policisë ka shumë veprime arbitrare gjatë kryerjes së detyrës, të cilat vijnë, ose nga mosnjohja e kompetencave, ose kryhen në mënyrë të vetëdijshme për afera korruptive. Pas kësaj vepre penale vjen vepra penale “Marrja e ryshfetit”. Numri i rasteve të marrjes së ryshfetit nga

zyrtarët e policisë, është për t'u marrë në konsideratë dhe shton nevojën për të rritur mbikëqyrjen dhe kontrollin ndaj personelit.

Veprat penale nga fusha e korrupsionit zyrtar, në vitet 2008-2017:

Numri i rasteve të raportuara ne PK janë:

1. Keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit: 207
2. Marrja e ryshfetit: 66
3. Falsifikimi i dokumentit: 26
4. Zbulimi i fshehtësisë zyrtare: 9
5. Mashtrimi në detyrë: 6
6. Ushtrimi i ndikimit: 6

Dinamika e veprës penale “Marrja e ryshfetit”:

Në periudhën 2008-2017 janë evidentuar 66 raste të veprës penale “Marrja e ryshfetit” ose 5.1% e numrit të përgjithshëm të rasteve penale të evidentuara. Pas veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, vepra penale Marrja e ryshfetit, zë vend të madh në numrin e përgjithshëm të veprave të raportuara në këtë periudhë. Të shikuara sipas viteve, në grafikun e mëposhtëm, konstatojmë se, në krahasim me vitin 2010, rastet e marrjes së ryshfetit nga punonjësit e policisë në vitin 2011, janë rritur tri herë (19 raste). Në vitet pasardhëse ato shënojnë ulje, por, gjithsesi, mbeten në nivel shqetësues. Në vitin 2015 ato janë rreth 2 herë më shumë se në vitin 2010. Kjo situatë tregon se, me gjithë punën e bërë për rritjen e integritetit të punonjësve të policisë, mbetet shumë për të bërë në këtë drejtim, pasi kjo lloj vepre penale, përveç pasojave të tjera që sjell, godet dhe cenon personalitetin dhe integritetin e zyrtarëve policorë, humb besimin e qytetarëve te policia e shtetit.

Vepra penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”:

Në periudhën 2008-2016 janë evidencuar 26 raste të veprës penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”. Dinamika e saj në vite shënon vetëm rritje. Në vitin 2014 janë regjistruar 12 raste, 6 herë më shumë se në vitet 2011 dhe 2013. Prania e kësaj vepre të paligjshme, flet për dobësitë në rekrutimin e personelit, në radhët e të cilit kanë mundur të depërtojnë edhe tipa mashtrues, manipulues, që, për qëllime fitimi, vepër kjo e paligjshme dhe e dënueshme. Ndonëse shifrat e kësaj vepre duken jo shumë të larta, ato duhet të nxisin strukturat përgjegjëse për zbulimin dhe spastrimin nga radhët e policisë të elementëve të tillë, që me vetëdije të plotë shkelin ligjin për përfitime vetjake duke shkelur ligjet.

Dinamika e veprës penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”, gjatë periudhës 2008-2016 janë evidencuar edhe lloje të tjera veprash penale të fushës së korrupsionit zyrtar, të kryera nga punonjës të policisë së Kosovës, si “Zbulimi i fshehtësisë zyrtare”(n raste); “Mashtrimi në detyrë”(6 raste); dhe “Ushtrimi i ndikimit”(6 raste), “Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit Gjyqësor”(6 raste), si dhe disa vepra të tjera që janë kryer në numër më të vogël, të cilat, gjithashtu, nuk duhet të neglizhohen.

Për t’u shënuar është edhe fakti se gjatë periudhës 2010-2015, nuk është evidentuar asnjë rast për këto vepra penale: “Përdorimi i paautorizuar i pasurisë”, “Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme”, “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”, që parashikohen në

Kodin Penal të Kosovës. Ky fakt tregon se në Policinë e Kosovës ekzistojnë mundësitë që të mos kryhen vepra penale dhe korruptive nga punonjësit e saj.

3.3 Hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës

Zbatimi i ligjit është profesion i veçantë, me zyrtarë që kanë një mori lirish që nuk janë në dispozicion për publikun e gjerë, përfshi edhe aplikimin e forcës vdekjeprurëse, ngasjen e makinës me shpejtësi të lartë dhe konfiskimin e pasurisë personale. Ndërsa këto liri mund të jenë të domosdoshme, ato, gjithashtu, mund të krijojnë mundësi për keq bërje, veçanërisht nëse sjellje të tilla kalojnë pa u zbuluar, për shkak të mbikëqyrjes së dobët. (Fitch, D.B, 2011: 24).

Mosndërmarrja e veprimit të caktuar apo mosveprimi mund të jetë shkak i pasojës nëse janë përmbushur këto kushte: 1) nëse ka ekzistuar obligimi që të veprohet në mënyrë të caktuar për t'u parandaluar pasoja, 2) nëse personi ka pasur mundësi, ka qenë në gjendje të parandalojë shkaktimin e pasojës dhe 3) nëse konstatohet se me siguri pasoja nuk do të shkaktohej, ose do të shkaktohej pasojë shumë më e vogël, po të ndërmerrej veprimi që është dashur të ndërmerrej. (Salihu, I. 2005: 221).

Pas themelimit dhe të zhvillimit të PK-së, në mungesë të njësive të specializuara, por edhe në mungesë të kompetencave, hetimin e veprave penale në të gjitha nivelet, përfshirë edhe veprat penale të kryera nga zyrtarët publikë, kompetente ka qenë policia e UNMIK-ut. Me ngritjen dhe forcimin kapaciteteve operacionale dhe strukturimin e PK-së, gradualisht, edhe zyrtarët e PK-së pas trajnimeve të nevojshme për hetimet e krimeve janë sistemuar

në njësitë hetimore, në nivel lokal dhe rajonal, më pas edhe në nivel qendror krahas procesit të pavarësimit të PK-së nga Policia e UNMIK-ut.

3.3.2 Roli i PK-së në hetimet penale të zyrtarëve të saj

Me ndryshimet e bëra në kompetencat e IPK-së, duke i dhënë asaj mandatin ligjor edhe për hetimin e veprave penale të kryera nga zyrtarët e PK-së, është përmbushur një standard i rëndësishëm i kontrollit të jashtëm mbi policinë. Megjithatë, kjo nuk e privon në asnjë mënyrë dhe nuk e liron nga përgjegjësia vetë Policinë që të ndër marrë masa për parandalimin, për raportimin dhe hetimin e veprave penale dhe të korrupsionit të kryer nga punonjësit e saj.

Në këtë drejtim, PK-ja ka krijuar mekanizmat e brendshëm të kontrollit, si: Njësia e Inspektimit, Drejtoria për Standarde Profesionale, Komisioni Disiplinor etj. Po ashtu, janë hartuar dhe miratuar edhe procedurat dhe rregulloret e punës, të cilat mundësojnë mbikëqyrje dhe llogaridhënie. Megjithatë, parandalimi dhe luftimi i sjelljeve devijante dhe i shkeljeve të ligjit kërkon edhe plane organizative afatgjata për ruajtjen dhe forcimin e integritetit policor. Në Planin Zhvillimor Strategjik 2011-2015 të PK-së janë parashikuar aktivitete për parandalimin e korrupsionit në radhët e personelit të policisë.

Përveç veprimeve në fushën e ndjekjes penale, PK-ja duhet të kryejë më tepër veprime administrative dhe menaxheriale, që masat dhe veprimet për parandalimin dhe luftimin e shkeljeve penale të jenë pjesë e planeve zhvillimore dhe të dokumenteve strategjike. Kjo kërkon që udhëheqja e PK-së të hartojë një plan afatgjatë për forcimin e integritetit policor dhe për luftimin e korrupsionit brenda radhëve të saj.

3.3.3 Inspektoratit Policor në hetimet penale ndaj punonjësve të PK-së

Hetimet penale ndaj punonjësve të PK-së zhvillohen nga IPK-ja, që është një agjenci e pavarur në kuadër të MPB-së, nëpërmjet zyrtarëve të autorizuar. Me termin “zyrtari i autorizuar i policisë”, Kodi i Procedurës Penale ka parasysh cilindo punonjës të Policisë së Kosovës apo të ndonjë shërbimi tjetër, që janë të autorizuar të zhvillojnë hetime penale ose të ekzekutojnë vendimin e prokurorit të shtetit apo të gjykatës. Me këtë formulim, Kodi u ka hapur rrugë edhe agjencive të tjera për të kryer hetime apo për të ushtruar detyra të parashikuara në të.

Inspektorati Policor i Kosovës, bazuar në Ligjin nr.03/L-231, është agjenci e autorizuar dhe me kompetencë për të hetuar penalisht zyrtarët policorë të Kosovës. Ai ka edhe disa kompetenca të tjera të kufizuara administrative. Me këtë ligj, hetuesve të IPK-së u janë dhënë kompetencat e zyrtarit të autorizuar policor, që parashikon KPP në procedurën hetimore.

Në nenin 2, të ligjit për IPK, në fushëveprimin e kësaj agjencie përfshihen: parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite, gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj. Në mënyrë më specifike, këto kompetenca të IPK për hetimet penale përcaktohen në nenin 17, Hetimet penale. Sipas tij, hetuesit e IPK-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre kanë kompetenca policore dhe i ushtrojnë ato në përputhje me Kushtetutën, me KPK-në, KPPK-në, me këtë ligj, si dhe me ligjet dhe akte nënligjore të tjera në fuqi.

Ky nen përfshin edhe hetimet mbi incidentet e profilit të lartë disiplinor, si dhe hetimin disiplinor të zyrtarëve policorë me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe të zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv.

Kur në bazë të dhënave që disponohen, dyshohet se një punonjës i Policisë, i cili është subjekt i hetimeve të IPK-së, sipas këtij ligji, sepse ka kryer një veprë penale ose planifikon apo organizon të kryejë një krim dhe kjo veprimtari nuk mund të zbulohet ose të parandalohet në rrugë e mënyra të tjera, hetuesit e IPK-së mund të përdorin masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit, të hetimit dhe të procedurës së parashikuar në Kodin e Procedurës Penale (Ligji për IPK, 2010:9).

Në nenin 2 të ligjit, thuhet se IPK, gjatë hetimit, është i autorizuar të mbledhë informacione dhe dëshmi, për të përcaktuar sjelljen e punonjësit të Policisë, për të cilin është iniciuar rasti.

Hetuesit e IPK-së i ushtrojnë kompetencat e tyre në pajtim me Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale parashikohen qartë mënyrat se kush ka të drejtë të iniciojë një hetim penal ndaj një qytetari, më konkretisht, kush ka të drejtë të bëjë një kallëzim penal. Sipas KPPK-së, kallëzimin penal te prokurori publik ka të drejtë ta bëjë çdo qytetar dhe policia. “Pavarësisht sistemit, roli i prokurorit me ndryshime të parëndësishme, është kudo i njëjtë. Ai përcakton dhe vë në jetë politikat e një vendi dhe përfaqëson mënyrën institucionale, shtetin në procesin penal” (Spiro, 2012).

Në rast dyshimi ndaj zyrtarëve policorë, kallëzimi penal mund të ushtrohet si nga qytetarët, po ashtu edhe nga policia. Por, ekskluzivisht, të drejtën për të ngritur kallëzim penal, sipas detyrës zyrtare, e ka Inspektorati Policor i Kosovës, i cili, sipas ligjit, është përgjegjës për hetimin e veprave penale ndaj zyrtarëve policorë dhe për hetimin e një

kategorie të caktuar të veprave administrative – disiplinore, të cilat janë të përcaktuara qartë me ligj.

Për hetimin sa më efikas të veprave penale që kryhen nga punonjës të PK-së është paraparë edhe obligimi ligjor i punonjësve të vetë Policisë për të njoftuar mbikëqyrësit e tyre për çdo rast me elemente të shkeljes penale apo të shkeljes administrative, ku janë përfshirë zyrtarë të policisë.

Të gjithë punonjësit e Policisë janë të detyruar t'ua raportojnë mbikëqyrësve të tyre rastet e shkeljeve të standardeve të disiplinës apo të veprave penale që përfshijnë punonjësit e Policisë. Punonjësit e Policisë duhet të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë dokumentacionin e nevojshëm gjatë hetimeve dhe procedurës disiplinore. (Policia e Kosovës, 2013: 5-6).

3.4 Mbikëqyrja dhe kontrolli institucional i Policisë së Kosovës

Me mekanizma efikase të menaxhimit të disiplinës në polici, kontrollit dhe të mbikëqyrjes, ndikon fuqishëm parandalimi i sjelljeve të pahijshme, të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, korrupsionit dhe të kryerjes së veprave penale nga punonjësit e policisë. Përpjekjet e drejtuesve dhe të këtyre mekanizmave duhet të orientohen në mbikëqyrjen e vazhdueshme të ndryshimit të sjelljes dhe të qëndrimeve të personelit.

Identifikimi i hershëm i dyshimeve të sjelljeve devijante të ndonjë zyrtari policor dhe i faktorëve që ndikojnë në këto sjellje është e rëndësishme në identifikimin e zyrtarëve që duhet të mbahen nën mbikëqyrje, të këshillohen, të ndihmohen në punë.

Autorët, Thibault, Lynch, McBride, por edhe Swanson, Territo, Taylor, kanë trajtuar nevojën për krijimin e një sistemi të paralajmërimit të hershëm për identifikimin e zyrtarëve problematikë:

Është i mundshëm menaxhimi i rrezikut të zyrtarëve policorë që përfshihen në korrupsion apo në sjellje brutale, duke zhvilluar një sistem të paralajmërimit të hershëm për të identifikuar zyrtarët që janë në rrezik. Ky sistem i paralajmërimit të hershëm funksionon më së miri në departamentet që janë të përkushtuar në zbulimin dhe në punën me zyrtarët problematikë. Ndalon problemet e fshehura të rriten dhe të bëhen skandale të mëdha policore dhe e bën të vështirë që departamentet t'i injorojnë dhe t'i mbulojnë sjelljet e zyrtarëve problematikë (Thibault, Lynch, McBride, 2007: 267).

Sistemi i paralajmërimit të hershëm është një mjet menaxhimi i bazës së të dhënave të policisë, i projektuar për të identifikuar zyrtarët me sjellje problematike dhe për të ndërhyrë për përmirësimin e performancës së tyre. Si përgjigje, departamenti reagon në kohë, para se një zyrtar i tillë të vijë në atë situatë ku rrezikon të kryejë shkelje disiplinore. Sistemi lajmëron departamentin për këta individë dhe i paralajmëron zyrtarët që gjatë këshillimit apo trajnimit t'i ndihmojnë ata të përmirësojnë sjelljet e tyre problematike. (Swanson, Territo, Taylor, 2005: 416)

Mbikëqyrësi që heton ankesën kundër vartësit të tij duhet të ndjekë çdo kanal hetimi në dispozicion të tij në kërkimin e së vërtetës. Ai duhet të mbetet objektiv në qasjen e tij dhe të shmanget nga nxjerrja e përfundimeve të pafajësisë apo fajësisë para se të njihen faktet". (Iannone, 2001: 247).

“Qëllimet parësore në administrimin e veprimeve të hetimit efektiv të ankesave ndaj personelit janë mbrojtja e integritetit dhe e reputacionit të forcës policore, mbrojtja e interesit publik dhe mbrojtja e zyrtarit të akuzuar nga akuzimi i padrejtë” (Iannone,

Iannone, 2001:215). Në funksion të kësaj, procesi i hetimit dhe dhënia e masave disiplinore duhet të jenë në pajtueshmëri të plotë me normat ligjore.

Në përputhje me Kodin Evropian të Etikës Policore, në Kosovë është hartuar Ligji për Policinë dhe Kodi i Etikës së PK-së. Kodi i Etikës i PK-së është hartuar mbi bazën e parimeve të cekura më lart, por edhe të dokumenteve të tjera. Në nenin 2 të Ligjit për Policinë jepen parimet udhëzuese, mbi të cilat duhet të udhëhiqet PK-ja, parime që janë të përcaktuara nga Këshilli i Evropës:

Parimet udhëzuese sipas ligjit të policisë, aktet e brendshme rregullative, procedurat e punës, planet strategjike, planet e trajnimit dhe edukimit, si dhe vlerësimi i performancës duhet të reflektojnë siguri dhe vullnet për një shërbim policor me dinjitet dhe respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive të njeriut. Organizata policore duhet të marrë masa efektive për të siguruar integritet dhe performancë të mirë të stafit policor, në veçanti, për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore individuale, siç parashihen, posaçërisht, në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. (Council of Europe, 2002: 44).

Për ruajtjen dhe forcimin e integritetit policor dhe për parandalimin e shkeljeve të Kodit të Etikës, të shkeljeve ligjore dhe të kryerjes së veprave penale nga zyrtarët e PK-së, përcaktuese dhe shumë të rëndësishme janë funksionet e menaxhimit të personelit në polici. Këtu kemi parasysh planifikimin e burimeve njerëzore, përcaktimin e kritereve për punësim, procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësve policorë, punësimin dhe caktimin në pozitë të tyre, zhvillimin e karrierës, trajnimin dhe formimin profesional, vlerësimin e performancës, por edhe të shpërblimit.

Sjellja e forcave policore ndaj publikut mund të shihet si një nga treguesit kryesorë të cilësisë së demokracisë në një vend. (IPU&DCAF, 2003: 61).

3.5 Administrimi i masave disiplinore në Policinë e Kosovës

Me aprovimin e rregullores nga ana e PSSP-së për Shërbimin Policor të Kosovës, u përcaktuan edhe shkeljet disiplinore, masat disiplinore dhe autoritetet vendimmarrëse në hetimet dhe dhënien e masave disiplinore. Sipas Rregullores nr.2005/54 të UNMIK-ut “Mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës”, shkeljet e rënda disiplinore konsideroheshin; (a) Sjellja e pahijshme e rëndë, (b) Mosbindja e rëndë, (c) Zbulimi i pavend dhe i rëndë i informatave, (d) Korrupsioni, (e) Shkelja e rëndë e kompetencave, (f) Përdorimi i pavend i armës, (g) Përdorimi i tepërt i forcës, (h) Dëmtimi i rëndë i pasurisë së policisë, (i) Përdorimi i alkoolit ose substancave të tjera in toksike, (j) Ngacmimi seksual gjatë shërbimit, (k) Keqpërdorimi dhe shfrytëzimi seksual i ndonjë personi dhe (l) Veprimtaria penale. (UNMIK, 2005: 5).

Në përkufizim vërejmë se korrupsioni dhe veprimtaria penale janë cilësuar shprehimisht si shkelje të rënda.

Sipas Rregullores nr.2005/54, parashikohej edhe krijimi i autoritetit vendor për çështje të disiplinës. Sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje: Komisioni për emërime të larta dhe disiplinë në polici (KELDP) themelohet me autorizimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. KELPD përbëhet prej kryesuesit, zëvendës kryesuesit dhe anëtarëve të tjerë. (UNMIK, 2005:4). KELDP ishte i autorizuar për rekomandimin e masave disiplinore për shkelje të rënda, kurse vendimi merrej nga Komisionari i Policisë së UNMIK-ut.

Masat disiplinore për shkelje të rëndë ishin: a) Shkarkimi, b) Ulje e gradës, c) Largimi nga pozita komanduese, d) Pezullimi, pa pagë, deri në gjashtëdhjetë ditë dhe e) Gjorbitje, që nuk është më e madhe se 50% e pagës mujore bruto (UNMIK, 2005:5). Përveç shkeljeve të rënda disiplinore me këtë rregullore parashikoheshin edhe shkeljet e lehta disiplinore. Polici ose zyrtari i personelit civil, i punësuar nga Shërbimi Policor i Kosovës, kryen shkelje të lehtë disiplinore, kur ai është fajtor për njërin prej veprave të mëposhtme: (a) Sjellje e lehtë diskredituese, (b) Mosbindje e lehtë, (c) Pakujdesi në detyrë, (d) Zbulim i lehtë pa vend të informatave, (e) Keqpërdorim i lehtë i kompetencave, (f) Dëmtim i lehtë i pasurisë së policisë ose (g) Mbajtje e papërshtatshme e uniformës dhe paraqitje e papërshtatshme personale. (Rregullorja nr.2005/54 UNMIK).

Ndryshe nga procedura për shkeljet e rënda, rekomandimi për masën disiplinore për shkelje të lehta jepet nga Njësia e Standardeve Profesionale, kurse vendimi merret nga Komisionari.

Zyrtari i Policisë së Kosovës ose i personelit civil në Shërbimin Policor të Kosovës, i cili ka kryer shkelje të lehtë disiplinore i nënshtrohet njërit prej këtyre ndëshkimeve:

- (a) Ulje grade,
- (b) Caktimi në detyrë tjetër,
- (c) Pezullimi, pa pagë, deri në tridhjetë ditë,
- (d) Gjorbë, që nuk është më e madhe se 50% e pagës mujore bruto ose
- (e) Qortimi.

Tani, çështja e disiplinës në PK është e rregulluar në bazë të Ligjit për Policinë dhe Udhëzimit Administrativ nr.06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedura Disiplinore në Policinë e Kosovës. Me këtë udhëzim janë përcaktuar llojet e shkeljeve disiplinore, masat

disiplinore, roli dhe detyrat e Drejtorisë së Standardeve Profesionale, roli dhe detyrat e Komisionit Disiplinor, roli dhe përgjegjësia e Komisionit për Ankesa dhe çështje të tjera me rëndësi për procedurën disiplinore. Ndër të tjera, ky udhëzim parashikon edhe parimin dyshkallësh në procedurë disiplinore, që nuk ekzistonte gjatë administrimit të disiplinës nga policia e UNMIK-ut.

Për rritjen e efikasitetit dhe trajtimin me kompetencë të të gjitha informacioneve për pretendime të shkeljes disiplinore nga zyrtarët e PK-së, Udhëzimi Administrativ 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedura Disiplinore përcakton: çdo mbikëqyrës i punonjësit të Policisë, Drejtoria e Standardeve Profesionale, çdoherë kur merr informatë nga individët apo mediat e shkruara dhe elektronike, radiotelevizioni dhe interneti, fillon një hetim paraprak për konstatimin e supozimit të ekzistimit apo mosekzistimit të shkeljeve disiplinore.

3.6 Shkeljet e rënda disiplinore

Shkeljet disiplinore janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 06/2012 për shkeljet, masat dhe procedura disiplinore.

Në nenin 12 të Udhëzimit, theksohet: shkelje e rëndë disiplinore konsiderohet veprimi ose mosveprimi i punonjësit të PK-së, punonjësit që bashkëpunon me të ose atij që nxit kryerjen e shkeljeve të mëposhtme:

- Sjellje e rëndë diskredituese,
- Mosbindje e rëndë,
- Zbulimi i pavend dhe i rëndë i informatave,

- Korrupsioni,
- Shkelje e rëndë e kompetencave,
- Përdorimi i pavend i armës,
- Përdorimi i tepërt i forcës,
- Dëmtimi i rëndë i pasurisë së Policisë,
- Përdorimi i alkoolit dhe substancave in toksike,
- Ngacmimet seksuale,
- Veprimet diskriminuese në bazë të moshës, gjinisë, orientimit seksual, përkatësisë etnike apo fetare
- Veprimtaria penale.

Pas kompletimit të procedurës hetimore për shkeljet disiplinore, Drejtoria e Standardeve Profesionale e dërgon materialin me rekomandime në Komisionin e Brendshëm Disiplinor, për caktimin e masës disiplinore. Masat që mund të jepen ndaj punonjësit të PK-së në rastet e shkeljeve të rënda disiplinore parashikohen në nenin 45 i Udhëzimit administrativ 06/2012 siç janë:

- a) ndërprerja e marrëdhënies së punës,
- b) ulje grade - jo më shumë se një gradë,
- c) largim nga pozita komanduese apo largim në një pozitë tjetër me përgjegjësi më të ulët, por pa e humbur gradën dhe kategorinë funksionale,
- ç) ndalesën në pagë, mbi 20% deri në 30% të pagës mujore bruto prej dy deri në gjashtë muaj.

Krahas masave të përcaktuara me këtë udhëzim, mund të jepen edhe masa plotësuese, të parashikuara në nenin 45, pika 2, të të njëjtit udhëzim:

- a) transferim administrativ,
- b) trajnim i detyruar,
- c) këshillim mjekësor/psikologjik dhe
- ç) ndalesë drejtimi të automjetit të PK-së deri në 1 vit.

Duhet theksuar se, sipas Udhëzimit administrativ për disiplinën, korrupsioni dhe veprimtaria penale parashikohen shprehimisht si shkelje të rënda. Neni 17 i Udhëzimit Administrativ 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedura Disiplinore përkufizon se:

Punonjësi i Policisë së Kosovës është fajtor për korrupsion nëse:

- Në cilësinë e zyrtarit policor apo të stafit civil të Policisë së Kosovës dhe pa autorizim përkatës, në mënyrë direkte ose indirekte, kërkon ose pranon ndonjë të mirë materiale, dhuratë, çfarëdo shërbimi, nënshkrimi ose rekomandimi;
- Merr obligime financiare ose obligime të tjera ndaj ndonjë personi tjetër në atë mënyrë që mund të ndikojë në kryerjen si duhet të detyrave si punonjës i Policisë së Kosovës;
- E keqpërdor pozitën e tij apo të saj si punonjës i Policisë së Kosovës, për leverdi personale, për vete ose për të tjerët;
- E vë veten në konflikt interesi, duke ndërmarrë veprime me të cilat kufizon, rrezikon apo pengon përmbushjen e detyrave zyrtare.

Kurse Neni 25, 'Veprimtaria penale', i të njëjtit udhëzim përcakton se: punonjësi i PK-së është fajtor, nëse për veprën penale apo kundërvajtjen e rëndë që ka kryer është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas ligjit në fuqi nga cilado gjykatë, që njihet nga ligjet e Kosovës. (Udhëzimi Administrativ 06/2012 i PK-së)

3.7 Shkeljet e lehta disiplinore

Shkeljet e lehta disiplinore përkufizohen në nenin 13 dhe si të tilla përcaktohen:

- Sjellja e lehtë diskredituese,
- Mosbindja e lehtë,
- Pakujdesia në detyrë,
- Zbulimi i pavend dhe i lehtë i informatave,
- Keqpërdorimi i lehtë i kompetencave,
- Dëmtimi i lehtë i pasurisë së Policisë,
- Mbajtja e papërshtatshme e uniformës dhe paraqitja e papërshtatshme personale.

Masat për shkelje të lehta disiplinore për punonjësit e PK-së parashikohen në nenin 44 të

Udhëzimit Administrativ 06/2012, për Shkeljet, Masat dhe Procedura Disiplinore:

1. Masat që mund të merren ndaj punonjësit të PK-së në rastet e shkeljeve të lehta disiplinore janë:

- Vërejtje me gojë;
- Vërejtje me shkrim;
- Ndalesë në pagë, 5%-20% nga paga bruto, deri në dy muaj;

2. Krahas masave të përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të jepen edhe masa plotësuese:

- këshillim mjekësor/psikologjik;
- ndalesë drejtimi të automjetit të PK-së deri 6 muaj dhe
- transferim administrativ vetëm me masën disiplinore nga paragrafi 1.3 i këtij neni.

3. Autoritetet për trajtimin, shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore janë:

Mbikëqyrësi i punonjësit; Komisioni i Brendshëm Disiplinor; Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime .

4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, të gjitha masat disiplinore sipas kompetencës nga ligji i IPK-së; Ministri i MPB-së, si shkallë e dytë dhe Kryeministri, sipas ligjit të Policisë dhe IPK-së.

Nëse gjatë hetimeve paraprake gjenden elemente të veprës penale, niveli lokal apo DSP, bazuar në Ligjin e IPK-së, ia kalon raportin IPK-së apo Departamentit të Hetimeve, të Policisë së Kosovës.

Sipas raportit vjetor 2014, nga 421 ankesa të qytetarëve, që janë trajtuar, vetëm 70 prej tyre janë gjetur të bazuara, kurse 351 raste (83%) ishin të pabaza. Kurse nga 220 raste të trajtuara si inicime të brendshme, pas procesit hetimor doli që 174 raste ishin të bazuara, kurse 46 raste (20%) nuk qëndronin. Siç shihet, ekziston një diferencë: 57% më shumë raste të pabazuara janë gjetur nga hetimi i rasteve të iniciuara nga qytetarët, në krahasim me rastet me inicim të brendshëm. Kjo mund të shpjegohet me faktin se inicimi i hetimeve të brendshme bëhet, kryesisht, nga zyrtarët policorë, të cilët kanë më shumë njohuri për rregullat, procedurat dhe kompetencat ligjore dhe, për rrjedhojë, raportet e inicimeve të brendshme janë më të bazuara dhe të argumentuara. Sidoqoftë, sugjerohet rishikimi i rasteve të gjetura si të pabazuara, me qëllim gjetjen e të vërtetës, pasi kështu rriten besueshmëria dhe transparenca. (Raporti vjetor 2014 i PK-së)

3.9 Roli i institucioneve të mbikëqyrjes dhe të kontrollit

Mbikëqyrja dhe kontrolli demokratik i organizatave policore është parim bazë për sundimin e ligjit dhe shtetin ligjor. Në bashkësinë ndërkombëtare ekziston konsensusi që legjislacioni dhe masat kundër korrupsionit duhet të zbatohen dhe të monitorohen nga organe të specializuara dhe/apo personel me kompetenca, burime dhe me trajnimin e duhur. “Për këtë duhet të ketë mekanizma që sigurojnë nivel të lartë të autonomisë strukturore, operative dhe financiare të institucioneve dhe të personave përgjegjës për luftimin e korrupsionit, për t’i mbrojtur ata nga ndikimet e padrejta politike. (OECD, 2008:17).

Institucionet e mbikëqyrjes së policisë kanë detyra të shumta dhe komplekse. Roli i tyre qëndron në kërkesat për zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore nga zyrtarët policorë, për ruajtjen dhe forcimin e vlerave etike, ngritjen e profesionalizmit, të performancës dhe të efikasitetit të tyre në punë. Gjithashtu, ato luajnë një rol të madh në menaxhimin e burimeve njerëzore, në proceset e rekrutimit, përzgjedhjes dhe trajnimit të personelit, në vlerësimin dhe shpërblimin e secilit, në ruajtjen e barazisë dhe të diversitetit të punonjësve të policisë. Ato mbikëqyrin edhe menaxhimin e pronës dhe të financave, procedurat e prokurimit, marrëdhëniet me publikun, administrimin e ankesave të qytetarëve, administrimin e disiplinës, hetimet penale, mbrojtjen e të dhënave dhe realizimin e objektivave të përgjithshme dhe specifike, të përcaktuara në dokumentet strategjike të policisë dhe të qeverisë.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i mbikëqyrjes dhe i kontrollit të policisë është shqyrtimi apo vlerësimi i përputhjes së akteve nënligjore me ligjet në fuqi dhe zbatimin e tyre në

praktikë. Ato udhëhiqen nga parimi, sipas të cilit policia gjithmonë duhet të veprojë në bazë të ligjeve. Policët u nënshtrohen të njëjtave ligje, të cilat duhet t'i zbatojnë dhe t'i mbrojnë.” (IPU&DCAF, 2003:61).

Policia e Kosovës ka, tashmë, një sistem të kompletuar të kontrollit të brendshëm: të inspektimit, të auditimit, të disiplinës, të mbrojtjes së të drejtave të personelit, të shqyrtimit të përdorimit të forcës etj. Lidhur me kontrollin e jashtëm, Ligji për Policinë përcakton se: Policia funksionon nën autoritetin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të policisë. Drejtori i përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit për administrimin dhe menaxhimin e policisë. (Ligji për Policinë, 2012:4).

Rolin kyç në kontrollin e brendshëm në PK e luajnë njësitë e strukturuar për këtë qëllim, të cilat kanë të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë. Të tilla janë: Drejtoria e Standardeve Profesionale, Komisioni Disiplinor, Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime, Komisioni për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës, Drejtoria e Personelit, Njësia e Inspektimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe njësi të tjera. Këto kanë përgjegjësi në mbikëqyrjen e zbatimit e praktikave dhe standardeve të policimit demokratik.

KAPITULLI I KATËRT

4. Inspektimi

Çfarë është inspektimi:

Inspektimi është një proces me anë të cilit individët monitorohen për të pasur qasje në të drejtat ose punët e tyre. Inspektimi, në një formë apo formë tjetër, praktikisht ndërmerret për të gjitha pozitat në qeveri ose biznes.

Për shembull, sa herë që një aplikues për punë pyetet për prapavijën kriminale, kjo paraqet një formë të inspektimit. Në sektorin e sigurisë, inspektimi mëton të jetë shumë më rigoroz dhe i gjerë. Atëherë kur bëhet në mënyrë të duhur, ai paraqet pjesën vitale të procesit të kundërzbulimit.

4.1 Përse është i domosdoshëm inspektimi?

Inspektimi është i domosdoshëm për të përjashtuar nga postet publike individë të cilët paraqesin kërcënim për shtetin për shkak se ata:

- kanë pikëpamje anti-kushtetuese;
- janë të lidhur me grupe terroriste, krimin e organizuar ose grupet politike influencuese; ose janë të predispozuar ndaj presionit, dhunës ose korrupsionit.

Për më tepër, inspektimi ndihmon që të:

- sigurohet integriteti dhe ndershmëria e personelit dhe ndalimi i mashtrimeve;
- mbrojtja e VIP-ve, vendeve të ndjeshme dhe informacionit të klasifikuar; dhe
- dekurajimi i individëve të papërshtatshëm, në rend të parë për të aplikuar për poste të ndërlidhura me sigurinë.

4.2 Kush ka nevojë të inspektohet?

Inspektimi zakonisht kërkohet të bëhet për secilin që ka qasje në informatat ose vendet e ndjeshme, ose që ka kompetenca të rëndësishme. Kandidatët për postet vijuese, pothuajse

gjithmonë inspektohen: personeli që shërben për anëtarët kryesorë të ekzekutivit; pjesëtarët e forcave të sigurisë (inteligjencës dhe agjencive të sigurisë, ushtrisë, policisë kombëtare dhe xhandarmërisë); personeli i parlamentarëve të mandatuar për aparatën e mbikëqyrjes dhe të sigurisë kombëtare; personeli me qasje fizike në vendet e ndjeshme; dhe personat joqeveritar, të punësuarit nga kontraktuesi ose institutet kërkimore, që kanë qasje në informatat e klasifikuara, ose që kryejnë shërbime për qeverinë lidhur me çështjet e sigurisë kombëtare. Përveç kësaj, disa vende kërkojnë edhe inspektimin e zyrtarëve të zgjedhur, të cilët kanë qasje në informatat e ndjeshme.

Të tjerat pre supozojnë se mandati publik i një zyrtari të zgjedhur paraqet nivel të mjaftueshëm të besimit, për ta arsyetuar qasjen tek pushteti dhe informatat.

Gjermania, për shembull, kërkon inspektimin e parlamentarëve që janë anëtarë të komiteteve të mbrojtjes dhe inteligjencës, ndërsa Shtetet e Bashkuara nuk e bëjnë një gjë të tillë. Shiko përmbledhjen për Komitetet Parlamentare të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Inspektimi nuk bëhet vetëm në kohën kur bëhet rekrutimi. ‘Pakujdesi’, siç quhet ndonjëherë, ushtrohet në intervale të rregullta (zakonisht së paku çdo pesë ose dhjetë vite), dhe gjithashtu në çdo kohë kur ekziston çfarëdo dyshimi lidhur me besueshmërinë e ndonjë individi. Mbikëqyrësit shpeshherë trajnohen për të qenë në gjendje që t’i njohin sjelljet e dyshimta, dhe bashkëpunëtorët inkurajohen të raportojnë çfarëdo aktiviteti të pazakonshëm ose arsyeje shqetësuese. Përveç kësaj, nëse ka ndërrim të detyrave të personelit, menaxherët duhet të vlerësojnë nëse individët e tillë kanë nevojë për inspektime të mëtutjeshme. Disa ndryshime të pozitive të punës mund të kërkojnë inspektimin në nivel edhe më të lartë. Disa vende, gjithashtu, mund të kërkojnë nga qeveritë tjera, që të vërtetojnë se shtetasit e tyre janë inspektuar në mënyrë adekuate, në

rast të ndonjë aktiviteti të përbashkët në sektorin e sigurisë, siç mund të jetë prokurimi dhe zhvillimi i armëve ndërkombëtare. Një proces i tillë zakonisht është i kodifikuar në formë të memorandumit të mirëkuptimit, ose marrëveshjeve tjera. www.quality.co.uk/.

4.3 Kush e realizon inspektimin?

Në shumicën e rasteve, individi ose departamenti që është përgjegjës për inspektim është i ndarë dhe i ngarkuar me detyrën e rekrutimit. Ekzistojnë tri mënyra të ndryshme esenciale për t'i organizuar aktivitetet inspektuese.

Në shumicën e vendeve, shërbimet e sigurisë, ato të inteligjencës ose të një agjencie të specializuar, kryejnë punën e madhe të inspektimit kombëtar, ndërsa disa agjenci bëjnë inspektimin e aktiviteteve të tyre. Një metodë e tillë e centralizuar ndihmon që të sigurohet se:

- respektohen procedurat standarde të inspektimit;
- agjencitë individuale nuk kanë nevojë që t'i zhvillojnë kapacitetet e tyre për inspektim, duke ua mundësuar që të përqendrohen në misionet e tyre kryesore; dhe
- burimet e përdorura janë shfrytëzuar në mënyrë optimale, duke eliminuar kapacitetet e panevojshme.

Megjithatë, agjencionet i rezistojnë një metode të centralizuar, më qëllim që t'i mbajnë nën sekret të dhënat për personelin e tyre, të mbajnë kontrollin rreth proceduarave të tyre të inspektimit, si dhe kritereve për rekrutim. Në disa vende, secila agjenci është përgjegjëse për inspektimin e vet. Në Zvicër ka një sistem të decentralizuar, në të cilin çdo agjenci federale ose e kantonit, e bën inspektimin për vetveten. Agjencia kontraktuese është përgjegjëse në rastet kur inspektohen punëtorët e kontrakturave. Disa vende, për të

zvogëluar shpenzimet, angazhojnë nga jashtë biznese private, të cilat kryejnë detyrat e inspektimit. Një gjë e tillë zakonisht përfshin aktivitete si të kontrollit të të dhënave kreditore ose kriminale, të cilat në masë të theksuar bazohen në të dhënat e siguruara apo grumbulluara nga kompanitë private.

Shumica e vendeve aplikojnë një përzierje të këtyre proceduarave. Në Kanada, për shembull, përveç për Policinë Mbretërore Kanadeze, tërë inspektimi qeveritar bëhet nga një agjenci e vetme, Shërbimi Inteligent Kanadez i Sigurisë (SHIKS).

Në Mbretërinë e Bashkuar (MB), Agjencia Inspektuese e Mbrojtjes kryen inspektimin për shërbimin e armatosur, personelin civil të Me, personelin e shërbimit inteligjent, të mbrojtjes dhe kontrakturave në fushën e mbrojtjes, e gjithashtu edhe të industrive private, bazuar në ri pagesa. Pesë agjenci tjera, gjithashtu kryejnë aktivitete inspektuese, duke përfshirë edhe vetë personelin e tyre: Shërbimi Inteligent, agjencitë inteligjente të jashtme dhe të sinjaleve, ministria e punëve të jashtme dhe Zyra Civile e Sigurisë Nukleare.

Në SHBA, janë dy agjenci të cilat kryejnë pjesën më të madhe të inspektimit, FBI (për të rekrutuarit e vet, kurse për agjencitë tjera federale siç është Shtëpia e Bardhë, Departamenti i Drejtësisë, Zyra Administrative e Gjykatave të SHBA dhe komitetet e caktuara të dhomës së senatit dhe kongresit, e gjithashtu edhe zyrtarët shtetëror dhe lokal të cilët kanë nevojë për qasje në informatat e klasifikuara) dhe Zyra e Menaxhimit të Personelit (ZMP) (për shumicën e agjencive tjera federale civile, ndonjëherë në bashkëpunim me departamentin e mbrojtjes). Agjencitë tjera, siç është departamenti i shtetit dhe agjencitë inteligjente, kryejnë aktivitete inspektuese për personelin e tyre.

Megjithatë, pavarësisht se kush e bën inspektimin, shumica e vendeve bëjnë përpjekje që të sigurohen se inspektimi është i standardizuar. Në Gjermani dhe në Zvicër, udhëzuesit për inspektim janë të kodifikuar në ligje. Në SHBA, këto janë të mandatuara nga urdhri presidencial. Pavarësisht nga autoriteti na i cili bën autorizimin, ato duhet të sigurojnë respektimin e procedurave standarde në tërë qeverinë dhe të vendosjes se mekanizmave mbrojtës demokratik kundër praktikave të sjelljes joprofesionale. www.quality.co.uk/.

4.4 Cilat janë disa nga teknikat kryesore të inspektimit?

Përderisa procesi i inspektimit ndryshon nga vendi në vend, në përgjithësi përdorën disa teknika standarde. Format e pranimit janë shpeshherë hapi i parë i procesit të inspektimit, të cilat kërkojnë nga individët që të paraqesin informatat vijuese:

- emrin e plotë dhe ndonjë emër të mëparshëm;
- historinë e punës;
- vendbanimin, prezencën dhe aktivitetet e bëra jashtë vendit;
- gjendjen financiare; dhe
- informata lidhur me kundërvajtjet ligjore të mëparshme dhe rastet e gjykimit. Përveç kësaj, format e pranimit zakonisht përfshijnë të ‘gjitha’ pyetjet e kapshme lidhur me atë se a ekziston ndonjë konflikt i interesit dhe kërkojnë nga aplikuesi që ta pranojë se gënjeshtër, keqinterpretimi i së vërtetës ose fshehja e qëllimshme e informatave, mund të paraqes bazë të mjaftueshme për mohimin e punësimit ose largimin e menjëhershëm nga puna.

Kontrolli elektronik mund të përfshij kontrollin e identitetit, i cili verifikon autentitetin e dokumenteve, siç janë: kartat e identitetit, pasaportat, certifikatat e lindjes, diplomat dhe dokumentet tjera, kontrollin e prapavijës, i cili mund të përfshijë veprimet në vijim:

- dosjet kriminale dhe të sigurisë kombëtare, duke përfshirë dosjet e huaja, nëse janë të përshtatshme;
- dosjet mjekësore, të cilat mund të zbulojnë se kandidati vuan nga ndonjë gjendje mjekësore ose psikologjike, e cila mund të bëhet pengesë në aftësinë e tij për t'u marrë me informata të ndjeshme; dhe
- dosjet financiare të subjektit dhe familjeve të tyre, si tregues të vështirësive serioze financiare ose të papërgjegjshmërisë, e cila mund t'i bëjë ata të jenë të predispozuar ndaj mitos, e gjithashtu edhe të pasurisë së pasqaruar.

Intervistat me subjektin janë një nga teknikat më të përgjithshme të inspektimit. Marrja në pyetje mund të përfshijë pyetje lidhur me detajet që janë dhënë në formën e pranimit, plus faktorë të tjerë siç mund të jenë: prapavija familjare, përvojat e kaluara, shëndeti, jeta personale, marrëdhëniet me shtetasit nga vende të caktuara, përdorimi i ilaçeve dhe alkoolit, lidhja me organizata të caktuara, pikëpamjet politike dhe aktivitetet e lira.

Kontrollimi i referencave në formë të shkruar ose përmes telefonit zakonisht është një aktivitet i obligueshëm, e gjithashtu edhe (në rastet e rëndësishme dhe shumë të ndjeshme) intervistat personale me shokët, mësuesit, miqtë e huaj, fqinjët dhe punëdhënësit. Në shumicën e rasteve, pëlqimi për këto intervista, para se ato të zhvillohen, duhet të jepet nga individi, i cili është duke u hetuar.

Një ndër arsytet, zakonisht më të vështira, dhe vonesat në kompletimin e kërkesave të inspektimit, është mos disponueshmëria ose papërshtatshmëria e referuesëve të nominuar

nga ana e kandidatit. Teknikat tjera, të cilat mund të përdoren, përfshijnë testet mjekësore dhe psikologjike, intervistat poligrafike dhe gjurmët e gishtave. www.quality.co.uk/,

4.5 Sa është i nevojshëm inspektimi?

Zakonisht ekzistojnë disa nivele të ndryshme të informatave ose vendeve të ndjeshme. Sa më shumë qasje në informata të klasifikuara, ose në qasje fizike në vende të ndjeshme që ofron një post, aq më rigoroz (dhe më i shtrenjtë) do të jetë procesi i inspektimit. Nuk ka një formulë magjike për të përcaktuar se çfarë informatash duhet klasifikuar dhe në cilin nivel. Këto zakonisht renditen në një rregull, sipas të cilit, ato mund të jenë të “klasifikuara”, “sekrete” dhe “top sekrete”. Procedurat e inspektimit për qasje në secilin nga këto nivele janë të ndryshme.

4.6 Çfarë sfidash paraqet inspektimi për të drejtat e njeriut dhe qeverisjen?

Nga vetë natyra e tij, inspektimi kërkon hetimin në jetën private të individëve, përtej asaj çfarë normalisht do të mund të lejohej nga qeveria. Miratimi duhet të merret nga subjekti para se të fillojë hetimi. I vetmi përjashtim i mundshëm janë rekrutët ushtarakë, të cilëve mund të mos u kërkohet pajtimi për disa masa të caktuara inspektuese.

Procesi i inspektimit u jep inspektorëve ndikim të madh në karrierën dhe jetët e atyre që kredencialet dhe karakteret e tyre bëhen subjekte të kontrollit.

Për ta ndaluar abuzimin nga ana e inspektorëve:

- inspektorët duhet t’u jenë nënshtruar kontrolleve më të larta të sigurisë në fushën në të cilën ata do të bëhen inspektor;

- inspektorët duhet të ri hetohen në intervale të rregullta, më qëllim që të ndalohet korrupsioni, në veçanti lidhur me dosjet financiare;
- personeli inspektues duhet të përfaqësojë në përgjithësi tërë popullsinë;
- subjektet duhet të kenë të drejtë t'i shikojnë rezultatet e hetimeve ndaj tyre; dhe
- subjektet duhet të kenë të drejtën për ankesë dhe të kërkojnë që të dhënat e pasakta dhe i relevante të hiqen nga dosjet e tyre.(www.quality.co.uk.)

4.7 Kriteret e papërshtatshme për inspektim

Zgjedhja e kriterëve të papërshtatshme mund të rezultojë në refuzimin e aplikuesve të kualifikuar ose përfshirjen e shumë aplikuesve të pakualifikuar. Në veçanti, janë të vështira kriteret për lidhjet politike, dosjet kriminale dhe përdorimi i ilaçeve dhe alkoolit në të kaluarën. Këto kriterë ndryshojnë nga vendi në vend. Në sistemet demokratike, kriteri politik, si një rregull i përgjithshëm, duhet të shërbejë vetëm për përjashtimin e ekstremistëve, të cilët do të mund të synonin rrëzimin e qeverisë më mjete jodemokratike. Në shumicën e vendeve, përdorimi i kufizuar i barnave ose kundërvajtjet e vogla kriminale në të kaluarën e largët, nuk janë pengesë për t'u punësuar në sektorin e sigurisë. In kompetencat për shkak të mungesës së të dhënave, ose të procedurave defektive. Procedurat e inspektimit mund të kërkojnë burime të mëdha.

Sipas ZMP të SHBA për vitin 2006, tabela e shifrave ndryshon prej 80\$ për një kontroll të thjeshtë të agjencisë kombëtare, deri në 3150\$ për një hetim standard të prapa vijës së kërkuar, për nivelin e pastërtisë top sekret.(www.quality.co.uk/).

Procedurat jo kompetente mund t'i rrisin këto çmime, ose rezultojnë me pritjen e individëve për kohë të pacaktuar, për t' marrë rezultatet e inspektimit të tyre. Për t'u

ballafaquar me probleme të tilla, duhet t'i jepet konsideratë faktit se a mund të këtë benifite në çmime dhe efikasitet në:

- standardizimin e proceduarave përgjatë tërë qeverisë,
- vlerësimin e disa funksioneve të caktuara të inspektimit, siç mund të jenë kontrolli i dosjeve nga një agjenci e centralizuar ose private, dhe
- thjeshtimi i qasjes në të dhëna, duke e përdoruar bazën kombëtare të të dhënave, ose procedurat standarde hulumtuese.

Sfidat e tilla theksojnë nevojën e inspektimit, i cili duhet të bëhet nga një kornizë ligjore e mirëfilltë për inspektim.

Një gjë e tillë duhet të përfshijë elementet vijuese:

- një statut kombëtar të sigurisë, i cili rregullon klasifikimin e informatave dhe procedurat e nevojshme inspektuese për të siguruar qasje në secilin nivel;
- ligjet për mbrojtjen e të dhënave, të cilat parashikojnë përjashtime nga rregullat për procedimin e informatave personale për kandidatët e inspektuar. Dosjet duhet të mbahen për një kohë të caktuar pas pensionimit ose vdekjes përpara se të shkatërrohen; dhe
- ligjet për të drejtat e njeriut dhe statutet jo diskriminuese, të cilat nuk ndalojnë monitorimin e individëve që punojnë për sigurinë kombëtare për shkak të faktorëve të tillë si: besimi etnik, pikëpamja politike, sëmundjet psikiatrike ose mjekësore, dhe origjina kombëtare - të gjitha klauzolat tjera jo diskriminuese duhet të aplikohen.

Cilat janë disa nga sfidat e veçanta për vendet në tranzicion dhe ato postkonfliktuale?

Inspektimi në vendet në tranzicion dhe ato postkonfliktuale është i lidhur ngushtë me çështjet e drejtësisë tranzicionale.

Në këtë situatë, inspektimi jo vetëm që përfshin monitorimin e punëtorëve për qasje në informata, por gjithashtu edhe monitorimin e individëve të akuzuar për kundërvajtje, si sjellje jodemokratike, dhunim i të drejtave njerëzore ose krime të luftës (ky proces në përgjithësi njihet si lustrim). Tranzicioni dhe shoqëritë postkonfliktuale ndeshën me shumë probleme të njëjta, të cilat ekzistojnë në demokracitë e konsoliduara. Megjithatë, në disa aspekte të caktuara, vështirësitë të cilat hasen gjatë inspektimit, mund të jenë më ekstreme: korniza ligjore zakonisht e pazhvilluar; institucionet mund të jenë të dobëta dhe të fragmentuara; burimet mund të jenë të pamjaftueshme për ta financuar procesin e inspektimit që përfshinë të gjitha nivelet e strukturave të sigurisë kombëtare:

- të dhënat për individët mund të mos ekzistojnë për shkak se mund të jenë humbur dosjet, mund të jenë shkatërruar ose të jenë bërë subjekt i manipulimit për motive politike;
- inspektorët mund të jenë të korruptuar ose të motivuar politikisht; dhe
- mund të ketë mungesë të kandidatëve, të cilët janë të kualifikuar dhe të pranueshëm, dhe kjo bën që kriteret e inspektimit të zvogëlohen dhe të merren ose promovohet personel i papërvojë.

(www.quality.co.uk/)

KAPITULLI I PESTË

KONTROLLI I POLICISË SË KOSOVËS

Qëllimi kryesor i kontrollit të policisë është: të kufizohet fuqia e saj, drejtimi i veprimtarisë së saj kah nevojat e shoqërisë (në vend të përdorimit të politikës), sigurimi i aktiviteteve të saj të përgjithshme nën parimin e sundimit të ligjit dhe për të parandaluar të

gjitha format tjera të devijimit nga detyrimet ligjore dhe procedurat për kryerjen e këtyre detyrave.

Në terminologjinë angleze fjala "control" (kontroll) shpesh përdoret në kuptim më të gjerë, sikurse veprim "ndikim vendimtar", ose ta kesh situatën në dorë etj. Gjatë zhvillimit shoqëror ky termin është përdorur në lëmit e ndryshme veprimitare. Rëndësia e mbikëqyrjes (kontrollit) është në atë, se ajo paraqet etapën relevante të fundit në ciklusin e udhëheqjes (planifikimi, organizimi, udhëheqja dhe mbikëqyrja (kontrolli)).

Numri i madh i qendrave, të cilat në bazë shkencore kanë studiuar organizimin, mbikëqyrjes (kontrollit) ia kanë dhënë rëndësinë dominuese. (Prof. dr. Ramo Maslesha, Policia dhe shoqëria, Sarajevë 2006, faqe 72).

Në fjalë, ata janë nisur nga ajo se udhëheqja do të thotë mbikëqyrje. Kontrolli në aspekt të krahasimit të rezultateve të vërteta me ato të pritura, e ka definuar H. Fayol (1916). Sipas atij, me kontrolluar do të thotë "të konstatuarit se a janë operacionet punuese në çdo kohë duke u zhvilluar në bazë të planeve të pranuar, me urdhëresat e dhëna dhe parimeve të vendosura". Glaser C. përfaqëson definicionin më të plotë. Ai mendon se kontrolli "krahason, shqyrton, kritikon, ajo stimulon planifikimin, thjeshtëson dhe forcon organizatën, ngrit suksesshmërinë e udhëheqjes dhe lehtëson lidhmërinë". (Glaser Comstock, Procedura administrative, Uashington, 1947, fq. 122 cituar nga Ramo Maslesha, Policia dhe shoqëria, Sarajevë, 2006 fq.73).

Çfarë rëndësie i kushtohet komponentës së kontrollit, na tregojnë edhe qëndrimet e udhëheqësve modernë, të cilët mendojnë se kontrolli, shkenca dhe përvoja paraqesin bazën themelore të ciklusit të udhëheqjes, me ç' rast duhet të kihet kujdes për dimensionet socio- psikologjike, meqenëse kontrolli mund të bjerë gjer tek implikimet.

Prandaj, shikimet moderne për kontrollin na tregojnë në disa predispozita elementare;

- Kontrolli është pozitiv, dhe fuqi natyrale pa të cilën udhëheqja nuk është e mundur dhe nuk është efikase;
- Kontrolli i udhëheqësit është efikas aq, sa ndikon në ndërrimin e sjelljeve të individëve në organizatë;
- Kontrolli efikas shtrihet në vleftësimin dhe lidhje të drejtë;
- Kontrolli efikas është pjesë e rëndësishme dhe njëra nga funksionet themelore të sistemit të informimit të organizatës.

5.1 Institucionet e kontrollit të policisë

Rëndësia e kontrollit është në atë, se kontrolli parqet etapën e fundit në ciklin e udhëheqjes (planifikimi, organizimi, udhëheqja dhe kontrolli (mbikëqyrja). Kontrolli ka rëndësinë dominuese, në këtë proces. Të kontrolluarit do të thotë “Të konstatuarit se a janë operacionet punuese në çdo kohë duke u zhvilluar në bazë të planeve, të pranuar në bazë të urdhëresave të dhëna dhe parimeve të vendosura”. Policia në çdo kohë duhet të veprë brenda kompetencave që i njeh ligji, dhe duhet ti nënshtrohet të njëjtit ligj që duhet të zbatohet dhe të mbrohet.

Sjellja e zyrtarëve policor kundrejt publikut mundë të shihet si një tregues i shkallës së demokracisë në një vend. Disa nga tiparet kryesore të demokratizimit të policisë sipas

Hans Bornit janë:

- a) shërbimet policore duhet të respektojnë sundimin e ligjit dhe të veprjnë në përputhje me kodin e etikës profesionale;

b) transparenca dhe ekzistenca e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm janë të nevojshme për të sigurua llogaridhënia nga ana e policisë; dhe

c) demokratizimi i policisë është një proces që shkon nga poshtë lart, duke iu përgjigjur nevojave dhe shqetësimeve të qytetarëve. Për të kontrolluar policinë e Kosovës duhet një punë e madhe.

Kjo organizatë ka numër të madh të policëve dhe mundësia e kontrollit adekuat të sajë, është mjaft e vështirë, andaj janë krijuar institucione të cilat duhet ta përcjellin dhe të bëjnë kontrollimin, mbikëqyrjen dhe inspektimin e punës së policisë së Kosovës (Ligji i Inspektoratit Policor të Kosovës).

5.2 Format e kontrollit të policisë

Qëllimet kryesore të kontrollit ndaj policisë janë: kufizimi i forcës – fuqisë, drejtimi i veprimtarisë së saj nevojave të shoqërisë (se sa veçanërisht nevojave politike), orientimi i veprimtarisë së përgjithshme të saj në principet e së drejtës pushtetare dhe pengimi i të gjitha llojeve tjera të shmangies nga detyrat ligjore dhe procedurave për kryerjen e detyrave të tilla.

Kontrolli parimisht është ”veprimtaria njerëzore e vetëdijshme dhe e përshtatshme e cila ka për qëllim që diçka të verifikoj – vërtetoj”.

Kontrolli ka qëllimin e fundit “shmangien apo korrigjimin e veprimeve të verifikuara, në mënyrë që puna e kontrolluar të kthehet në rrjedhat normale”. (Po aty).




Figura 1. Lloji i kontrollit ndaj Policisë




Figura 2. Kontrolli formal i jashtëm

Përveç ndarjes së kontrollit formal dhe joformal, e rëndësishme është edhe ndarja e kontrollit, në të brendshëm dhe të jashtëm.

Udhëheqja e organizatës policore në kushtet moderne kërkon krijimin e politikave në polici, e cila nga udhëheqësi policor kërkon aftësi të shumta dhe karakteristikat të tjera, si dhe aftësi të theksuara në udhëheqjen operative. Një ndër detyrat më të rëndësishme është, si të vepohet në nivelet subordinuese, në mënyrë që të motivohen për realizimin e qëllimeve të caktuara.

Nga kjo rrjedhë edhe fakti relevant se në atë proces rol të rëndësishëm paraqet edhe aftësia e kontrollit së organizatës policore, respektivisht, të konfirmohet gjendja e vërtetë

dhe të krahasohet me gjendjen e dëshiruar. Udhëheqësit në polici të cilët marrin detyrat e realizimit të komponentës kontrolluese mbi punën e njësive organizative, duhet të vlerësojnë zhvillimin e komponentëve të departamenteve të ndryshme, të cilat nëpërmes të kontrollit korrekt në masë të madhe do të mundësojnë lidhmëni më të madhe organizative, dhe efikasitet në punën e strukturave policore.

Udhëheqësi policor, i cili ka qëndrim të qartë kur është në pyetje komponenta e drejtuar e kontrollit dhe zbatimi i saj në rrethana konkrete, do të krijojë atmosferë të tillë në mbarë organizatën, e cila do të rezultojë që struktura policore të fitojë jo vetëm forma kualitative, por edhe bazën e përmbajtëse profesionale dhe specialiste, gjë që do të diktojë zgjidhjen e detyrave dhe përmbushjen e qëllimeve të institucionit dhe individuale në mënyrë të suksesshme.

Po ashtu, kontrolli i drejtuar eprorit i japë informata për: rregullsinë e qëllimeve të planifikuara, përparimit të punëve, shkallës së realizimit të qëllimeve në fazën e caktuar, angazhimit të shembullit të njerëzve dhe mjeteve, taktikës personale të udhëheqjes, aftësive të sjelljeve sociale të anëtarëve të policisë.

Nga të lartpërmendurit, mund të shënojmë se kontrolli në sistemin kooperativ të udhëheqjes paraqet pjesë të përbashkët procesit operativ të udhëheqjes në polici:

- Siguron marrëdhënie humane dhe ligjshmëri në punën e policisë;
- Ofron ndihmë policisë në planin e specialistikës dhe profesionalizmit;
- Te policia krijon bindjen e domosdoshmërisë, me qëllim të përmbushjes më efikase të detyrave të sigurisë e jo si “gjueti në gabime” me qëllim sanksionimi etj.

Teoria bashkëkohore për policinë njih dy forma të kontrollit të policisë në shumicën e shteteve në botë, kontrollin e brendshëm apo vetëkontrollin dhe kontrollin e jashtëm i cili realizohet nga institucionet e tjera. (Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës).

5.3 Kontrolli i brendshëm

Kontrolli i brendshëm i policisë nënkupton kontrollin që e bënë vetë policia apo vetëkontrollin, për zbatimin e autorizimeve të policisë, e në radhë të parë, të përdorimit të mjeteve të detyrimit.

Në kuadër të këtij studimi shkencor fokusi do të përqendrohet në kontrollin e jashtëm të policisë, por do të potencohet edhe kontrolli i brendshëm i policisë në mënyrë më sipërfaqësore.

Kontrolli i brendshëm i policisë së Republikës së Kosovës bëhet nga ana e eprorëve të policisë ndaj vartësve të tyre, dhe ky kontroll ushtrohet po thuaj se çdo ditë dhe në çdo moment. Natyra e punëve policore mundëson që kontrolli të jetë sa ma rigoroz dhe funksionon sipas zinxhirit komandues, nga poshtë lartë. (Parimet dhe Procedurat e PK-së).

5.4 Kontrolli i jashtëm

Kontrolli i jashtëm i policisë, zbulimi i keqpërdorimeve dhe tejkalimeve të autorizimeve, varet më së shumti nga ankesat e qytetarëve, pavarësisht se shumë polici verifikojnë ndershmerinë e pjesëtarëve të tyre, me metoda të ndryshme të kontrollit, prapë se prapë ka keqpërdorime në kryerjen e detyrave. Kontrolli i jashtëm më shumë ka të bëjë më veprimet policore të cilat bien ndesh me ligjet e aplikuara në vend dhe të cilat veprime

kanë elemente të veprave penale, ku poenta e këtij kontrolli është që të mblidhen prova dhe argumente me qëllim të inicimit dhe fillimit të procedurës penal ndaj atyre policëve të cilët dyshohen se janë të implikuar në raste të tilla.

Kontrolli i policisë së Kosovës bëhet nga mekanizma profesional dhe kompetent në kryerjen e detyrave të tyre, kur jemi te kontrolli i jashtëm mundemi të konstatojmë se një formë të kësaj kontrole pos institucioneve kompetente që merren me ndjekjen dhe gjykimin e kryesve (policëve) të veprave penale një formë të kontrollit të jashtëm të policisë së Kosovës bëhet në aspektin politikë bërjes së çështjeve të sigurisë nga Komisioni Parlamentar për Siguri dhe në aspektin administrativo-disiplinor nga Inspektorati Policor i Kosovës. (Komisioni për Siguri i Kuvendit të Kosovës).

5.5 Mjetet e kontrollit - formale të jashtme

Në mjetet e kontrollit formal të jashtëm bëjnë pjesë:

- Kontrolli parlamentar;
- Kontrolli qeveritar dhe organeve të tjera ekzekutive;
- Kontrolli i trupave joqeveritare;
- Kontrolli gjyqësor;
- Kontrolli i prokurorisë;
- Kontrolli gjyqësor kushtetues;
- Avokati i popullit.

5.6 Kontrolli parlamentar ndaj punës policore

Parlamenti në secilin shtet luan një rol shumë domethënës për strukturat e sigurisë, duke miratuar ligje që përcaktojnë shërbimet e sigurisë dhe kompetencat e tyre, duke ushtruar mbikëqyrjen demokratike dhe duke miratuar buxhetin e tyre, përfshirë këtu edhe trajtimin e ankesave të publikut.

5.6.1 Komisioni parlamentar për siguri (mbikëqyrja dhe kontrolli parlamentar)

Komisioni Parlamentar për Siguri, është trup punues i Kuvendit të Kosovës i cili bën mbikëqyrjen apo kontrollin parlamentar mbi segmentet e sigurisë. Ky komision angazhohet për të zhvilluar dhe mbikëqyrur politikat dhe strategjitë që kanë të bëjnë me sigurinë e brendshme, mbikëqyrë edhe shpenzimet dhe menaxhimin financiar të MPB-së dhe në veçanti të policisë së Kosovës, si dhe mbikëqyrë çështjet lidhur me masat disiplinore ndaj pjesëtarëve të policisë.

Komisioni parlamentar për siguri mbikëqyrë menaxhimin dhe dhënien e dokumentacionit personal dhe dokumentacioneve të udhëtimit. Gjithashtu mbikëqyrë implementimin e standardeve evropiane lidhur me strukturimin dhe veprimtarin e strukturave të sigurisë në Kosovë, si dhe komisioni së bashku me MPB-në, do të inicioj marrëveshje bilaterale dhe multilaterale në fushën e sigurisë dhe mbrojtjen kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Komisionit parlamentar të sigurisë i raportojnë personat përgjegjës në menaxhimin e lartë të sektorëve të sigurisë në Kosovë, duke iu dërguar raporte për punën që e bëjnë dhe hapat

të cilët do të ndërmarrin në të ardhmen me qëllim që të parandalojnë dhe hetojnë krimet të cilat mundë të kryhen. (Komisioni për Siguri i Kuvendit të Kosovës).

Ndonëse me kompetenca dhe përgjegjësi të ndryshme për fushën e sigurisë parlamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e këtyre strukturave. Këtë rol parlamenti kryesisht e kryen nëpërmjet komisionit parlamentar për siguri. Çdo legjislativ demokratik krijon komisionet e përhershme për të kryer funksionet dhe për të qenë sa me efikas . Komisionet parlamentare janë trupa punues të parlamentit që ushtrojnë funksione të caktuara nga rrethi i fushëveprimit të tij. (Dr. Bajrami, Arsim, Demokracia parlamentare, botim i katërt, 2005, Prishtinë, fq. 127).

Ky punim konsiston në trajtimin e përgjithshëm të Komisionit Parlamentar për Siguri, dhe komisionit parlamentar për siguri në Kosovë. (Komisioni për mbrojtje dhe siguri. buletin i DCAF. 2006).

Për shembull, SHBA ku kontrolli ndaj agjencioneve federale të policisë është në dorën e presidentit (si bartës i pushtetit ekzekutiv në sistemin presidencial), ai e kryen këtë nëpërmes drejtorit të FBI-së.

Kontrolli ndaj forcave të policisë të vendeve anëtare është në duart e guvernatorit si funksionari më i lartë i zgjedhur, ndërsa kontrollin ndaj policisë së qytetit është në duart e kryetarit të qytetit – komunës apo këshillit të qytetit. (Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri. buletin i DCAF. 2006).

Me ligjin e policisë së Kosovës përcaktohen raportet në mes të policisë, prokurorit publik dhe gjykatës. Policia bashkëpunon dhe i raporton Zyrës së prokurorit publik kompetent për informatat lidhur me akuzat për aktivitetet të dyshimta kriminale, për të cilat policia

është njoftuar në pajtim me ligjin e aplikueshëm. (Ligji mbi Policinë e Kosovës Nr.03/L-035).

5.7 Avokati i Popullit

Avokati i Popullit merret me ankesat e popullit në lidhje me vendimet, veprimet ose mosveprimet e administratës publike. Mbajtësi i këtij posti zgjidhet nga parlamenti ose emërohet nga kreu i shtetit ose i qeverisë, duke u këshilluar ose pas këshillimit me parlamentin. Roli i avokatit të popullit është që të mbrojë njerëzit kundër shkeljeve së të drejtave, shpërdorimit të kompetencave, gabimeve, shpërfilljes, vendimeve të padrejta dhe keqadministrimit me qëllim që të përmirësojë administratën publike dhe t'i bëjë veprimet e qeverisë më të hapura dhe qeverinë dhe nëpunësit e saj më të përgjegjshëm para publikut. Posti i avokatit të popullit mund të mishërohet në Kushtetutën e vendit dhe të mbështetet me ligj ose të krijohet me një akt të asamblesë ligjvënëse.

5.8 Kontrolli e jashtëm joformal

Varësisht nga niveli i demokratizimit të shoqërisë, është prezent ndikimi i publikut, mediave, partive politike, grupet e interesuara për presin dhe mekanizmave të jashtëm joformal në polici.

Mediat janë gjithashtu mjete të rëndësishme joformale të jashtme të kontrollit ndaj policisë. Postimi medial i punës policore dhe kriminalitetit është e përfaqësuar në dy drejtime dhe atë në të ashtu quajturat përmbajtje informative apo dokumentuese.

5.9 Kontrolli i brendshëm i punës policore

Kujt i përgjigjet policia?

Dikush duhet të jetë në gjendje të përgjigjet që ata janë përgjegjës të të përzgjedhurve, përfaqësuesve të publikut njerëzve me të cilët policia merret (p.sh. viktimave dhe të dyshuarve) dhe segmenteve të tjera të drejtësisë (prokurorisë apo gjykatave).

Pyetje bazike me të cilën fillojmë të bëjmë analiza është: “A e njohin mjaftueshëm qytetarët punën policore për ta bërë vlerësimin?”

A duhet policia të jetë e përgjegjshme për vlerësimin e veprimeve të policëve ?

Çka do të ndodhë nëse publiku spikat se policia po e shkel ligjin në mënyrë që të ndërmerret diçka ndaj shkelësve të ligjit?

Çështja e përgjegjësisë është çështje e publikuar dhe nuk ka mendime të njëjta sa i përket se kush e ka autoritetin për të vlerësuar përgjegjësin e policisë, kush i ka mjetet me të cilat do të vlerësohet si i përgjegjshëm dhe për çka të vlerësoj të përgjegjshëm (Geller, 1985).

5.9.1 Kontrolli i veprimeve të policisë bëhet në dy mënyra:

1. Mënyra e parë është nëpërmes mekanizmave mbikëqyrëse. Ato bazohen në konceptin nëse veprimet mund të vëzhgohen atëherë është e mundur të vërtetohet, korrigjohet apo të dënohen veprimet e pa ligjshme. Mekanizmat mbikëqyrës mund të jenë të brendshëm dhe të jashtëm.

Mekanizmat mbikëqyrës të brendshëm bëhet nëpërmes sistemit të hetimeve.

Mbikëqyrja e jashtme bëhet nëpërmes kontrollit civil dhe nëpërmes mjeteve juridike ndaj sjelljeve jo të drejta të policisë.

2. Mënyra e dytë është zbatimi i standardeve të sjelljeve. Në këtë aspekt policia mund të punësohen apo të edukohen në pajtim me standardet e sjelljeve me të cilat mund të vlerësojnë sjelljet e tyre. (Parimet dhe Procedurat e Policisë së Kosovës).

5.9.2 Mekanizmat mbikëqyrës në kuadër të policisë

Ekzistojnë dy lloje të mekanizmave mbikëqyrës në kuadër të policisë:

- 1. Mekanizmi mbikëqyrës menaxhues (udhëheqës)*
- 2. Procedura e hetimeve të brendshme.*

Organizata policore ka strukturën e vet organizative e cila përcakton çartë zinxhirin komandues nga lartë poshtë dhe në vijën horizontale. Udhëheqësit në polici i përmbahen principit hierarkik të komandimit dhe udhëheqjes. Organizata policore nxjerr urdhëresa, udhëzime, rregullore, direktiva dhe akte tjera nënligjore për udhëheqjen me policinë.

Në ambientin burokratik ekzistojnë standardet në formë të shkruar si drejtues të organizatës. Mirëpo njerëzit udhëheqës në polici nuk i përshtaten politikës dhe standardeve të përcaktuara. Në praktik ata mund të reagojnë në mënyra të ndryshme kur policët shmangën nga standardet e parashikuara. Ata mund të injorojnë, të veprojnë formalisht dhe jo formalisht ose ti mbrojnë policët.

Reagimi formal i udhëheqësve përfshinë: këshillimet profesionale ose edukimin, dhënia e këshillave apo udhëzimeve personit si ti përmirësojë sjelljet e veta ose shqiptimi i ndonjë mase disiplinore si qortim, suspendim, degradim, largim.

Sa më shumë që publiku kritikon veprimet e policisë kjo është e kuptueshme se udhëheqësit do të ndërmarrin ndonjë masë disiplinore.

Disa udhëheqës dëshirojnë që si shembull të një polici, të tregojnë se çka mund ti gjejë edhe të tjerët si shenjë se veprimet e caktuara nuk do të tolerohen. Mirëpo të punësuarit veprimet e tilla mund ti cilësojnë reagimet e udhëheqësve si veprime të motivuara politikisht dhe pa drejtësisht. Nëpunësit mendojnë se ata po viktimizohen për shkak të kënaqjes së interesave politike.

Nëse udhëheqësit konsiderojnë se ka shmangie nga standardet, mirëpo nuk ka dëshmi të mjaftueshme për to për të filluar veprime formale ata mund të përgjigjen në mënyrë jo formale, p.sh. caktimi i zyrtarit në një punë tjetër apo i caktimit të detyrave tjera të zyrtarit. (Parimet dhe Procedurat e Policisë së Kosovës)

Detyrat e caktuara shfrytëzohen për të përcaktuar detyrat në titull ‘detyrat me dënim’, p.sh. patrullimi nëpër burgje apo patrullimi në këmbë dimrit. Ndonjëherë p.sh. nëse problemi ka të bëjë me veprimet e policëve ndaj publikut policët mund të caktohen në ndonjë detyrë që jep mundësi minimale e kontaktit me publikun. Përpos kësaj mbikëqyrësit mund të presin që ky lloj i dënimeve joformale të kontrollit të sjellë deri te dhënia e dorëheqjes apo edhe pensionimit.

Si veprime joformale të udhëheqësve mund të jenë edhe trajnimet shtesë në nivel lokal apo qendror.

Udhëheqësit mund të shmangen nga veprimet dhe ta merr policin në mbrojtje për këto arsye: Udhëheqësi mund të lejojë veprimin ‘devijant’ të policit, të konsideroj se veprimet e organizatës janë tepër dënuese, ndëshkuese, të jetë në ndikimin e ashtuquajturit ligjit të heshtur në polici duke konsideruar se pranimi i veprimeve devijante do të sjellë deri te kritikën drejtuar në llogari të tij apo të saj, thjesht dëshiron t’i shmangët zgjidhjes së problemit që ekziston.

Është evidente se ekzistojnë shumë rregulla (me qindra) në formë të shkruar në bazë të cilave policia duhet të udhëhiqet. Ato vazhdimisht shtohen, ndryshohen varësisht nga rrethanat e krijuara. Sistemi i aplikimit të direktivave është bazë e fortë e kontrollit administrativ (Carter dhe Barker, 1994). Ato e mbrojnë dhe e udhëheqin organizatën nga përgjegjësia. Mirëpo shumë direktiva vjetërsohen apo nuk janë të qarta dhe nuk janë aplikuar asnjëherë. Është e rëndësishme që organizata në mënyrë periodike të i rifreskon direktivat që ti azhurnojë dhe mundësoj ato në veprim të mëtejshëm. (Plani Strategjik i Ministrisë së Punëve të Brendshme 2007-2010).

5.10 Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është organ i cili vepron si agjension i pavarur nga policia në kuadër të MPB-së, dhe i cili ka për qëllim që të kontrolloj punën e policisë së Kosovës. Për kryerjen e të gjitha këtyre punëve duhet një staf i përgatitur mirë profesionalisht, me një vizion të qartë dhe të vetëdijshëm për gjendjen që kemi trashëguar pas luftës së fundit në Kosovë. (Ligji i Inspektoratit Policor të Kosovës).

Policia e Kosovës si organizata më e re policore në rajon, pa ndonjë traditë të madhe, dhe me një përvojë vetëm disa vjeçare, me vështirësi do t'i përmbushë dhe realizojë të gjitha këto detyra. Policia e Kosovës edhe pse është e thirrur për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do të mundet të kryejë detyrat policore në mënyrë efikase ashtu sikurse çdo polici në botë, pa bërë edhe shkelje të po këtyre të drejtave.

Policinë duhet ta kontrollojë një mekanizëm i pavarur, i cili do të kujdeset që Policia e Kosovës të jetë në hap me të priturat nga popullata, të veprojë në përputhje me ligjet e

aplikuara në Kosovë, dhe të veprojnë në mënyrë efektive, gjithnjë duke respektuar edhe aktet dhe konventat më të rëndësishme ndërkombëtare të cilat parashohin mbrojtjen dhe respektimin e lirisë dhe të drejtave të njeriut si dhe duke respektuar KEEP-në, i cili është dokument bazë për punën e policisë. (Ligji i Policisë së Kosovës).

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të OKB-së, në Kosovë e formon Inspektoratin Policor për të bërë kontrollime dhe inspektime të PK-së, si dhe hetimin e pohimeve për shkelje të rënda disiplinore nga policët ose personeli civil i PK-së. Inspektorati policor i Kosovës është krijuar si agjension i pavarur që të mbikëqyr dhe vëzhgojë, punën e policisë në vendin tonë, i cili model është marrë nga Britania e Madhe.

Inspektorati punën e vetë e bazon vetëm në fakte dhe prova të mbledhura në bazë të autorizimeve, me qëllim që të mos ndodhë, që ndonjë pjesëtar i policisë së Kosovës të pësojë si rezultat i hakmarrjeve, inateve apo duke u bazuar në ndonjë lloj diskriminimi, si pasojë e të cilit do të trajtohet ndryshe nga të tjerët.

Pjesëtarët e inspektoratit policor të Kosovës duhet të janë profesionist, të përgatitur dhe të trajnuar që autorizimet e inspektorit policor t'i përmbushin me profesionalizëm dhe në bazë të ligjit.

Krijimi i inspektoratit policor për qytetarët është një alternativë më e mirë dhe më e sigurt, sepse mbikëqyrja e policisë bëhet nga një institucion i pavarur dhe i ndarë nga policia e Kosovës. Inspektorati Policor i Kosovës është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/54. Ky institucion është formuar nga PSSP-ja, për të bërë kontrollime dhe inspektime të PK-së, dhe për të raportuar përmbushjen dhe efektivitetin e këtij shërbimi në arritjen e objektivave dhe synimeve të përcaktuara, si dhe për të hetuar pohimet për kryerjen e shkeljeve të rënda disiplinore nga policët ose personeli civil i PK-

së. Implementimi i kësaj Rregullore është bërë në mënyrë të detajuar nga urdhëresa administrative Nr. 2006/9.

Me aprovimin e Ligjit i nr.03/L-035 për Policinë, PK-ja themelohet si Polici e Kosovës dhe nuk është më tutje nën kompetencat e Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut. Kjo në fakt ka qenë edhe qëllimi i këtij ligji.

Qëllimi i këtij Ligji është themelimi i Policisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm policisë), përshkrimi i autorizimeve dhe i detyrave të saj, si dhe autorizimeve dhe i detyrave të zyrtarëve policorë, përcaktimi i strukturës organizative dhe rregullimi i çështjeve të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së . (Ligji për Policinë, 2008:1).

Detyrat e policisë të përcaktuara me Ligjin i nr.03/L-035 për policinë dhe Rregullorja nr. 2005/54 mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës në parim nuk ndryshojnë. Për më tepër edhe me ligjin aktual për policinë Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të policisë të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji janë thuajse plotësisht të njëjta me ligjin e kaluar:

- mbrojtje jetën, pronën dhe të ofrojë siguri për të gjithë personat;
- mbrojtje të drejtat dhe liritë themelore të gjithë personave;
- parandalojë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike;
- parandalojë dhe t'i zbulojë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- hetojë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- mbikëqyrë dhe kontrollojë sigurinë në komunikacion;
- menaxhojë dhe kontrollojë kufirin shtetëror;
- ofrojë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe

- kryejë detyra të tjera të parapara me ligjin në fuqi.

Me rëndësi për qëllimet e këtij studimi janë parimet udhëzuese të parapara në neni 2 të këtij ligji në të cilat PK-ja bazohet në ushtrimin e autorizimeve të veta ligjore. Sipas ligjit, veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:

- trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë personave;
- respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;
- paanshmëria dhe neutraliteti lidhur me bindjet dhe pikëpamjet politike të personave;
- integriteti, ndershmëria dhe përgjegjësia në shërbimin publik;
- transparenca - ofrimi i informatave për qytetarët dhe të qenit të hapur ndaj publikut;
- legjitimiteti, përshtatshmëria dhe proporcionaliteti;
- përkushtimi ndaj punësimit, avancimit dhe caktimit të detyrave në mënyrë gjithëpërfshirëse, meritore dhe pa diskriminim, duke reflektuar karakterin shumetnik në Republikën e Kosovës dhe duke i njohur parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të parapara në Kushtetutë.

5.10.1 Ligji nr. 03/l-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës

Ligji për IPK-në rregullon kompetencat dhe përgjegjësitë për IPK-në hetimin e veprave penale të kryera nga pjesëtarët e PK-së dhe hetimin e incidenteve disiplinore të profilit të lartë, si dhe obligimet për PK-në në rast se zyrtarët e saj përfshihen në vepra penale.

Sipas neni 4 përkufizimet, të këtij ligji; Hetues përkufizohet personeli i Inspektoratit Policor të Kosovës që zhvillon hetime penale ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës,

përfshirë edhe hetimet mbi incidentet e profilit të lartë disiplinor si dhe hetimin disiplinor të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv. Kurse incident disiplinor i profilit të lartë përkufizohet incidenti ose trendi i ngjarjeve që tërheqin vëmendje domethënëse të publikut duke përfshirë, por pa u kufizuar në supozimet si: konflikte apo incidente të drejtpërdrejta në mes policisë dhe komuniteteve që ndërlidhet me veprimet racore, etnike apo diskriminuese. Konflikti mund të jetë në formën e ngacmimit, brutalitetit apo përdorimit të forcës së tepruar nga ana e Policisë; të gjitha incidentet e përdorimit të forcës vdekjeprurëse; të gjitha vdekjet gjatë mbajtjes nën kontroll nga policia; aksidentet fatale të trafikut ku përfshihen punonjësit e policisë.

Ligji për IPK-në përcakton kompetencat hetimore gjatë hetimeve penale. Neni 17 Hetimet penale, pika 2 përcakton se objekt i veprimtarisë hetimore të IPK-së është parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit së detyrës ose jashtë saj, përfshirë edhe hetimet mbi incidentet e profilit të lartë disiplinor si dhe hetimin disiplinor të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv. Në rastet komplekse të hetimeve penale kundër pjesëtarëve të PK-së mund të aplikohen edhe masat e fshehta hetimore në pajtim me dispozitat e KPPK-së.

Policia sapo të njoftohet apo të marrë informatë se punonjësi i Policisë është përfshirë në kryerjen e një vepre penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, menjëherë ndërmerr të gjitha masat për sigurimin e provave dhe ndërmerr të gjitha veprimet paraprake duke përfshirë por pa u kufizuar në daljen në vendin e ngjarjes, sigurimin e vendit të ngjarjes,

arrestimin e të dyshuarit nëse përmbushen kushtet ligjore, përkujdesjen për arritjen e ndihmës mjekësore si dhe identifikimin dhe ndalimin e dëshmitarëve.

Lidhur me rastin Policia duhet ta njoftoj prokurorin pa vonesë dhe brenda kohës së paraparë në Kodin e Procedurës Penale dhe menjëherë duhet ta njofton edhe IPK-në. Ligji nr. 03/I-178 për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë.

Siguria e informacionit ka rëndësi jo vetëm për organizatat policore por edhe për institucionet e tjera të shtetit të cilat posedojnë informata të cilat duhet të klasifikohen sipas ligjit.

Të gjitha institucionet publike garantojnë sigurinë fizike dhe sigurinë e informacioneve lidhur me informacionet e klasifikuara në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara përmes akteve nënligjore, i cili është në përputhje me standardet relevante të përcaktuara nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe rregulloret mbi sigurinë të Bashkimit Evropian. (Ligji për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë, 2010: 12).

Sipas ligjit, neni 24 Autoriteti Verifikues; Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është autoriteti verifikues që ka përgjegjësi për të zhvilluar procedura të verifikimit të sigurisë, siç është përcaktuar me këtë ligj, për të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës dhe kontraktuesve të tyre. “Agjencive të fshehta të sigurisë dhe informacionit shpeshherë u besohen kompetenca të jashtëzakonshme, siç është miratimi i sigurisë, që, në qoftë se përdoren në mënyrë jo korrekte ose të gabuar, bartin rrezikun e padrejtësive të rënda ndaj individëve” (Born, Leigh, 2005: 111).

Pasi që pjesëtarët e PK-së janë në vazhdimësi në posedim dhe përdorim të informacioneve të ndjeshme dhe ligjërisht janë të obliguar që ato ti trajtojnë në mënyrë konfidenciale dhe

t'i mbrojnë nga keqpërdorimi është me interes edhe njohja me sanksionet penale të parapara me Ligjin për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë. Kjo ka rëndësi të madhe për pjesëtarët e PK-se me vetë faktin pjesëtarët e policisë janë apo vijnë në dijeni të informacioneve të klasifikuara dhe shpërdorimi eventual i tyre do të kishte pasoja për individ apo institucione por edhe për vetë PK-në. Për këtë arsye janë paraparë edhe sanksionet shkalla e të cilave është përcaktuar nga niveli i klasifikimit të informacionit.

(Ligji nr. 03/l-178, 2010: 27).

5.10.2 Analizë e rasteve të hetuara nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)

IPK-ja është krijuar në vitin 2006 dhe fillimisht kishte kompetenca për hetime të shkeljeve të rënda disiplinore, ndërsa DSP-ja është marrë me hetimin e shkeljeve të lehta disiplinore. Me ndryshimet e Ligjit për IPK-në kanë ndryshuar edhe kompetencat e këtij agjensioni. Me këtë ligj tani IPK-ja është kompetente për hetime penale ndaj pjesëtarëve të PK-së, kur dyshohet se janë të përfshirë në vepra penale dhe një pjesë e hetimeve disiplinore për pozitat ekzekutive dhe punonjësit me gradën më të lartë në PK.

Kështu që ankesat e qytetarëve të pranuar nga IPK-ja e të cilat nuk bien në kategorinë e përmendur më lart i referohen DSP-së për hetime disiplinore.

Për periudhën janar-dhjetor 2011, IPK-ja ka pranuar gjithsej 649 ankesa të qytetarëve ndaj zyrtarëve policorë në lidhje me shkelje disiplinore. Pas analizimit dhe klasifikimit të ankesave, IPK-ja të njëjtat i ka proceduar për hetim disiplinor pranë Drejtorisë për Hetime të Brendshme të Policisë së Kosovës. (IPK, 2011: 13).

Sipas ligjit të IPK-së autorizimet ligjore të IPK-së për hetime penale kanë hyrë në fuqi nga qershori i vitit 2011. “Nga muaji qershor deri në muajin dhjetor të 2011-s, IPK-ja ka regjistruar gjithsej 143 lëndë të karakterit penal, në lidhje me vepra të ndryshme penale, të cilat supozohet se janë kryer nga zyrtarët policorë, gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare apo edhe jashtë saj. (IPK, 2011: 130).

Sipas të dhënave statistikore të IPK-së të paraqitura në Raportin Vjetor 2011 një numër i lëndëve të karakterit penal janë dërguar në prokurorinë kompetente, por jo të gjitha kanë përfunduar me kallëzime penale. (Sipas raportit, për periudhën kohore qershor-dhjetor 2011).

IPK-ja ka ngritur gjithsej 46 kallëzime penale në prokuroritë kompetente, ndërsa 18 lëndë janë dërguar në Prokurori me ‘raport të veçantë’, pasi që nuk ka pasur dyshim të bazuar për ngritjen e kallëzimit penal, pesë (5) raste janë dërguar në Gjykata për Kundërvajtje, tetë (8) raste janë mbyllur në IPK pas hetimit preliminar, tetë (8) raste janë mbyllur pa u hapur hetimet penale në konsultim me prokurorët kompetentë. Numri i pjesëtarëve të PK-së nën hetime dhe struktura etnike dhe gjinore e të dyshuarve sipas Raportit Vjetor 2011 të IPK-së është: si të dyshuar për vepër penale janë duke u hetuar 157 pjesëtarë të PK-së të gjinisë mashkullore si dhe tetë (8) të gjinisë femërore.

Kurse sa i përket përkatësisë së tyre etnike, del se 147 janë me përkatësi shqiptarë, 16 serbë, 1 boshnjak dhe 1 turk. (Raporti vjetor 2011, Inspektorati Policor i Kosovës)

Tre (3) zyrtarë policorë janë të arrestuar nën dyshimin se kanë kryer veprën penal “Kidnapim”, 3 (tre) zyrtarë policorë janë të arrestuar për veprën penale “Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit” dhe për veprën penale “Marrja e ryshfetit”, 2 (dy) janë të arrestuar për veprën penale “Përdorimi paautorizuar i armëve” dhe “Shkaktim i rrezikut të

përgjithshëm”, 2 (dy) për veprën penale “Rrezikim i trafikut publik - Aksident komunikacioni me fatalitet”, 1 (një) zyrtar policor është arrestuar për veprën penale të “Vrasje”, 1 (një) është arrestuar për “Shpërdorimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”, 1 (një) është arrestuar në lidhje me veprën penale “Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”, 1 (një) zyrtar policor është arrestuar për veprën penale “Dhuna në familje”, si dhe 1 (një) zyrtar policor është arrestuar në dyshimin se ka kryer veprën penale “Lëndim i lehtë trupor” dhe “Ndërprerje e palejuar e shtatzënisë”. (IPK, 2011: 18).

Të dhënat statistikore të vitit 2012 tregojnë për një trend të njëjtë të raportimit të rasteve të shkeljeve penale dhe disiplinore të pjesëtarëve të PK-së.

Sipas Raportit Vjetor 2012, për periudhën janar-dhjetor 2012, IPK-ja ka pranuar gjithsej 1078 ankesa ndaj zyrtarëve policorë në lidhje me shkelje disiplinore dhe penale. Pas analizimit dhe klasifikimit të ankesave, IPK-ja ka proceduar për hetim disiplinor pranë Drejtorisë për Hetime të Brendshme të Policisë së Kosovës 776 raste. Këto raste nuk kanë pasur elemente të veprës penale apo nuk janë kualifikuar si shkelje disiplinore të profilit të lartë siç është e paraparë me Ligjin për IPK-në. Ndërsa, 302 raste të cilat janë kualifikuar si kompetencë e IPK-së për hetim nga të cilat 292 raste kanë qenë raste me elemente të veprës penale ndërsa 10 nga to kanë qenë raste disiplinore të profilit të lartë.

Për dallim nga viti 2011 ku kishim më së shumti raste të raportuara të rrezikimit të trafikut gjatë vitit 2012 kemi më tepër raste që kanë të bëjnë brutalitet dhe tejkalim të autorizimeve për përdorim të forcës, edhe pse nuk kemi të dhëna nëse rastet e lëndëve lëndim i lehtë trupor janë të gjitha të raportuar si vepra gjatë kryerje së detyrë zyrtare apo jo. IPK-ja është e autorizuar t’i hetojë edhe veprat penale të kryera nga pjesëtarët e PK-së jashtë detyrës zyrtare. Sipas raportit vjetor 2012, rastet më të shpeshta me elemente të

veprës penale të hetuara nga IPK-ja gjatë vitit 2012 kanë qenë rastet; lëndimi i lehtë trupor, 52 raste, keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës 45 raste, shpërdorim i detyrës zyrtare apo autorizimit 42 raste, rrezikim i trafikut publik 40 raste etj. Ndërsa gjithsej “si subjekt i hetimeve në Inspektoratin Policor të Kosovës kanë qenë 361 punonjës të Policisë së Kosovës pa dallim grade apo pozite.” (IPK, 2012: 18).

Gjatë vitit 2012 subjekt i hetimeve në IPK kanë qenë 361 punonjës të Policisë së Kosovës prej tyre 67 zyrtarë të graduar apo 22%, prej tyre; 3 kolonel apo 1%, 1 nënkolonel apo 0%, 4 major apo 1 %, 7 kapiten apo 2%, 16 toger apo 5%, 36 rreshter apo 10%, 283 zyrtar policor apo 78% si dhe 11 punonjësve nga stafi civil që përbënte 3% nga totali i punonjësve të PK-së si subjekt i hetimeve nga (IPK, 2012: 19).

Është shumë i rëndësishëm krijimi i një sistemi funksional të administrimit të disiplinës organizative. Kjo është për më tepër e rëndësishme dhe e domosdoshme për organizatat policore dhe për ato të zbatimit të ligjit në përgjithësi. Administrimi i disiplinës ndikon në krijimin e një imazhi të mirë në publik për organizatën policore dhe në të njëjtën kohë siguron shërbime efikase dhe profesionale, respektim e drejtave të qytetarëve. Ajo që është gjithashtu shumë e rëndësishme është se një sistem i menaxhuar mirë i disiplinës në polici do të ndikojë fuqishëm në parandalim të sjelljeve të pahijshme, shpërdorimit të detyrës, korrupsionit dhe kryerjes së veprave penale nga pjesëtarët e policisë. Përpjekjet e menaxherëve duhet të orientohen në mbikëqyrjen e vazhdueshme të ndryshimit të sjelljes dhe qëndrimeve të personelit në raport me detyrat dhe përgjegjësit e tyre. Identifikimi i hershëm i indikacioneve të sjelljeve devijante të personelit dhe faktorëve që ndikojnë në këto sjellje është e rëndësishme në identifikimin e zyrtarëve të cilët mund të kenë nevojë për një mbikëqyrje më intensive, këshilla, përkrahje apo udhëzime me qëllim të reagimit

më të hershëm në parandalim të shkeljeve ligjore. Autorët, Thibault, Lynch, McBride, pastaj Swanson, Territo, Taylor, diskutuan nevojën për krijimin e një sistemi të paralajmërimit të hershëm për identifikimin e zyrtarëve problematikë:

Është i mundshëm menaxhimi i rrezikut të zyrtarëve policorë që përfshihen në korrupsion apo sjellje brutale duke zhvilluar një sistem të paralajmërimit të hershëm për të identifikuar zyrtarët të cilët janë në rrezik. Ky sistem i paralajmërimit të hershëm më së miri funksionon në departamentet që janë të përkushtuar në zbulimin dhe punën me zyrtarët problematik. I ndalon problemet e fshehura të rriten dhe bëhen skandale të mëdha policore, dhe ë bënë të vështirë që departamentet ti injorojnë dhe ti mbulojnë sjelljet e zyrtarëve problematik. (Thibault, Lynch, McBride, 2007: 267).

Sistemi i paralajmërimit të hershëm është një mjet menaxhimi i bazës së të dhënave të policisë i projektuar për të identifikuar zyrtarët me sjellje problematike dhe për të intervenuar për përmirësimin e performancës e tyre. Si përgjigje e hershme, departamenti reagon para se një zyrtar i tillë të vij në atë situatë ku rrezikon veprime formale disiplinore. Sistemi lajmëron departamentin për këta individë dhe i paralajmëron zyrtarët që gjatë këshillimit apo trajnimit t'i ndihmojnë ata të përmirësojnë sjelljet e tyre problematike. (Swanson, Territo, Taylor, 2005: 416).

Sistemi i mirëfilltë i administrimit të disiplinës fillon me gatishmërinë dhe vullnetin e policisë për pranimin dhe shqyrtimin e të gjitha ankesave të publikut ndaj pjesëtarëve të saj, pavarësisht nga mënyra e shprehjes së ankesës.

Edhe në rastet kur organizatat policore ballafaqohen me ankesa edhe nga qytetarë të cilët ankohen në veprimet e policisë në rastet e shqiptimit të gjobave në trafik, sekuestrimit të pasurisë, ndalimit, arrestimit, përdorimit të forcës etj., ankesat duhet të pranohen si e

drejtë legjitime dhe kushtetuese e qytetarëve dhe duhet të shqyrtohen me profesionalizëm duke respektuar parimin e ligjshmërisë dhe të etikës. Kështu reagimi i shpejtë dhe i drejtë në ankesat e qytetarëve dhe marrja e masave adekuate disiplinore është në funksion të respektimi të të drejtave dhe lirive të njeriut por njëkohësisht edhe ruajtjes dhe forcimit të imazhit të policisë. Në këtë proces së bashku me imazhin e policisë nuk duhet harruar edhe të drejtat legjitime të punonjësit të policisë për tu mbrojtur nga akuzat e pabaza.

“Qëllimet parësore në administrimin e veprimeve të hetimit efektiv të ankesave ndaj personelit janë për të mbrojtur integritetin dhe reputacionin e forcës policore, të mbrojnë interesin publik dhe për të mbrojtur punonjësin e akuzuar nga akuzimi i padrejtë”. (Iannone, Iannone, 2001: 215).

Zyrtarët policorë që mund të jenë subjekt të hetimit disiplinor gëzojnë të drejtat e tyre dhe duhet të trajtohet mbi parimin e ligjshmërisë dhe me dinjitet. Provat dhe pretendimet duhet të administrohen mirë dhe kjo kërkon angazhim dhe përkushtim të zyrtarit mbikëqyrës apo hetues në mënyrë që procesi hetimor të mos ndikojë në motivimin për punë të zyrtarëve që janë subjekt i hetimeve si në rastin kur hetimet përfundojnë me masë disiplinore apo kur përfundojnë si të pagjetura.

“Mbikëqyrësi që heton ankesën kundër vartësit të tij duhet të ndjekë çdo kanal të hetimit në dispozicionin e tij në kërkimin e së vërtetës. Ai duhet të mbetet objektiv në qasjen e tij dhe të shmanget nga nxjerrja e përfundimeve të pafajësisë apo fajësisë para se të njihen faktet”. (Iannone, Iannone, 2001: 247).

Nuk ka asnjë dyshim se në organizatat policore ku rendi, disiplina dhe vlerat etike janë në nivelin e duhur, gjasat që personeli në këto organizata të përfshihet në vepra penale dhe korrupsion janë më të vogla. Në të kundërtën mungesa e standardeve të sjelljes etike, shkeljet e shpeshta të përsëritura të disiplinës, ankesat e shumta të qytetarëve, tejkalimi i

autorizimeve, veprimet e njëanshme apo mosveprimi sipas detyrës dhe menaxhimi joefikas i disiplinës në organizatë ka gjasë të rezultojë me shkelje më të rënda të ligjit si vepra penale, korrupsioni, keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe vepra tjera të sanksionuara. Në vende të ndryshme janë ndërtuar modele dhe praktika të ndryshme për mbikëqyrjen e organizatave policore varësisht nga rregullimi shtetëror, legjislacioni, por edhe nga nevoja për kontroll dhe mbikëqyrje për shkak të nivelit të korrupsionit, sfidave të ndryshme apo kërkesave të tjera të kohës.

Sido që të jetë, organizatat policore në vendet demokratike i kushtojnë rëndësi administrimit të disiplinës, ndërtimit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe i nënshtrohen mekanizmave të kontrollit të jashtëm dhe mbikëqyrjes nga institucionet legjitime. Në këtë drejtim edhe në Kosovë është shënuar një progres në krijimin e procedurave administrative dhe ligjore për disiplinën, kontrollin dhe mbikëqyrjen e PK-së.

5.11 Roli i institucioneve të mbikëqyrjes dhe kontrollit

Mbikëqyrja dhe kontrolli demokratik i organizatave policore është parim bazë për sundimin e ligjit dhe të shtetit ligjor. Roli i institucioneve të mbikëqyrjes së policisë qëndron në kërkesat për zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore, ruajtjes dhe forcimit të vlerave etike, ngritjes së profesionalizmit, ngritjes së efikasitetit, menaxhim e burimeve njerëzore, regrutimin, seleksionimin, trajnimin, performancën, vlerësimin, kompensimin, barazinë dhe diversitetin, menaxhimin e pronës dhe financave, procedurat e prokurimit, marrëdhëniet me publikun, administrimin e ankesave të qytetarëve, administrimin e

disiplinës, hetimet penale, mbrojtjen e të dhënave dhe realizimin e objektivave të përgjithshme dhe specifike të parapara me dokumentet strategjike të policisë dhe të qeverisë. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i mbikëqyrjes dhe kontrollit të policisë është shqyrtimi apo vlerësimi i pëlqyshmërisë së akteve nënligjore me ligjet e aplikueshme.

Policia gjithmonë duhet të veprojë brenda rregullave ligjore. Ata i nënshtrohen të njëjtit ligj të cilin duhet ta zbatojnë dhe ta ruajnë. Përveç kësaj, roli i policisë është dhe duhet të jetë i veçantë nga roli i institucioneve tjera në sistemin e drejtësisë penale, siç është sistemi i zyrës së prokurorit, gjyqësorit, apo sistemi korrektues.

Nga perspektiva e qeverisjes së mirë, të gjitha shtetet duhet të ofrojnë siguri publike duke respektuar liritë individuale dhe të drejtat e njeriut. Qytetarët në demokraci kanë të drejtë të gëzojnë trajtim të drejtë, të paanshëm dhe të pritshëm nga policia.

Sjellja e forcave policore ndaj publikut mund të shihet si një nga treguesit kryesor të demokracisë në një vend. (IPU&DCAF, 2003: 61).

Policia gjithmonë duhet të veprojë brenda rregullave ligjore. Ata i nënshtrohen të njëjtit ligj të cilin duhet ta zbatojnë dhe ta ruajnë. Përveç kësaj, roli i policisë është dhe duhet të jetë i veçantë nga roli i institucioneve tjera në sistemin e drejtësisë penale, siç është sistemi i zyrës së prokurorit, gjyqësorit, apo sistemi korrektues. Nga perspektiva e qeverisjes së mirë, të gjitha shtetet duhet të ofrojnë siguri publike duke respektuar liritë individuale dhe të drejtat e njeriut. Qytetarët në demokraci kanë të drejtë të gëzojnë trajtim të drejtë, të paanshëm dhe të pritshëm nga policia. Sjellja e forcave policore ndaj publikut mund të shihet si një nga treguesit kryesor të cilësisë së demokracisë në një vend. (IPU&DCAF, 2003: 61).

Organizatave policore duhet të synojnë që përmes trajnimeve, këshillimeve dhe vlerësimeve të punës dhe sjelljes të arrijnë që personeli i tyre të plotësojë dhe respektojë kriteret dhe standardet etike dhe profesionale. Në parim “punonjësit, duhet të pritet të kontrollojnë veten, si në ndërveprime me njëri tjetrin po ashtu edhe me publikun, në një mënyrë që tregon respekt, sinqeritet, integritet dhe përkushtim ndaj shërbimit publik.” (Swanson, Territo, Taylor, 2005: 412).

Në këtë aspekt mund të vlerësohet roli dhe rëndësia e institucioneve të mbikëqyrjes dhe kontrollit të policisë. Ekzistojnë dy lloje të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi policinë. Kontrolli i brendshëm dhe kontrolli i jashtëm. Ndonëse qëllimi edhe i kontrollit të jashtëm edhe i kontrollit të brendshëm është i njëjtë, dallimi kryesor qëndron në mënyrën dhe shkallën e ndërhyrjes në punën e pavarur të policisë. Përderisa mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë të strukturuar brenda organizatës dhe janë pjesë integrale e saj kanë edhe kompetenca dhe autorizime për të vepruar në ushtrimin e mandatit të tyre.

Sa i përket mekanizmave të kontrollit të jashtëm dilema shtrohet në mundësinë e ndikimit politik, sepse bëhet fjalë për institucione të cilat janë plotësisht të pavarura nga policia.

Prandaj, vjen në shprehje edhe kërkimi i llogaridhënies nga institucionet të cilat mund të kenë ngjyrimë politike.

“ka disa pyetje rreth mënyrës faktike përmes së cilës shfaqet kjo llogaridhënie dhe shkallën në të cilën është. Është sugjeruar se shkalla e kontrollit mbi policinë nga autoriteti politik ndryshon me nivelin e udhëheqjes në të cilin ndodhin funksionet policore”. (Swanson, Territo, Taylor, 2005: 90).

Policia e Kosovës ka ndërtuar një sistem të kompletuar të kontrollit të brendshëm të inspektimit, auditimit, disiplinës, të drejtat e personelit, shqyrtimit të përdorimit të forcës

etj. Kurse sa i përket kontrollit të jashtëm, kjo çështje është rregulluar me ligj. Duke filluar nga Ligji për Policinë i cili përcakton se:

Policia funksionon nën autoritetin e ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e drejtorit të përgjithshëm të policisë.

Autoriteti i ministrit nuk përfshinë menaxhimin operacional të policisë. Drejtori i përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit për administrimin dhe menaxhimin e policisë. Drejtori i përgjithshëm bashkëpunon me ministrin dhe i ofron informata dhe raporte atij sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. (Ligji për Policinë, 2012: 4).

Kultura politike përcakton edhe nivelin dhe formën e kontrollit të autoritetit politik mbi policinë. Ekzistojnë edhe praktika të mira të ushtrimit të kontrollit mbi policinë të cilat janë të parapara me dispozita ligjore. Për shembull në PK, “ nëse Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendësrejtoreve të Përgjithshëm të Policisë iu përfundon mandati në vitin kalendarik të zgjedhjeve të përgjithshme, atëherë qëndrimi i tyre në detyrë do të zgjatet në mënyrë automatike për një vit pas certifikimit të zgjedhjeve.” (Ligji për Policinë, 2012: 20).

5.11.1 Mekanizmat e kontrollit të brendshëm të Policisë së Kosovës

Kontrolli i brendshëm i policisë është një nga funksionet më të rëndësishme të udhëheqjes së organizatës. Qëllimi i mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm është që kryerja e detyra dhe përgjegjësi dhe përmbushja e misionit të policisë të jetë e bazuar në standardet më të larta të policimit demokratik. Respektimi i parimeve, procedurave dhe normave ligjore

në të gjitha aktivitetet që zhvillon policia, duke filluar nga trajtimi i barabartë i qytetarëve gjatë procesit të regrutimit, respektimin e të drejtave të punonjësve, pastaj ushtrimin e autorizimeve policore në pajtim me ligjet e aplikuara dhe konventat ndërkombëtare. Përveç kësaj, roli dhe rëndësia e mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm qëndron në parandalimin e shpërdorimit të ligjit, shkeljeve të procedurave të operimit, vendimet arbitrare dhe njëkohësisht siguron hetim të paanshëm dhe ndërmarrjen e masave për hetimin dhe sanksionimin e çfarëdo shkeljeje nga ana e të punësuarve. Kontrolli i brendshëm i policisë kërkon angazhim dhe njohuri të personelit mbikëqyrës për të ndërtuar kapacitetet dhe mekanizmat efikas për ushtrim të kontrollit të brendshëm. Kjo nënkupton planifikim afatgjatë të burimeve njerëzore, të buxhetit të ndryshimeve dhe plotësimit të ligjit dhe rregulloreve.

Secili pjesëtar i agjencisë duhet të luaj rol për të siguruar që kontrolli i brendshëm funksionon në mënyrë të rregullt, sido që të jetë menaxherët janë ata të cilët e kanë përgjegjësinë primare për të implementuar kontrollet e brendshme dhe për të monitoruar efikasitetin e tyre. (Crime and Misconduct Commission, 2005: 25).

Në strukturën organizative të PK-së janë të strukturuar njësitë të cilat në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë që kanë luajnë rolin kyç në kontrollin e brendshëm, duke filluar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, Komisioni Disiplinor, Komisioni për ankesa dhe Shpërblime, Komisioni për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës, Drejtoria e Personelit, Njësia e Inspektimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe njësitë e tjera, të cilat pa përjashtim kanë rol dhe përgjegjësi në mbikëqyrjen kontrollin dhe implementimin e praktikave dhe standardeve më të mira të policimit demokratik. Për më tepër, jo vetëm personeli mbikëqyrës, por të gjithë të punësuarit duhet të jenë aktivë, të dedikuar dhe të

përkushtuar për kryerjen e detyrave në mënyrë sa më profesionale në mënyrë që koncepti i mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm të policisë të jetë sa më efektiv dhe të jetë në funksion të ndërtimit të një organizate policore me integritet të lartë, e aftë për të përmbushur objektivat në luftimin e krimit, të gëzojë një respekt dhe besim nga publiku si dhe PK-në ta bëjë një organizatë moderne dhe me standardet etike dhe profesionale.

Policia e Kosovës, edhe pse një organizatë relativisht e re ka arritur që të krijoj procedurat e punës në administrimin e procedurës dhe masave disiplinore, raportimit të shkeljeve administrative dhe penale dhe krijimit të kapaciteteve të brendshme të cilat janë në pajtim me nevojën dhe kërkesat për mbikëqyrje dhe kontroll të jashtëm.

Për më tepër edhe në kuptim të ndryshimeve dhe plotësimeve ligjore në Kosovë kemi një sistem që dallon nga shumë shtete sa i përket kontrollit të jashtëm me vetë faktin se hetimet penale kundër pjesëtarëve të PK-së zhvillohen nga një agjenci krejtësisht i pavarur nga policia por që ka kompetenca ligjore për zhvillimin e hetimeve penale në mënyrë të pavarur sipas kodit të procedurës penale dhe nën mbikëqyrjen e prokurorit publik. Kjo paraqet një praktikë të re dhe mbetet të shihet në të ardhmen nëse kjo mund të jetë një model edhe për vendet e tjera.

5.11.2 Roli i Inspektoratit Policor të Kosovës në kontrollin e jashtëm të PK-së

Një nga mekanizmat më të rëndësishëm për mbikëqyrje dhe kontroll të jashtëm të policisë është IPK-ja. Themelimi i kësaj agjencie është autorizuar nga PPSP-ja me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/54 Mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës dhe fillimisht është e emëruar Inspektorati i Policisë. Inspektorati i policisë u

themelua për të bërë kontrollime dhe inspektime në Shërbimin Policor të Kosovës dhe për të raportuar për përmbushjen dhe efektshmërinë e këtij shërbimi në arritjen e objektivave dhe duke hetuar pohimet për kryerjen e shkeljeve të rënda disiplinore nga policët ose personeli civil i Shërbimit Policor të Kosovës, dhe nëse ka rekomandime për ndonjë ndëshkim të cilin duhet shqiptuar ia paraqet ato KELDP-së.(Këshilli për Emërime të Larta në Drejtorinë e Përgjithshme).

Inspektorati i policisë është i pavarur prej Shërbimit Policor të Kosovës dhe personeli dhe mjetet materiale të tij nuk duhet të konsiderohen si personel dhe mjete materiale të Shërbimit Policor të Kosovës; ai duhet të punojë në mënyrë profesionale dhe të paanshme, duke i respektuar plotësisht standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, pa ndikime politike dhe në interesin e të gjitha bashkësive në Kosovë.

Inspektorati i policisë themelohet si një agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, por me përbërje dhe detyra të punës që i pasqyrojnë parimet e përcaktuara më lart. (UNMIK, 2005: 11-12).

Roli dhe kompetencat e IPK-së u ndryshuan dhe u zgjeruan me aprovimin e ligjit për IPK-në. “Misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës është që përmes ushtrimit të veprimitarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara”. (Ligji për IPK, 2011: 2). Kurse në nenin 2 të ligjit të IPK-së përcaktohet fushëveprimi i IPK-së. Sipas këtij ligji fushëveprimi i IPK-së është:

- inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi;

- hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës, siç është përcaktuar në nenin 4, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.11 të këtij ligji;
- hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv;
- kur ekziston dyshimi i bazuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka kryer shkelje disiplinore, Kryeministri mund të autorizojë IPK-në për zhvillim të hetimeve disiplinore. IPK-ja pas përfundimit të hetimeve disiplinore i raporton Kryeministrit për të gjeturat;
- pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga IPK dhe cilat do t'i referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve përgjegjëse.

5.11.3 Autorizimet e Inspektoratit Policor të Kosovës

Inspektorati Policor i Republikës së Kosovës, si agjension ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i pavarur nga policia e republikës së Kosovës, ka këto autorizime:

- të zhvilloj inspektime ndaj policisë së republikës së Kosovës dhe të raportojnë mbi punën dhe efikasitetin në arritjen e qëllimeve;
- të hetojë akuzat për shkelje të rënda disiplinore ndaj të gjithë punonjësve të policisë pa dallim grade dhe të gjitha shkeljet e tjera ndaj pozitave të larta;

- ekzekutive, dhe t'i rekomandojë komisionit për emërimë të larta dhe disiplinë në polici se çfarë mase disiplinore, nëse është e nevojshme duhet të shqiptohet.

5.11.4 Llojet e inspektimeve në Inspektoratin Policor të Kosovës

Institucioni i inspektoratit, për të realizuar qëllimin për të cilin është themeluar natyrisht se duhet të ndërmerr disa veprime, me të cilat ai kryen punën dhe realizon misionin e vetë. Metodrat kryesore në të cilën mbështetet inspektorati policor të Kosovës, janë mbledhja e informatave për pjesëtarët e policisë së Kosovës përmes formave të ndryshme, të cilat kuptohet janë në përputhje me ligjet e aplikuara në Kosovë, e posaçërisht përmes inspektimeve të cilat i kryen, duke intervistuar policët, eprorët dhe duke bërë inspektime të dokumentacioneve të Policisë së Kosovës. (Parimet dhe Procedurat e Policisë së Kosovës).

Inspektimet janë të ndara në dy lloje:

Inspektimet e zakonshme (të rregullta) dhe inspektimet e jashtëzakonshme. Inspektimet duhet të autorizohen nga Krye shefi Ekzekutiv i IPK-së, duke u dhënë në formë të shkruar për kryerjen e inspektimeve të zakonshme jepen në fillim të vitit dhe i mbaron afati në fund të vitit përkatës. Ndërsa inspektimit e jashtëzakonshëm autorizohen për shtatëdhjetë e dy (72) orë, me mundësi vazhdimi nëse ekzistojnë arsye të bazuara për kryerjen e detyrave. (Ligji i Inspektoratit Policor të Kosovës).

Fushat e inspektimit në Inspektoratin Policor të Kosovës:

Ekzistojnë gjithsej katërmëdhjetë fusha në të cilat inspektorati policor, bënë inspektime të zakonshme, dhe për secilën fushë duhet të kryhet nga një inspektim.

Për të cilin duhet të përpilohet një raport mbi gjendjen në atë fushë, në fund të çdo viti kalendarik dhe duhet t'i paraqitet ministrit të Punëve të Brendshme, një raport vjetor i përmbledhur për të gjitha fushat.

Bëhen edhe inspektime të jashtëzakonshme varësisht prej nevojave që paraqiten gjatë punës së policisë së Kosovës.

Fushat të cilat inspektohen, në inspektime të zakonshme nga inspektorët policor janë:

- menaxhimi i objekteve policore;
- menaxhimi i buxhetit, financave dhe prokurimit;
- menaxhimi i parkut të automjeteve dhe pajisjeve;
- menaxhimi i burimeve njerëzore;
- menaxhimi i armëve, municionit dhe pajisjeve tjera;
- menaxhimi në raste të arrestit dhe ndalimit dhe paraburgimit policor;
- menaxhimi i krimeve kundër minoriteteve dhe lirisë së lëvizjes;
- menaxhimi i patrullimeve;
- menaxhimi i hetimit dhe zbulimit të krimit;
- menaxhimi i ankesave kundër policisë dhe hetimi i shkeljeve disiplinore;
- menaxhimi i planeve për policore lokale, sigurisë së qytetarëve dhe iniciativave të aktiviteteve policore në komunitet;
- menaxhimi i procedimit të të dhënave personale në përputhje me ligjin e aplikueshëm.
- menaxhimi i policisë kufitare; dhe fusha tjera të parapara nga ana e krye shefit të inspektoratit ose Ministrit.

Roli i policisë në të gjitha shtetet është i një rëndësie të madhe në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike si dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut si institucion me rëndësi specifike në strukturat e sigurisë sistemin juridik të shteteve përkatëse, andaj edhe në vendin tonë janë marrë si model apo për bazë përvojat e policive më bashkëkohore dhe më profesionale në ndërtimin e policisë së Kosovës. Treguesi më i mirë për këtë konstatim është performanca e policisë së Kosovës në raport me policitë e shteteve në rajon.

Organizimi i policisë në shumicën e vendeve të cilat janë trajtuar gjatë këtij punimi është po thuaj se i ngjashëm me disa dallime të vogla në formën e organizimit ku disa shtete kanë organizim të ndarë në dy, tre apo katër nivel. Por konsiderojmë se këto ndarje më shumë i takojnë aspekteve të realizimit të punëve praktike policore brenda për brenda shteteve, varësisht nga ajo se si është strukturuar ndarja e brendshme e sistemit policor se sa kanë në fakt ndonjë dallim thelbësor në organizimin e sistemeve policore të trajtuara. Policia e Kosovës ka akceptuar një formë të organizimit të saj, të atillë që funksionimin e policisë e ka të ndarë në nivel qendror (Komanda Qendrore e Policisë së Kosovës) dhe nivel lokal (Komandat Regjionale siç janë: Prishtina, Ferizaj, Gjilani, Peja, Mitrovica dhe Prizreni), mandej në kuadër të regjioneve bëjnë pjesë stacionet përkatëse.

Çështje tejet me rëndësi që duhet të potencohet është se policia e Kosovës ka vetëm një zinxhir komandues unik, i cili gjendet në Komandën qendrore në Prishtinë.

Kontrolli i policisë në përgjithësi është çështje mjaft sensitive, por e domosdoshme dhe shumë e rëndësishëm, ngase policia si një mekanizëm i rëndësishëm i shtetit nëse nuk ka kontroll mundet lehtë të devijojë nga qëllimi i saj.

Pikërisht për këtë arsye edhe zbatohen forma të ndryshme të kontrollit ndaj policisë pa të drejtë të ndërhyrjes në çështjet e operative të sajë dhe pa penguar kryerjen e punëve policore. Ne jemi ndaluar vetëm në disa nga format e kontrollit të policisë së Kosovës duke qenë të vetëdijshëm se ka edhe forma të tjera të kontrollit. Disa nga format të cilat ne i kemi trajtuar janë si në vijim: Kontrolli parlamentar i policisë së Kosovës, i cili ushtrohet nga komisioni parlamentar për punë të brendshme dhe siguri, i cili komision është në kuadër të Kuvendit të Kosovës, dhe i cili e mbikëqyre punën e institucioneve të sigurisë në Kosovë. Mandej kemi trajtuar edhe Kontrollin administrativ – disiplinor ndaj Policisë së Kosovës e ushtron Inspektorati Policor i Kosovës, i cili organ inspekton menaxhmentin e lartë të policisë së Kosovës në lidhje me mënyrën e menaxhimit të planeve operative të zbatuara si dhe heton ankesat rreth shkeljeve të rënda disiplinore ndaj pjesëtarëve të policisë që ushtrohen nga qytetarët apo edhe nga vetë zyrtarët policor përgjegjës në Policinë e Kosovës.

5.11.5 Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë së Inspektimit

Është parim i Policisë së Kosovës me të cilin sigurohet që puna e secilit zyrtar policor dhe punëtor tjetër i punësuar në Policinë e Kosovës, të gjitha njësive, stacioneve, drejtorive dhe e departamenteve të kryhet në përputhje me parimet dhe procedurat në fuqi. Asnjë zyrtar policor apo ndonjë punëtor tjetër i punësuar në Polici nuk guxon ta shkelë apo ta keqpërdor njërën nga këto procedura të cilat janë parim bazë për një punë sa më profesionale dhe në përputhje me Kodin e etikës. Nëpërmjet Auditimit dhe Inspektimit

arrihet që të avancohen standardet unike të punës dhe të menaxhohen në mënyre sa më efikase dhe efektive burimet njerëzore dhe ato materiale në kuadër të PK-së.

Gjithmonë kur Auditimi dhe Inspektimi has në parregullsi dhe keq menaxhim duhet të raportojë dhe të rekomandojë për hapat që duhen ndërmarrë në mënyrë që të mënjanohen eliminohen këto shkelje dhe procedura që duhet ndjekur në të ardhmen. (Parimi 4.56 dhe Ligji për Auditimin e Brendshëm).

Detyrat primare të Njësisë së Inspektimit janë kryerja e inspektimit brenda Organizatës së PK-së në të gjitha nivelet: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoritë Rajonale të PK-së me Stacionet përkatëse në tërë Kosovën, duke përfshirë edhe Drejtoritë Rajonale të Policisë Kufitare si dhe Stacionet Policore të Policisë Kufitare. Këto detyra përfshijnë, por nuk janë të kufizuara nga objektivat pasuse kryesore:

Të kryejë procesin e inspektimit në mënyrë profesionale në përputhje me planin dhe programin e inspektimit të aprovuar më parë nga Shefi i Stafit të Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së;

Të përgatitë raporte, dokumente të shkruara me përmbledhje të qarta e koncize për inspektimin (kontrollin).

Të kryejë hulumtime, kërkime, të analizojë nevojat dhe të mbrojë interesat e PK-së;

Të përpilojë dokumente, të përgatitë propozime të projekteve dhe rekomandimeve;

Të sigurojë konsultime profesionale dhe ligjore në përputhje me legjislacionin përkatës ekzistues dhe kërkesave të kohës;

Përgatitë raporte dhe bën prezantime në interes të PK-së;

Përcjell dhe i përpunon për nevojat e menaxhmentit të lartë të PK-së, ligjet, aktet nënligjore, rregulloret, udhëzimet dhe procedurat që kanë të bëjnë me aktivitete të PK-së;

Të kryejë vlerësime të veçanta, analiza dhe statistika lidhur me aktivitetet e PK-së në përgjithësi;

Organizon trajnime të nevojshme dhe profesionale për pjesëtarët e Njesisë së Inspektimit; Kryen inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme në gjitha departamentet, divizionet, drejtoritë përkatëse, sektorët dhe njësitë e PK-së, pa dallim.

Për punën e Njesisë së Inspektimit, mbikëqyrësi i NJI i raporton Shefit të NJI-së, i cili më pas drejtpërdrejt raporton te Shefi i Stafit të Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së.

Zyrtarët e NJI-së janë të pajisur me dokument identifikimi, që shërben si dëshmi dhe autorizim për të vepruar në emër të NJI-së.

Me përfundimin e inspektimit, përgatitet një raport objektiv për fushën e inspektuar.

Raportet e inspektimit duhet t'i përmbajnë qartë kriteret objektive të gjendjes dhe do të përmbajnë rekomandime për adresimin e çdo rrethane që në mënyrë negative ndikon në efektivitetin e policisë dhe performancën e saj.

Shefi dhe Mbikëqyrësi i NJI-së duhet të sigurojnë se raportet janë në pajtim me standardet më të larta të etikës dhe integritetit si dhe përmbushin objektivat e efektshmërisë dhe performancës policore.

Inspektimi i dosjeve personale për shfrytëzimin e të gjitha llojeve të pushimeve.

Inspektimi i orarit të punës sipas parimeve dhe procedurave policore.

Inspektimi i dosjeve të trajnimeve shtesë të organizuara në kuadër të PK-së.

Inspektimi nëpër vende të punës se si përfillën Urdhëresat e lëshuara nga DPP dhe DRP.

Inspektimi i Njësive të hetimeve në të gjitha nivelet organizative në PK-së.

Inspektimi lidhur me zbatimin e parimeve dhe procedurave policore P. 4.10 Standardet e uniformës dhe stafit civil.

Inspektimi i punëve dhe detyrave të Shërbimeve Mbështetëse.

Inspektimi rreth menaxhimit të personelit (sipas strukturës organizative të aprovuar) në numër dhe grada përkatëse.

Inspektimi rreth menaxhimit dhe shfrytëzimit të veturave të PK-së.

Të iniciojë zgjidhje praktike për çështje lidhur me zbatimin e Parimeve dhe Procedurave mbi përdorimin e automjeteve P. 4-37.

Të krijojnë dhe mirëmbajnë bazë të shënimeve për analiza dhe informata të njësitit/ekipit.

Të përcjell rekomandime të paanshme, duke sjellë vendime të mira në dispozicion.

Të sjellë informata të sakta dhe koncize në lidhje me inspektimin.

Kryen punë të tjera që i përcakton Shefi dhe Mbikëqyrësi i Njesisë së Inspektimit.

Raporton në baza ditore, javore, mujore, tremujore dhe vjetore përmes Mbikëqyrësit dhe Shefit të Njesisë së Inspektimit, për t'u përcjellë sipas zinxhirit komandues tek Drejtoria/njësia përkatëse.

5.11.6 Definimi i misionit të Inspektimit

Misioni i Inspektimit ka të bëjë me kontrollimin dhe mënyrën e menaxhimit dhe të kualitetit të punës dhe të sigurohet se veprimtaritë policore janë duke u kryer në pajtim me parimet dhe procedurat e PK-së.

Të mbikëqyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë mënyrën dhe procedurat e zbatimit të vendimeve, sipas parimeve, procedurave dhe ligjeve në fuqi .

Inspektimi duhet të ketë qasje të pakufizuar në të gjitha fushat e veprimtarisë policore, në të gjitha të dhënat, për personelin, pasuritë dhe objektet, si dhe është i autorizuar të nxjerrë

çfarëdo lloje informate dhe shpjegime të cilat Drejtori i Përgjithshëm i Policisë i konsideron të nevojshme.

Inspektimi duhet ta përpilojë raportin me shkrim, ndërsa një kopje t'ia dërgojë udhëheqësit përkatës ku është bërë Inspektimi. Raporti duhet ti përmbajë detajet e Inspektimit, lëshimet që janë identifikuar dhe rekomandimet për mënjanimin e parregullsive që janë hasur gjatë Inspektimit. (Parimi P-4.56).

Detyrë e Shefit të Inspektimit është që të ndërmarrë veprime të nevojshme për prezantimin e gjendjes së kërkuar dhe, nëse ka shkelje të parimeve dhe procedurave të PK-së, të iniciojë procedurë për përgjegjësi disiplinore.

Inspektimi për parregullsitë e identifikuara gjatë Inspektimit përcakton afate për mënjanimin e tyre dhe për arritjen e nivelit të dëshiruar. Këto afate caktohen varësisht nga natyra e parregullsive dhe e shkeljeve të identifikuara gjatë Inspektimit.

Mosrespektimi i afateve të caktuara për mënjanimin e këtyre parregullsive mund të jetë shkas për inicim të procedurës disiplinore nga ana e kësaj njësie. Autoritet i procedimit të raporteve të Inspektimit është Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Formë e kontrollit të brendshëm ndaj punës policore është inspektimi dhe auditimi. Çdo organizatë apo institucion i rëndësishëm krijon mekanizma të brendshëm të kontrollit, ndërsa vet shteti krijon një mekanizëm qendror të kontrollit që quhet inspektim dhe auditim gjeneral. (Ligji për Auditimin e Brendshëm - Kosovë).

Inspektimi ka për qëllim që të evidentoj gjendjen ekzistuese në zbatimin e ligjeve dhe direktivave të organizatës me qëllim që të konstatohet gjendja faktike e zbatimit të këtyre procedurave dhe të jepen rekomandimet dhe direktivat për eliminimin e dobësive të

evidentuara me qëllim të ngritjes së standardit të punës dhe në rastet e veçanta nëse gjen se ka shkelje të dispozitave ligjore të inicioj procedurë të brendshme hetimore.

Në policinë e Kosovës ekziston njësitë e inspektimit dhe auditimit i cili ka kompetencat e përcaktuara për inspektim dhe auditim në fushat e ndryshme të punës policore.

Karakteristik e veçantë në policinë e Kosovës është se krahas njësitit të inspektimit të brendshëm është i themeluar edhe departamenti i inspektimit të punës policore në kuadër të ministrisë së punëve të brendshme konkretisht në Inspektoratin policore të Kosovës.

Këto njësit të inspektimit bëjnë inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme dhe sjellin rekomandime për drejtorin e përgjithshëm të policisë me raport vjetor apo të veçantë.

Drejtori i përgjithshëm i policisë merr obligime që rekomandimet e inspektimit të i administron dhe të i komplet. (Parimi 3.37 i PK dhe Ligji i Policisë së Kosovës).




Figura 3. Ankesat ndaj Policisë

5.11.7 Detyrat dhe përgjegjësitë:

Inspektimi duhet të kenë qasje të pakufizuar në të gjitha fushat e veprimtarisë policore, në të gjitha të dhënat, për personelin, pasuritë dhe objektet, si dhe është i autorizuar të nxjerrë çfarëdo lloj informate dhe shpjegime të cilat Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Ekipet e Inspektimit duhet të përpilojnë raport me shkrim, ta informojnë Mbikëqyrësin për të gjeturat gjatë Inspektimit. Raporti duhet të përmbajë detajet e Inspektimit, lëshimet që janë identifikuar dhe rekomandimet për menjanimin e parregullsive që janë hasur gjatë Inspektimit. (Parimi P-4.56 Auditimi dhe Inspektimi).

Inspektimi për parregullsitë e identifikuara gjatë Inspektimit përcakton afate për menjanimin e tyre dhe për arritjen e nivelit të dëshiruar.

Këto afate caktohen varësisht nga natyra e parregullsive dhe e shkeljeve të identifikuara gjatë Inspektimit.

Punojnë në punë dhe detyra policore si dhe detyra të caktuara nga Mbikëqyrësit më të lartë sipas strukturës organizative, Shefit të njësisë, Mbikëqyrësit të njësisë, të caktuar dhe aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Të sistemojnë raportet e punës të Njësisë në formë të shkruar dhe elektronike. Angazhimi i ekipeve bëhet sipas P. 3.14 Orari i punës dhe planifikimit nga Mbikëqyrësi i njësisë apo Shefit të Njësisë. Shefi i njësisë apo Mbikëqyrësi i njësisë sipas nevojës kombinon ekipet me qëllim të kryerjes së punëve dhe detyrave policore sidomos në rastet kur njëri nga pjesëtarët e ekipit mungon nga detyra.

Shefi apo Mbikëqyrësi i Njesisë duke u bazuar në organizimin e brendshëm ndërron-kombinon ekipet apo pjesëtarët e ekipit kur vlerëson se është nevojshme, se do të ketë rezultate pozitive, punë më profesionale në lëmit e caktuara policore. (po aty).

Planifikon strategjinë e punës dhe përcakton orarin vjetor të inspektimeve të rregullta, formon ekipet dhe përcakton orarin e punës për të njëjtat, njofton njësitë, drejtoritë, stacionet, regjionet apo departamentet për kohën apo llojet e inspektimit.

- Kryen inspektime dhe ri inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme;
- Personeli i Njesisë njoftohet me kohë për ligjet dhe aktet tjera normative, rregulloret e brendshme të PK-së, procedurat e standardeve të operimit.
- Përcjellë ndryshimet në zhvillimet e tranzicionit dhe jep rekomandime për standardizimin e shkresave të PK-së.
- Përcjellë rekomandimet dhe udhëzimet nëpër shërbimet përkatëse për përmirësimin e standardeve të shërbimeve të punës.
- Raporton dhe rekomandon për parregullsitë që janë regjistruar gjatë inspektimit.
- Inicion dhe rekomandon zgjidhje praktike për çështjet lidhur me zbatimin e ligjeve, akteve të tjera juridike, parimeve dhe procedurave të PK-së dhe procedurat standarde të operimit në fushat konkrete nga veprimtaria e njesisë.
- Krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave, për analiza dhe informata të njesisë/ekipit.
- Përcjellë rekomandime të paanshme, duke propozuar zgjidhje efektive dhe efikase për njësitë organizative të inspektuara,
- Përpilon raporte të sakta dhe koncize mbi inspektimin e kryer,

- Inicion dhe rekomandon ndryshimet e parimeve dhe procedurave sipas praktikës pozitive.
- Krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave dhe procedon raportet e njësive të inspektuara.
- Punë e kompletuar profesionale e hulumtuese, duke u bazuar ne udhëzimet e mbikëqyrësit të Njesisë së Inspektimit dhe Auditimit duke ofruar konkluzione dhe rekomandime sipas kërkesave;
- Vepron sipas orarit vjetor për auditim;
- Kryen auditim në mënyrë profesionale dhe në përputhje me planin dhe programin e auditimit të aprovuar paraprakisht;
- Zhvillon debate (konsulta) me menaxhmentin për fushat e auditimit. Pas përfundimit të kontrollit rekomandon përmirësime në operacionalizimin e çmimeve, ofertave dhe kërkesave, me qëllim të uljes së kostos të shpenzimeve buxhetore;
- Përgatit raporte të shkruara e të paanshme me përmbledhje të qartë e koncize për auditimin (kontrollin);
- Në koordinim me njësitet tjera brenda PK-së, i nxitë që të zhvillohen analiza dhe hulumtime në identifikimin e nevojave në vazhdimësi në të gjitha nivelet e udhëheqjes;
- Përpilon raporte dhe përgatit propozime për projekte dhe rekomandime;
- Siguron konsultime profesionale dhe ligjore në përputhje me legjislacionin përkatës ekzistues dhe kërkesave të parashtruara.
- Përgatit raporte, zhvillon strategji dhe bën prezantime në interes të PK-së.

- Mbikëqyrë dhe koordinon aktivitetet e vartësve dhe të personelit të kontaktuar.
- Konsulton përgjegjësit e të gjitha shtyllave, departamenteve dhe njësive organizative të tjera në lidhje me rregulloret e brendshme, procedurat e operimit dhe urdhëresave;
- Kryen vlerësime të veçanta, analiza, statistika dhe mirëmban bazën e të dhënave për nevoja të Njësisë. (Po aty).
- Inspektimi duhet të kenë qasje të pakufizuar në të gjitha fushat e veprimtarisë policore, në të gjitha të dhënat, për personelin, pasuritë dhe objektet, si dhe është i autorizuar të nxjerre çfarëdo lloje informate dhe shpjegime të cila Drejtori i Përgjithshëm i PK-së i konsideron të nevojshme.
- Inspektimi duhet të përpilojë raportin me shkrim, ndërsa një kopje t'ia dërgojë udhëheqësit përkatës ku është bërë Inspektimi.
- Raporti duhet ti përmbajë detajet e Auditimit dhe Inspektimit, lëshimet që janë identifikuar dhe rekomandimet për menjanimin e parregullsive që janë hasur gjatë Inspektimit.

Detyrë e Shefit të Auditimit dhe Inspektimit është që të ndërmarrë veprime të nevojshme për prezantimin e gjendjes së kërkuar dhe, nëse ka shkelje të parimeve dhe procedurave të SHPK-së, të iniciojë procedurë për përgjegjësi disiplinore.

Inspektimi për parregullsitë e identifikuar gjatë Inspektimit përcakton afate për menjanimin e tyre dhe për arritjen e nivelit të dëshiruar. Këto afate caktohen varësisht nga natyra e parregullsive dhe e shkeljeve të identifikuar gjatë Auditimit dhe Inspektimit.

Mosrespektimi i afateve të caktuara për mënjanimin e këtyre parregullsive mund të jetë shkas për inicim të procedurës disiplinore nga ana e kësaj njësie. Autoritet i procedimit të raporteve të Auditimit dhe Inspektimit është Drejtori i Përgjithshëm i PK-së. (Po aty).

5.11.8 Identifikimi i njësisë së Auditimit dhe Inspektimit

Shefi dhe zyrtarët e Auditimit dhe të Inspektimit pajisen me kartela identifikimi për Auditim dhe inspektim dhe se të njëjtat do t'i prezantojnë para çdo Auditimi dhe Inspektimi.

Njësia e Inspektimit dhe Auditimit e PK-së me personelin e saj vepron në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, e ndarë në: Njësinë e Inspektimit dhe Njësinë e Auditimit të Brendshëm.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Njësisë janë si në vijim:

- Kontrollimi i punës policore, menaxhimit dhe ligjshmërisë së veprimtarisë të PK ;
- Mbikëqyrja e zbatueshmërisë së ligjeve në fuqi, rregulloreve, udhëzimeve dhe urdhrave për të gjitha njësitë dhe pjesëtarët e policisë në të gjitha nivelet;
- Raportimi objektiv për gjendjen e gjetur;
- Rekomandimet për përmirësimin e performancës së punës.

5.12 Procedura Standarde e Operimit - Njësia e Inspektimit

Njësia e Inspektimit si edhe njësit tjera është e obliguar të hartoj Procedurë standarde të të operimit e cila procedurë do të miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Procedura Standarde e Operimit, në rastin konkret nënkupton mënyrën e veprimit të Njesisë së Inspektimit, e cila është standarde për fushë veprimtarinë e saj.

Roli dhe misioni i NJI-së është kontrolli dhe mbikëqyrja e zyrtarëve policorë dhe stafit civil të punësuar në Policinë e Kosovës, në të gjitha Njësitë, Stacionet Policore, Drejtoritë, Divizionet dhe Departamentet përkatëse, në mënyrë që të zbatohen rregullat e punës së Policisë së Kosovës në përputhje me ligjet, parimet dhe procedurat në fuqi, si dhe Urdhëresave dhe Udhëzimeve të aprovuara nga Drejtori i Përgjithshëm i PK-së.

Zyrtarët policorë apo stafi civil, të punësuar në Policinë e Kosovës, duhet të jenë të vetëdijshëm që t'i zbatojnë në praktikë procedurat e lartcekura, ndërsa zyrtarët e Njesisë së Inspektimit, duhet të përkujdesen dhe të raportojnë sipas zinxhirit komandues për çdo parregullsi apo moszbatim të rregulloreve të lartcekura, në përputhje me Kodin e Etikës së PK-së.

Njësia e Inspektimit kryesisht bën kontrollimin dhe mënyrën e menaxhimit të kualitetit të punës duke u siguruar që veprimtaritë policore të realizohen në pajtim me Ligjin e Policisë, ligjet tjera relevante, aktet nënligjore, udhëzimeve administrative, Procedurave Standarde të Operimit, urdhëresave dhe vendimeve të menaxhmentit policor, në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase duke ndikuar në përmirësimin e funksionimit të Policisë së Kosovës.

Njësia e Inspektimit, aktivitetin e vet e realizon kryesisht duke kryer inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Qëllimi i hartimit të PSO-je është që nëpërmjet Njesisë së Inspektimit, të arrihet që të avancohen standardet unike të punës dhe të menaxhohen në mënyrë sa më efikase dhe efektive burimet njerëzore dhe ato materiale në kuadër të PK-së. Gjithmonë kur Njësia e

Inspektimit has në parregullsi dhe keq menaxhim, menjëherë duhet të raportojë dhe të rekomandojë për hapat që duhen ndërmarrë në mënyrë që të mënjanoen shkeljet, si dhe duhet rekomanduar procedurat që duhet ndjekur në të ardhmen.

Njësia e Inspektimit, veprimtarinë dhe aktivitetet e saja i bën duke bërë kontrolle lidhur mënyrën e menaxhimit të kualitetit të punës dhe të sigurohet se veprimtaritë policore janë duke u kryer në pajtim me Ligjin e Policisë, Parimet dhe Procedurat e PK-së dhe aktet tjera nënligjore në fuqi. Njësia e Inspektimit mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë mënyrën dhe procedurat e zbatimit të vendimeve, sipas ligjeve në fuqi, dhe sipas parimeve dhe procedurave të PK-së.

Njësia e Inspektimit duhet të kenë qasje të pakufizuar në të gjitha fushat e veprimtarisë policore, në të gjitha të dhënat, për personelin, pasuritë dhe objektet, si dhe është e autorizuar të nxjerrë çfarëdo lloj informate dhe shpjegime të cilat Drejtori i Përgjithshëm i PK-së, ose i autorizuari i tij i konsideron të nevojshme.

Njësia e Inspektimit duhet ta përpilojë raportin me shkrim, ndërsa një kopje t'ia dërgojë mbikëqyrësit përkatës ku është bërë inspektimi. Raporti duhet t'i përmbajë detajet e inspektimit, lëshimet që janë identifikuar dhe rekomandimet për mënjanimin e parregullsive që janë hasur gjatë inspektimit.

Detyrë e Shefit të Njesisë së Inspektimit është që të ndërmarrë veprime të nevojshme për prezantimin e gjendjes së kërkuar dhe, nëse ka shkelje të parimeve dhe procedurave të PK-së, të kërkojë iniciimin e procedurës për përgjegjësi disiplinore.

Shefi i Njesisë së Inspektimit lidhur për parregullsitë e identifikuar gjatë inspektimit përcakton afate për mënjanimin e tyre dhe për arritjen e nivelit të dëshiruar. Këto afate

caktohen varësisht nga natyra e parregullsive dhe e shkeljeve të identifikuara gjatë inspektimit.

Mosrespektimi i afateve të caktuara për mënjanimin e këtyre parregullsive mund të jetë shkas për propozimin e inicimit të procedurës disiplinore nga ana e Njesisë së Inspektimit.

5.12.1 Detyrat dhe përgjegjësitë e Shefit të Njesisë së Inspektimit

Udhëheq dhe menaxhon me Njësinë e Inspektimit, duke përfshirë stafin e tij vartës, automjetet si dhe pajisjet tjera në kuadër të NJI-së.

- Bën përcjelljen e të gjitha raporteve që dalin nga Njësia e Inspektimit.
- Informon me kohë stafin për ndryshimet dhe plotësimet me ligjet, aktet nënligjore dhe parimet e Policisë.
- Përcjell ndryshimet dhe jep rekomandime për standardizimin e shkresave të Policisë.
- Përkujdeset për zhvillimin e stafit të NJI-së si dhe vlerëson vartësit e tij në forma periodike.
- Përcjell rekomandimet dhe udhëzimet nëpër shërbimet përkatëse për përmirësimin e standardeve të punës në Polici.
- Raporton dhe rekomandon për parregullsitë që janë gjetur gjatë inspektimit.
- Informon dhe njofton Drejtoritë e nivelit qendror, Drejtoritë rajonale të Policisë, Departamentet dhe njësitë tjera të Policisë për inspektime dhe kohën e inspektimeve.
- Bën ndarjen e ekipeve dhe përcakton orarin e punës sipas ekipeve.

- Mbështet Njësinë e Inspektimit në përgatitjen e raporteve dhe dokumenteve të shkruara me përmbledhje të qarta e koncize për inspektimet e kryera.
- Kryen hulumtime, kërkime, analizon nevojat dhe mbron interesat e Policisë,
- Përpilon dokumente, përgatit propozime të projekteve dhe rekomandimeve.
- Zhvillon konsultime profesionale dhe ligjore në përputhje me legjislacionin përkatës ekzistues dhe kërkesave të kohës.
- Përgatit raporte periodike dhe bën prezantime në interes të Policisë.
- Përcjell dhe i përpunon për nevojat e PK-së, aktet nënligjore, rregulloret, udhëzimet dhe procedurat që kanë të bëjnë me fushë veprimtarinë dhe aktivitetet e Policisë.
- Bashkëpunon me të gjithë menaxherët e Departamenteve, Divizioneve dhe Drejtorive përkatëse në lidhje me Procedurat Standarde të Operimit, Udhëzimeve Administrative dhe Urdhëresave, të cilat janë relevante për punën e tyre.
- Kryen vlerësime të veçanta, analiza dhe statistika në interes të PK-së;
- Zhvillon aktivitete përgatitore paraprake për realizimin e inspektimeve;
- Përcakton afate për përmbushjen e rekomandimeve për të gjitha Njësitë organizative të PK-së.

5.12.2 Detyrat dhe përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të Njësisë së Inspektimit

Udhëheq dhe menaxhon me stafin vartës (zyrtarët e inspektimit) të Njësinë e Inspektimit.

- Në mungesë të Shefit të Njësisë së Inspektimit, mbikëqyrësi i NJI-së zëvendëson atë.

- Përkujdeset për zhvillimin e stafit vartës të NJI-së si dhe vlerëson vartësit e tij në forma periodike.
- Mban bazën e të dhënave dhe përcjelljen e raporteve.
- Raporton në perioda ditore, javore, mujore, tremujore dhe vjetore tek Shefi i Njësisë së Inspektimit lidhur me të gjitha aktivitetet e NJI-së.
- Informon me kohë stafin për ndryshimet dhe plotësimet me ligjet, aktet nënligjore dhe parimet e Policisë.
- Në bashkëpunim me Shefin e NJI-së përcjell ndryshimet dhe jep rekomandime për standardizimin e shkresave të Policisë.
- Përcjell rekomandimet dhe udhëzimet nëpër shërbimet përkatëse për përmirësimin e standardeve të punës në Polici.
- Përmes Shefit të NJI-së, raporton dhe rekomandon për parregullsitë që janë gjetur gjatë inspektimit.
- Përmes zinxhirit komandues informon dhe njofton Drejtoritë e nivelit qendror, Drejtoritë rajonale të Policisë, Departamentet dhe njësitë tjera të Policisë për inspektime dhe kohën e inspektimeve.
- Në bashkëpunim me Shefin e NJI-së, bën ndarjen e ekipeve dhe përcakton orarin e punës sipas ekipeve.
- Mbështet NJI-në në përgatitjen e raporteve dhe dokumenteve të shkruara me përmbledhje të qarta e koncize për inspektimet e kryera.
- Kryen hulumtime, kërkime, analizon nevojat dhe mbron interesat e Policisë,
- Përpilon dokumente, përgatit propozime të projekteve dhe rekomandimeve.

- Zhvillon konsultime profesionale dhe ligjore në përputhje me legjislacionin përkatës ekzistues dhe kërkesave të kohës.
- Përgatit raporte dhe bënë prezantime në interes të Policisë.
- Përcjell dhe i përpunon për nevojat e PK-së, ligjet, aktet nënligjore, rregulloret, udhëzimet dhe procedurat që kanë të bëjnë me fushë veprimtarinë dhe aktivitetet e NJI-së dhe PK-së në përgjithësi.

5.12.3 Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarëve të Njesisë së Inspektimit

Detyrat primare të Zyrtarëve të NJI-së janë kryerja e inspektimit brenda Organizatës së PK-së në të gjitha nivelet: Drejtorinë e Përgjithshme të PK-së, Drejtoritë Rajonale, Stacionet Policore, Drejtoritë Rajonale të Policisë Kufitare së bashku me stacionet e tyre përkatëse, dhe të gjithë Sektorët dhe Njësitë organizative të PK-së në tërë Kosovën, duke u bazuar në Parimin P-4.56 dhe autorizimet e këtij Parimi:

- Inspektimi i dosjeve personale për shfrytëzimin e të gjitha llojeve të pushimeve.
- Inspektimi i orarit të punës sipas parimeve dhe proceduarve policore.
- Inspektimi i Njësive të hetimeve në gjitha nivelet organizative të PK-së.
- Inspektimi i dosjeve të trajnimeve shtesë të organizuara në kuadër të PK-së.
- Inspektimi nëpër vende të punës dhe përfillja e Urdhëresave e Emërimeve të lëshuara nga DPP dhe Drejtoritë Rajonale.
- Inspektimi lidhur me zbatimin e parimeve dhe proceduarve policore P-4.10 Standardet e uniformës dhe stafit civil.
- Inspektimit i punëve dhe detyrave të Shërbimeve Mbështetëse.

- Inspektimi rreth menaxhimit të personelit (sipas strukturës organizative të aprovuar) në numër dhe grada përkatëse.
- Inspektimi rreth menaxhimit dhe shfrytëzimit të veturave të PK-së.
- Të inicioj zgjidhje praktike për çështje lidhur me zbatimin e Parimeve dhe Proceduarve mbi përdorimin e automjeteve P-4.37.
- Të krijojnë dhe mirëmbajnë bazë të shënimeve për analiza dhe informata të njësitit/ekipit.
- Të përcjell rekomandime të drejta, të paanshme, duke u bazuar vetëm në argumente dhe fakte, duke sjellë vendime të mira në dispozicion dhe në interes të PK-së.
- Të sjellë informata të sakta dhe koncize në lidhje me inspektimin.
- Kryen punë të tjera që i përcakton Shefi apo Mbikëqyrësi i Njesisë së Inspektimit.
- Raporton në baza ditore, javore, mujore, tremujore dhe vjetore te Shefi apo Mbikëqyrësi i Njesisë së Inspektimit.

Njësia e Inspektimit, sipas Strukturës Organizative të PK-së, të miratuar më 17 maj 2012, bën pjesë në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, ndërsa i raporton drejtpërdrejt Shefit të Stafit të Drejtorit të Përgjithshëm.

NJI ka autorizime të plota të inspektimit në të gjitha Departamentet, Divizionet dhe Drejtoritë e PK-së, të gjithë Sektorët dhe Njësitë e PK-së, pa dallim, duke ofruar një pasqyrë të qartë dhe reale të kualitetit të punës së Organizatës së PK-së në përgjithësi.

Zinxhiri komandues:

- Zyrtarët e Njesisë së Inspektimit

- Mbikëqyrësi i Njesisë së Inspektimit
- Shefi i Njesisë së Inspektimit
- Shefi i Stafit të Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së
- Shfuqizimi dhe amandamentimi
- Të drejtën e shfuqizimit dhe të amandamentimit të kësaj PSO-je e ka vetëm Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.
- Referencat për hartimin e kësaj PSO-je:
- Parimet dhe Procedurat e Policisë së Kosovës.
- Ligji i Policisë së Kosovës;
- Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës;
- Parimi P-4.56 Auditimi dhe Inspektimi;
- P-10.04, Parimi për Procedura Standarde të Operimit.

5.13 Kontrolli dhe auditimi i brendshëm

Kontrolli i brendshëm ka për funksion emetimin e rregullave dhe procedurave për caktimin e masave efikase për të bërë të mundur arritjen e objektivave në administrimin e burimeve, në mënyrë që ato të jenë të mirë përdorura, të mbrojtura fizikisht nga keqpërdorimet si dhe ti japin rezultatet e parashikuara në programe.

Nga ana tjetër kontrolli i brendshëm duhet të sigurojë në mënyrë të arsyeshme se programet janë hartuar për të garantuar përdorimin e burimeve në mënyrën më të mirë të mundshme. Kontrolli i brendshëm jep siguri të arsyeshme (jo absolute) për menaxhimin se objektivat që do arrihen.

Mjedisi i kontrollit të brendshëm:

Ligji “ Për qarkullimin dhe dokumentimin e vlerave materiale”.

Ligji “ Për hartimin e zbatimin e buxhetit te shtetit”

Ligji “ Për kontabilitetin”

Ligji “ Për statusin e nëpunësit civil”

Ligji “Për prokurimin publik”

Mungesa e një sistemi të organizuar të kontrollit të brendshëm sjell që:

Subjektet publike e kanë të kufizuar mundësinë për të nxjerre rregulla për administrimin e burimeve publike, mbasi nuk janë të autorizuar nga ndonjë ligj sipas kushtetutës, nuk janë të përcaktuara parimet mbi të cilat do të nxirren këto rregulla.

Rregullat dhe procedurat duhet te jene ne një proces te vazhdueshëm ndryshimesh, pra duhet të krijohen hapësira për këto ndryshime.

Ekzistojnë dy grupime të mëdha në çështjen e përkufizimit të kontrollit të brendshëm: 1. Ai amerikan GAO; 2. Ai evropian INTOSAI.

Përkufizimi sipas INTOSAIT

Kontrolli i brendshëm është tërësia e instrumenteve, procedurave, metodave, sistemeve të krijuara nga një subjekt, për t’u siguruar që veprimtaria e saj të përputhet me rregullat dhe kërkesat e jashtme e të brendshme (ligjet), rregulloret, direktivat e drejtimit etj., që subjekti ruan burimet, në mënyrë të tillë që inkurajon operacionet ekonomike në mënyrë efektive dhe efikase, që subjekti paraqet informacion të saktë financiar dhe të drejtimit.

Përkufizimi sipas GAO-s, kontrolli i brendshëm është një proces, i ndikuar nga menaxhimi dhe personeli tjetër, i projektuar që të japë siguri të arsyeshme në lidhje me arritjen e objektivave në kategoritë vijuese:

- Besueshmëria dhe raportimi financiar;
- Efektiviteti dhe efikasitetin e veprimeve;
- Pajtueshmëria me ligjet dhe rregullat.

Komponentët e kontrollit të brendshëm (sipas standardeve ndërkombëtare):

- Ambienti i kontrollit;
- Vlerësimi i riskut;
- Aktiviteti i kontrollit;
- Informacioni dhe komunikimi.

Ambienti i kontrollit përfshin:

- Vlerat etike dhe integritetin;
- Filozofinë e menaxhimit dhe stilin e operimit;
- Strukturën organizative;
- Caktimin e autoritetit dhe përgjegjësisë;
- Politiken e burimeve;
- Kompetencën e personelit.

Vlerësimi i riskut

1. Faktorë të jashtëm:

- Ndryshimet ekonomike;
- Ndryshimi i punonjësve, komunitetit, nevojave dhe synimeve për atë që do të arrihet;
- Ndryshimi i legjislacionit;
- Zhvillimet teknologjike;
- Katastrofat natyrore;
- Kushtet konkurruese.

2. Faktorë të brendshëm:

- Personeli i ri;
- Kompetenca, përshtatshmëria dhe integriteti i personelit;
- Madhësia e subjektit dhe kompleksitetit i veprimeve;
- Ndryshime në përgjegjësitë e drejtimit.

Analiza e riskut:

- Mandatin qeveritar;
- Skandalet publike;
- Të papriturat;
- Mosrealizimin e të ardhurave;
- Pengesat.

Aktiviteti i kontrollit:

- Rishqyrtimin e nivelit të performances aktuale të vet menaxhimit;
- Rishqyrtimin e performances në nivelin operacional;
- Analizën e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Kontrollin fizik mbi asetet e dobëta;
- Ndarjen e detyrave;
- Ekzekutimin e transaksioneve;
- Regjistrimin e transaksioneve;
- Dokumentimi i saktë i transaksioneve dhe kontrollit të brendshëm.

Informacioni dhe komunikimi

- Politikat dhe procedurat e shkruara të subjektit;
- Qëllimet dhe objektivat e buxhetit;

- Politikat dhe procedurat e dokumentuara të buxhetit;
- Organigramin;
- Përshkrimin e postit;
- Vlerësimin e performances për personelin;
- Programet e trajnimit dhe
- Raportet periodike progresive.

Tipat e kontrollit

Sipas funksioneve dhe ndikimeve që ushtrojnë në veprimtarinë e subjektit.

- Parandalues, zbulues, direktivë, kontroll i përgjithshëm, kontroll i aplikuar dhe parandalues.

Kontroll sipas fushës ku ato veprojnë dhe implementime;

- Kontroll administrative;
- Kontroll te burimeve njerëzorë;
- Kontroll buxhetore,
- Kontroll financiare,
- Kontroll të kontabilitetit,
- Kontrolli i prokurimeve publike,
- Auditimi i brendshëm etj.

Auditimi i brendshëm i sektorit publik

Është një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për drejtimin e projektuar për të shtuar vlerën dhe përmirësuar veprimet e subjektit publik. Ai ndihmon

subjektin me ane të një mënyre sistematike dhe te disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar frytsh mërinë e menaxhimit te riskut, proceset e kontrollit dhe te qeverisjes.

Ku mbështetet funksionimi i auditit:

Ligji Nr.9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm ne sektorin publik”. Ligji i mësipërm përfshin:

- auditimin e sistemit;
- pajtueshmërinë dhe miratimin e auditimit;
- auditimin e vlerësimit të drejtimit (performacës).

Drejtimit kryesore të auditimit

Përdorimi me kursim, dobi dhe frytshmi të burimeve financiare dhe njerëzore; Risku i kontrollit të drejtimit; Shkalla në të cilën rezultatet e programeve të subjektit të audituar plotësojnë objektivat e tij; Pajtueshmëria e veprimtarisë së subjektit të audituar me legjislacionin në fuqi; Kujdesi për plotësimin e të dhënave financiare dhe të drejtimit, si dhe përdorimi i tyre në mbështetje të vendimmarrjes; Ruajtja dhe miradministrimi i aseteve, pronë publike.

Parimet e përgjithshme të funksionimit të auditimit, parimet e ligjshmërisë, parimet pavarësisë, parimet paanësisë, parimet fshehtësisë.

Zbatimi i parimit të ligjshmërisë

Është respektimi i Kushtetutës, i legjislacionit te shtetit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ku shteti është palë.

Zbatimi i parimit të pavarësisë

Është ushtrimi i veprimtarisë për përcaktimin, planifikimin, realizimin dhe raportimin e veprimtarisë së auditimit, jashtë çdo ndikimi, që ka lidhje me veprimtarinë e audituar apo rrethanat, që cenojnë apo mund të cenojnë objektivitetin.

Vlerësimi për objektivitetin administrohet, në radhë të parë, nga vetë individi, në rolin e audituesit dhe më pas nga strukturat mbikëqyrëse.

Zbatimi i parimit të pa-anësisë

Është pasqyrimi objektiv dhe transparent në dokumentet përkatëse i të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e subjekteve të audituara, pa u ndikuar nga interesi vetjak ose pikëpamjet e palës së tretë.

Zbatimi i parimit të fshehtësisë

Është trajtimi si konfidencial i të dhënave të tjera, të administruara gjatë auditimit.

5.14 Objektivat e auditimit të brendshëm

Dhënia e një sigurie të arsyeshme dhe të pavarur, për drejtuesit kryesorë, për përmirësimin e veprimeve të entit, duke zbatuar mënyrën më të mirë sistematike, vlerësimin dhe përmirësimin e frytshmërisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm. Shqyrtimi i sistemeve të kontrollit dhe transaksionet, për vlerësimin dhe dhënien e rekomandimeve lidhur me: Rreziqet e brendshme, në kuadër të kontrollit të drejtimit; përdorimin me kursim, dobi dhe frytshmi të burimeve financiare dhe njerëzore; shkallën që rezultatet e programeve të subjektit të audituar plotësojnë objektivat e tij dhe nëse arritjet e programit, takohen me ato të planifikuara; pajtueshmërinë e veprimtarisë së subjektit të auditit me legjislacionin në fuqi; kujdesin dhe plotësimin e të dhënave financiare dhe të drejtimit, për mbështetjen e procesit të vendimmarrjes në drejtim.

Funksionet e auditit të brendshëm

Të auditojnë, në përputhje me kërkesat, standardet e auditimit dhe me përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj.

- Të kërkojnë, marrin dhe përdorin lirisht dhe pa kufizim të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe të menaxhimit të subjektit publik që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e të dhënave me karakter sekret.
- Të tërheqin për nevoja auditimi, kopje të dokumenteve, të vërtetuara ose origjinale, kundrejt vërtetimit të lëshuar. Dokumentet origjinale duhet të kthehen tek subjekti publik brenda 72 orëve.
- Të hyjnë dhe të verifikojnë në vend, në depo, magazina, njësi ose objekte, pa asnjë kufizim; të vlerësojnë dhe të verifikojnë, kudo ku ka vlera materiale e monetare, në pronësi të shtetit, duke respektuar rregullat e brendshme të subjektit dhe në përputhje me programin e auditimit.
- T'i propozojnë drejtuesit të njësisë së auditimit ndalimin e përkohshëm, kurdoherë të arsyetuar me shkrim, të veprimeve, që bien ndesh me legjislacionin në fuqi ose që cenojnë interesat ekonomike të shtetit deri në shqyrtimin përfundimtar nga organet përkatëse, që i kanë në përgjegjësi.
- Të kërkojnë deklarime nga të audituarit ose nga personat e tjerë, për problemet që lidhen me auditimin.

Në bashkëpunim me subjektin e audituar, të përcaktojnë detyrat dhe masat për korrigjimin e parregullsive të vërtetuara nga auditimi.

- Kur vërtetojnë përgjegjësi materiale ose financiare, shkelje dhe parregullsi, propozojnë, sipas rastit, masa me karakter zhdëmtimi, ose masa disiplinore.

Çfarë është e këshillueshme për raportin përfundimtar të auditit

- Objektivat e auditit,
- Fusha e auditimit,
- Zbulimet (negative ose pozitive),
- Zonat për përmirësim dhe
- Rekomandime.

5.15 Çfarë është Kontrolli i Lartë i Shtetit (SAI)

Kontrolli i Lartë i Shtetit është një organ kushtetues veprimtaria e të cilit rregullohet mbi bazën e Kushtetutës së R.SH. si dhe të ligjit specifik për Kontrollin e Lartë të Shtetit.

- Sipas Kushtetutës, Kontrolli i Lartë i Shtetit është organi më i lartë i auditimit financiar në Republikën e Shqipërisë dhe në veprimtarinë e tij ai i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe Ligjeve. Kushtetuta përcakton se Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi i Shqipërisë dhe ka një mandat prej shtatë vjetësh.

Objekti i punës i këtij organi është:

- Veprimtaria ekonomike e financiare e sektorit publik;
- Përdorimi dhe mbrojtja e fondeve shtetërorë nga pushteti qendror dhe vendor;
- Veprimtaria e personave juridike ku Shteti ka më shumë se 50 % të aksioneve ose kur huat dhe detyrimet e tjera garantohen nga Shteti me sektor publik në

veprimtarinë e KLSH do të kuptohet sektorin shtetëror, ku pjesëmarrja e shtetit është mbi 50 %.

Kontrolli i lartë i Shtetit i raporton Kuvendit të Shqipërisë për:

- Për zbatimin e buxhetit të shtetit;
- Jep mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar përpara se ai të miratohet në Kuvend.
- Për rezultatet e auditimit sa herë që kërkohet nga Kuvendi.

Ligji Nr.8270 datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” ndryshuar me ligjin Nr.8599 datë 10.04.2000.

Ky Ligj përcakton bazat e organizimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë , raportimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Përcakton objektivat, detyrat, organizimin, kompetencat. Në ligj KLSH përkufizohet si organi më i lartë i kontrollit ekonomik-financiar në R. Sh., përcakton si një organ i pavarur i depolitizuar dhe departizuar i cili udhëhiqet vetëm nga Kushtetuta dhe ligjet e tjera.

Objektivat e Kontrollit të Lartë të Shtetit:

K.L Sh mund të japë rekomandime lidhur me vlerësimin e drejtimit dhe të veprimtarisë auditimit të brendshëm.

Propozon për ndryshime në legjislacion në të gjitha fushat e veprimtarisë ekonomike e financiare dhe të drejtimit duke kërkuar shfuqizimin e tyre nga organi që i ka nxjerrë dhe nëse kjo nuk realizohet brenda dy muajve ai u drejtohet organeve më të larta.

Kompetencat e KLSH-së:

Kërkon nga subjektet e audituara marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e gjendjes në përputhje me rekomandimet e tij lidhur me;

Marrjen e masave disiplinore ose të zhdëmtimit në përputhje me ligjet për personat që kanë shkaktuar dëme interesave shtetërore.

Ai gjithashtu ka të drejtë dhe subjektet e audituara janë të detyruara të raportojnë me shkrim brenda 20 ditëve për zbatimin e rekomandimeve ose marrjen e masave.

Te merren masa në përputhje me rregullat e prokurimeve kur janë shkelur procedurat përkatëse si dhe të paraqesë padi në gjyq për çështje që i çmon te arsyeshme.

Një audit përpara se të filloje auditimin duhet të sigurohet vetë se e ka autoritetin e nevojshëm personal për punën që do të kryejë. Ai nuk duhet të harrojë për asnjë moment se kryetari i Njësisë së auditit dhe publiku kanë besim tek ai.

Auditimi i brendshëm është profesion dhe aktivitet që merret me këshillimin e organizatave lidhur me mënyrën se si t'i realizojnë më mirë objektivat e tyre. Auditimi i brendshëm përfshinë shfrytëzimin e metodologjisë sistematike për analizimin e proceseve afariste apo problemeve organizative dhe me rekomandimin e zgjidhjeve. Auditorët e brendshëm punësohen nga organizatat për të bërë aktivitet të auditimit të brendshëm. Fushëveprimi i auditimit të brendshëm brenda një organizate është i gjerë dhe mund të përfshijë çështje të kontrollit të brendshëm siç janë efikasiteti i operacioneve, besueshmëria e raportimit financiar, zbulimi dhe hulumtimi i mashtrimeve, ruajtja e aseteve dhe përputhshmëria me ligjet dhe rregulloret. Auditorët e brendshëm nuk janë përgjegjës për ekzekutimin e aktiviteteve të kompanisë; ata këshillojnë menaxhmentin dhe bordin e drejtorëve (apo organin e ngjashëm mbikëqyrës) lidhur me mënyrën se si t'i

ekzekutojnë përgjegjësitë e tyre më mirë. Si rezultat i fushëveprimit të tyre të gjerë, auditorët e brendshëm mund të kenë nivele të ndryshme të shkollimit profesional të lartë.

5.16 Pavarësia e organizatës

Për ta kryer rolin e tyre në mënyrë efikase, auditorët e brendshëm kërkojnë pavarësi organizative nga menaxhimet për të mundësuar vlerësim të pakufizuar të aktiviteve të menaxhmentit dhe personelit. Megjithëse auditorët e brendshëm janë pjesë e menaxhmentit të kompanisë dhe paguhen nga kompania, klienti i tyre kryesor i aktivitetit të auditimit të brendshëm është entiteti i ngarkuar me mbikëqyrjen e aktiviteve të menaxhmentit. Për të ofruar pavarësi, shumë auditor ekzekutiv i raportojnë kryesuesit të komitetit të auditimit dhe mund të zëvendësohen vetëm me marrëveshjen e atij individi.

Roli në kontrollin e brendshëm.

Aktiviteti i auditimit të brendshëm kryesisht ka për qëllim përmirësimin e kontrollit të brendshëm. Sipas kornizës së COSO-së, kontrolli i brendshëm zakonisht definohet si një proces që ndikohet nga bordi i një entiteti të drejtorëve, menaxhmentit dhe personelit tjetër, që ka për qëllim të ofrojë siguri të arsyeshme lidhur me arritjen e objektivave në kategoritë vijuese:

- Efikasiteti dhe efektiviteti i operacioneve.
- Besueshmëria e raportimit financiar.
- Përputhshmëria me ligjet dhe rregulloret.

5.17 Llojet e auditimeve të brendshme

Ekzistojnë pesë lloje të auditimeve të brendshme të cilësisë të cilët mund të ndahen si në vijim:

- Auditimet e sistemeve - Vlerësojnë efikasitetin e sistemit të MC-së si tërësi.
- Auditimet procedurale - Elementet e ndryshme të sistemeve të MC-së do të gjykohen për sa i përket procedurave.
- Auditimet e produktit/shërbimit - Elementet e sistemeve të MC-së vlerësohen në bazë të produkteve/shërbimeve.

Përpos këtyre, ekzistojnë auditime të rregullta dhe të paplanifikuara.

Auditimet e planifikuara - janë të përcaktuara në aspekt të afateve dhe fushave që duhet të auditohen si dhe shpeshësinë e tyre.

Artikulli në vijim mund të shfrytëzohet për t'i treguar faktet për dhe kundër lidhur me auditimet e brendshme dhe për të treguar si të shfrytëzohen auditimet e brendshme për të përmirësuar biznesin dhe për të qenë i suksesshëm. Monitorimi i cilësisë nga jashtë është komponentë e rëndësishme e menaxhimit të cilësisë. Ajo i ofron bordit dhe grupeve të tjera që mbështeten në punën e auditorit të jashtëm konfirmim të pavarur të cilësisë së punës së kryer. Monitorimi i cilësisë nga jashtë duhet të bëhet nga persona të kualifikuar të cilët janë të pavarur nga organizata dhe të cilët nuk kanë konflikt të interesit. Auditorët e jashtëm mund të angazhohen, por kjo mund të kushtojë shtrenjtë për një biznes të vogël. Auditorët e brendshëm të zgjedhur me kujdes janë shumë efikas në mbajtjen e sistemeve dhe në funksionimin e tyre të duhur. Zgjedhja e stafit nga biznesi konsiderohet të jetë më efikas se sa të merret nga seksioni i auditimit.

Kjo mundëson kuptimin e procesit të menaxhimit të cilësisë në biznes, ofron mundësi për sektor të ndryshëm që ta auditojnë njëri tjetrin dhe largon qasjet ‘na dhe ata’. Përpos kësaj, kjo është më efikase nëse auditorët nuk janë pjesë e menaxhmentit. Kjo e bënë të qartë se vlerësimi ka të bëjë me sistemin e jo me nëpunësit. Auditorët e trajnuar mirë do të kujdesen që koncepti i auditimeve të brendshme të shtojë vlerë në biznes, e jo të gjejë gabime tek personat apo funksionet që auditohen. Nxënësit duhet të kërkojnë ueb sajtin në vijim për të gjetur më shumë informacione rreth menaxhimit të cilësisë, normave të ISO, sigurimit të cilësisë dhe auditimeve të çdo standardi. Duhet gjithashtu të shikoni ‘Vijën e Sistemit të Menaxhimit’ në www.quality.co.uk/, për informacione shtesë lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë.

Nevoja e krijoj auditimin e brendshëm dhe po e bënë atë pjesë përbërëse të organizatave moderne. Asnjë nga bizneset e mëdha nuk mund të mos ketë një funksion të tillë. Nëse nuk e kanë deri tani, duhet ta kenë herët a vonë (Arthur E. Hald, 1944). Auditimi i brendshëm përbën sot një element kryesor të qeverisjes së çdo organizate, pavarësisht nga aktiviteti që kryen apo pronësia.

Skandalet që kanë ndodhur në mënyrë të vazhdueshme në korporatat e mëdha, por sidomos ato të tipit të ENRON, “Parmalat” etj., rreth viteve 2000, e drejtuan vëmendjen te nevoja për përmirësimin e qeverisjes së korporatës dhe për forcimin e funksionit të auditimit. Firmosja nga Presidenti Bush i ligjit Sarbanes – Oxley në vitin 2002 bëri që auditimi i brendshëm të marrë rol më të rëndësishëm në korporata dhe institucione.

Megjithëse prej kohësh njëhej rëndësia e këtij funksioni në mbështetje të qeverisjes së mirë të organizatave, madje kjo rëndësi ishte mishëruar në formulimin e standardeve

ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, përsëri ishte ky moment që ndikoi në pranimin në praktikë të rolit të auditimit të brendshëm.

Ditët kur audituesi i brendshëm kontrollonte nëse ishin mbledhur apo shumëzuar saktë shifrat nëpër fatura e dokumente të tjera kontabël, janë tashmë të kaluara. Sot audituesi i brendshëm dhe funksioni i auditimit të brendshëm orientohen te vlerësimi i rreziqeve të një organizate dhe kontrolleve të vendosura për reduktimin e tyre, me synim përmbushjen e objektivave të organizatës. Sot auditimi i brendshëm konsiderohet si një element kyç për të pasur një aktivitet të suksesshëm.

5.17.1 Zhvillimi historik i auditimit

“Origjina e auditimit fillon që nga kohët kur kontabiliteti sapo kishte filluar. Me zhvillimin e civilizimit, lindi nevoja e një njeriu të besueshëm në lidhje me pasurinë e një tjetri”. (Richard Brown 1905).

Ngritja e funksionit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm buroi nga nevoja për të pasur disa mjete të pavarura të verifikimit me qëllim që të reduktoheshin gabimet nga regjistrimet kontabile, përvetësimet e pasurive dhe mashtrimet brenda organizatave fitimprurëse dhe jo fitimprurëse.

Funksioni i auditimit ka rrënjë të hershme. Ai ka zënë vend të rëndësishëm në administratën publike qysh në vitet 4000 para Krishtit (P.K.), në Lindjen e Afërt e më pas në Egjipt dhe në Kinë. Më vonë edhe sistemet publike financiare të Babilonisë, Greqisë, Perandorisë Romake, shtetet e Italisë etj., e ndien nevojën për auditim. Kjo nevojë u diktua nga shqetësimi që ekzistonte prej gabimeve dhe pasaktësive në regjistrime, që

mund të bëheshin nga punonjësit jo kompetentë, por edhe nga shqetësimi prej mashtrimit, që mund të kryhej prej punonjësve të korruptuar. Për pasojë, në këto qytetërime u zhvilluan sisteme të detajuara të spontanëve dhe verifikimeve (O'Reilly, 1998). Në Evropën e shekullit 18, auditimi më tepër përqendrohej në verifikimin e pajtueshmërisë me rregullat dhe normat e dekretuara nga autoritete të ndryshme.

Me hyrjen e shekullit të 20, theksi u vu në krijimin e një funksioni formal të auditimit të brendshëm. Bazat, zhvillimi dhe evoluimi i profesionit bashkëkohor të auditit të brendshëm është i lidhur ngushtë me historinë e Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA), një institut ndërkombëtar, i cili u themelua nga 24 anëtarë, të mbledhur në qytetin e Nju Jorkut, SHBA, më 9 dhjetor të vitit 1941. Prej atij momenti, profesioni i auditimit të brendshëm ka njohur rritje dhe përparim të konsiderueshëm. Nga fundi i viteve 1970, profesioni i auditimit të brendshëm fitoi të drejtën për t'u quajtur "profesion që mund të zhvillohet shpejt dhe në mënyrë të qëndrueshme" dhe që premtonte të bëhet "një profesion në shekullin e 21-të".

5.17.2 Çfarë është auditimi i brendshëm

A ka hartuar dhe shpallur Kuadrin e Praktikës Profesionale të Audituesit të Brendshëm. Ky kuadër përbëhet nga: Përkufizimi i Auditimit të Brendshëm, Standardet e Auditimit, Kodi i Etikës, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga ushtruesit e profesionit të auditimit të brendshëm. Kuadri përmban edhe elemente të cilët nuk janë të detyrueshme për zbatim, por ndjekja e tyre e orienton dhe e ndihmon audituesin e brendshëm të kuptojë mirë elementët e detyrueshëm të cituar më sipër dhe t'i zbatojë drejt e me objektivitet ato.

Elementët jo të detyrueshëm janë praktikat këshillimore, dokumentet që shprehin pozicionin e IIA-së për çështjet e auditimit të brendshëm, dokumente kërkimore etj.

Për të kuptuar së çfarë është auditimi i brendshëm, më e saktë do të ishte t'i referohemi përkufizimit të shpallur nga IIA: “Auditimi i brendshëm është një aktivitet sigurie dhe këshillimi, i pavarur dhe objektiv, i ndërtuar për të shtuar vlerë dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës. Ai ndihmon organizatën të arrijë objektivat, duke përdorur mjete sistematike në vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të administrimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve të drejtimit”. Ky përkufizim i auditimit të brendshëm qartëson rolin dhe përgjegjësinë e këtij funksioni:

Auditimi i brendshëm drejtohet për nga kërkesat e klientëve dhe merret me çështjet kryesore të kontrollit, drejtimit dhe qeverisjes. Kjo realizohet nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të sigurisë dhe këshillimit.

Auditimi i brendshëm ka kontribut të rëndësishëm në çdo organizatë, pasi në veprimtarinë e vet duhet të tregojë se po i shton vlerë dhe po përmirëson operacionet e organizatës.

Auditimi i brendshëm ka përgjegjësi që ta mbështesë organizatën për të arritur të gjitha objektivat e saj.

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i vlefshëm, pasi udhëhiqet nga standardet, të cilat përbëjnë bazat për dokumentimin e duhur, disiplinën dhe procese sistematike që sigurojnë cilësinë e performancës së angazhimit të auditimit të brendshëm.

Në këtë përkufizim supozohet se kontrollet ekzistojnë vetëm për të ndihmuar organizatën të administrojë rreziqet e saj dhe të nxisë qeverisjen efektive. Një perspektivë e tillë i zgjeron në mënyrë të konsiderueshme horizontet e auditimit të brendshëm dhe zgjeron

fushën e tij të punës, e drejton atë kah administrimi i rreziqeve, kontrollet dhe proceset e qeverisjes.

Kështu, në vitet 1990 u kuptua qartësisht se audituesit e brendshëm, në varësi të nevojave dhe preferencave të veçanta të organizatës së tyre, punonin në fusha të ndryshme: auditet e pajtueshmërisë me ligjet, auditet e cikleve të transaksioneve, hetimi i mashtrimeve dhe i parregullsive të tjera, vlerësimi i efikasitetit operacionale, analitike, matja dhe raportimi i rreziqeve operacionale dhe të organizatës, në tërësi dhe aktivitete të tjera sigurie dhe këshillimi. Në kryerjen e shumë prej këtyre aktiviteteve, audituesit e brendshëm përdorën mjetet e bazuara në nivelin e rrezikut dhe të përqendruara në kontroll. Ata, gjithashtu, përdorën shumë aplikacionet e sofistikuar teknologjike në kryerjen e këtyre auditeve. Pra “audituesit e shekullit të 21-të duhet të përgatiten të auditojnë virtualisht çdo gjë, operacionet (duke përfshirë sistemet e kontrollit), performancën, informacionet dhe sistemet e informacionit, pajtueshmërinë me ligjet, pasqyrat financiare, mashtrimet, raportimet dhe cilësinë” (Ratliff, Reding, 2002).

Auditimi i brendshëm, vija e tretë e mbrojtjes:

Çdo organizatë, pavarësisht nga struktura, forma, qëllimi, lloji i kapitalit në veprimtarinë e vet ndërmerr rreziqe të caktuara. Për përmbushjen e objektivave që ka organizata, e rëndësishme është që këto rreziqe të njihen dhe të administrohen. Procesi i administrimit të rreziqeve realizohet nga krejt organizata, sipas një modeli i cili përshkruhet nga Jean-Pierre Garitte, si i përbërë nga tri vija mbrojtëse. Procesi i njohjes dhe administrimit të rreziqeve bëhet nga punonjësit dhe drejtuesit e operacioneve të organizatës, gjatë kryerjes së veprimtarisë së përditshme. Rreziqet njihen duke i identifikuar dhe i vlerësuar ato.

Rreziqet reduktohen nëpërmjet vendosjes së kontrolleve. Rreziqet administrohen nëpërmjet procesit të vënies në funksionim të kontrolleve dhe mbikëqyrjes së këtij procesi nga drejtuesit e nivelit të ulët deri te niveli i lartë. Pikërisht ajo pjesë e organizatës, e cila përbëhet nga punonjësit dhe drejtuesit e angazhuar në veprimtarinë e përditshme të saj, është pronare, përgjegjëse dhe jep llogari për vlerësimin e rreziqeve, kontrollin e rreziqeve dhe reduktimin e tyre. Në këtë mënyrë ata shndërrohen në vijën e parë të mbrojtjes së organizatës.

Duke qenë se përmbushja e objektivave është tepër e rëndësishme, organizatat ndërtojnë vijën e dytë të mbrojtjes, e cila realizon mbikëqyrjen e rreziqeve dhe efektivitetin e kontrollit të tyre në vijën e parë të mbrojtjes. Vija e dytë e mbrojtjes përbëhet nga funksione të tilla si: kontrolli financiar, inspektimi, hetimi i mashtrimit, administrimi i rrezikut, kontrolli i brendshëm, pajtueshmëria me ligjet dhe rregullat.

Vija e dytë e mbrojtjes realizon në mënyrë të pavarur vlerësimin e rrezikut, strategjisë së organizatës për të marrë rrezik mbi vete, e raportimit të rrezikut dhe të përshtatshmërisë së planeve të hartuara për zvogëlimin e rrezikut.

Në vijën e tretë të mbrojtjes qëndron funksioni i auditimit të brendshëm, i cili jep siguri mbi funksionimin e dy vijave të para të mbrojtjes, mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme, si dhe mbi efektivitetin e zbatimit të politikave. Rëndësia shërbimeve të sigurisë që ofron auditimi i brendshëm është se vija e tretë e mbrojtjes e kryen funksionin e saj në mënyrë të pavarur nga punonjësit dhe drejtuesit e angazhuar në veprimtarinë e përditshme të organizatës.

Për pasojë, auditimi i brendshëm kërkohet të mos jetë pjesë e operacioneve të organizatës dhe as në administrimin apo drejtimin e tyre, si dhe të raportojë në nivelet më të larta të organizatës, siç janë bordi apo komiteti i auditimit.

Ky model gjen zbatim në çdo organizatë, por zhvillimi i funksioneve brenda secilës vijë mbrojtëse varet gjerësisht nga madhësia dhe kompleksiteti i organizatës, fusha ku vepron, rreziqet me të cilat përballet, shtrirja gjeografike etj. Si rregull një organizatë e madhe me strukturë apo aktivitete komplekse, me shtrirje të gjerë gjeografike apo një shumëkombëshe, e cila përballet me nivele të larta rreziku dhe rreziqe të shumëfishta apo që vepron në industri sensitive (si p.sh., industria bankare) kërkohet të kenë një sistem të ndërtuar mirë dhe sa më të përshtatshëm të kontroleve të brendshme, për të reduktuar rreziqet që ndërmerren. Asnjëherë nuk kërkohet që rreziku të jetë zero. Një rrezik zero, sipas Jean-Pierre Garitte, do të thotë zero aktivitet dhe mungesë fitimi.

Ajo që kërkohet është kontrolli i përshtatshëm i rreziqeve të ndërmarra, duke ndjekur parimin e kosto-efektivitet.

Kontrolli dhe auditimi, dallojnë:

Rëndom roli i audituesit të brendshëm ngatërrohet me rolin e kontrollit / kontrolluesit. Paqartësinë për rolin e auditimit të brendshëm mund ta ndeshim në çdo nivel organizate, nga punonjësi më i thjeshtë e deri te drejtuesit. Madje në rrethana të caktuara dhe vetë audituesit e brendshëm nuk e kanë të qartë rolin e tyre. Kjo paqartësi është më e theksuar në ato mjedise ku sapo kanë filluar të kenë njohje dhe të gjejnë zbatim standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm. Sipas IIA-së “Kontrolli është çdo veprim i marrë nga drejtimi për të nxitur arritjen e objektivave dhe qëllimeve.

Drejtimi planifikon, organizon dhe drejton veprime të mjaftueshme për të siguruar garanci të arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Pra, kontrolli është rezultat i planifikimit të duhur dhe organizimit nga ana e drejtimit”.

Tërësia e kontrolleve në një organizatë përbën atë që quhet “sistemi i kontrolleve të brendshme”. Në këtë kuptim “kontrollorët” në organizatë janë vetë punonjësit dhe drejtuesit në nivele të ndryshme hierarkike. Me fjalë të tjera “kontrollorët” gjenden në vijën e parë dhe të dytë të mbrojtjes. Elementët që e përbëjnë sistemin e kontrollit të brendshëm janë të përcaktuara në shkallë ndërkombëtare në atë që quhet sistemi COSO dhe janë 5 të tillë: mjedisi i kontrollit; vlerësimi i rrezikut; aktivitetet e kontrollit; mbikëqyrja; dhe informimi e komunikimi. Këtij kuadri elementesh më vonë iu shtuan dhe 3 të tjerë për të arritur në atë që sot e quajmë COSO IC – ERM (kontroll i brendshëm – administrim i rrezikut të organizatës).

Këta tre elementë janë: vendosja e objektivave; identifikimi i ngjarjes dhe përgjigjja ndaj rrezikut është sistem kontrolle të brendshme që siguron se përmbushen objektivat operacionale. Por duhet pasur parasysh që kjo siguri nuk është absolute. Sistemi i kontrolleve të brendshme jep vetëm siguri të arsyeshme. Ndërsa auditimi i brendshëm bën vlerësimin për të siguruar që sistemi i kontrolleve të brendshme ekziston, funksionon, është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm. Auditimi i brendshëm në këtë mënyrë e mbështet drejtimin për ta siguruar se

- (a) rreziqet janë identifikuar dhe mbikëqyrur në mënyrë efektive,
- (b) proceset e organizatës kontrollohen në mënyrë efektive,

(c) proceset e organizatës janë efektive. është pikërisht për këtë arsye që sot auditimi i brendshëm konsiderohet si një nga shtyllat e qeverisjes së mirë të organizatës.

